Republika e Kosovës
Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2025
dhe
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës
Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2025



ask

MICS

MICS
GENERATING EVIDENCE TO DELIVER FOR CHILDREN

Republika e Kosovës
Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2025
dhe
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës
Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2025

Raporti i Gjetjeve të Anketës

Shtator 2026

ANKETA E TREGUESVE TË SHUMËFISHTË PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS 2025
DHE
ANKETA E TREGUESVE TË SHUMËFISHTË PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2025

Dizajni dhe kopertinës:
Vonesa Gashi

Publikuar në shtator 2026

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS) për Republikën e Kosovës dhe MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës janë realizuar në vitin 2025 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike është ofruar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me financim nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, UNICEF, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim – Ambasada e Zvicrës në Kosovë, Zyra e Koordinatorit për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDCO) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

Në Komitetin Teknik ishin të përfaqësuara ASK-ja, UNICEF-i, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh), Ministria e Shëndetësisë (MSh), Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP), Ministria e Financave (MF), Ministria e Drejtësisë (MD), Institucioni i Avokatit të Popullit, Universiteti i Prishtinës dhe Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF.

Programi global MICS u zhvillua nga UNICEF-i në vitet 1990 si një program ndërkombëtar shumëqëllimësh i anketave të ekonomive familjare, për t'i mbështetur vendet në mbledhjen e të dhënave të krahasueshme ndërkombëtarisht për një gamë të gjerë treguesish mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave. Anketat MICS matin treguesit kyç që u mundësojnë vendeve të gjenerojnë të dhëna për përdorim në politika, programe dhe plane kombëtare të zhvillimit, si dhe të monitorojnë progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve) dhe zotimeve të tjera të dakorduara ndërkombëtarisht. Në Republikën e Kosovës, raundet e MICS të realizuara në vitet 2013–2014 dhe 2019–2020 plotësuan boshllëqe të rëndësishme në të dhëna dhe ofruan njohuri tejet të vlefshme për vendimmarrje. Të dhënat kanë ndikuar në hartimin e strategjive dhe kornizave kryesore kombëtare, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijës 2019–2023 dhe Strategjinë e Arsimit 2022–2026, si dhe Kornizën e Bashkëpunimit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021–2025 dhe Programin e UNICEF-it për Kosovë 2021–2025. Vlera e tyre njihet gjerësisht nga shoqëria civile, akademia dhe palët e tjera të interesit. Në veçanti, të dhënat kanë informuar vendime të rëndësishme për financim, përfshirë alokimet e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) dhe investimet e Qeverisë në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe në fusha të tjera prioritare.

Qëllimi i këtij raporti është të lehtësojë shpërndarjen dhe përdorimin në kohë të rezultateve nga MICS 2025 për Republikën e Kosovës dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës. Raporti përmban informacione të hollësishme për metodologjinë e anketës dhe të gjitha tabelat standarde të MICS. Raporti shoqërohet nga një seri pasqyrash të shkurtra informative statistikore mbi gjetjet kryesore të anketës.

Për më shumë informacione rreth programit global MICS, vizitoni mics.unicef.org.

Citimi i sugjeruar:

Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF. 2026. *Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Republikën e Kosovës 2025 dhe Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2025, Raporti i Gjetjeve të Anketës*. Prishtinë, Republika e Kosovës: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF.

TABELA PËRMBLEDHËSE E ZBATIMIT TË ANKETËS DHE POPULLSISË SË ANKETËS

Mostra dhe zbatimi i anketës			
Korniza e mostrimit	Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2024	**Pyetësorët**	Ekonomia familjare Femrat e moshës 15–49 vjeç Meshkujt e moshës 15–49 vjeç Fëmijët nën moshën 5 vjeç Fëmijët e moshës 5–17 vjeç Formulari i të dhënave të vaksinimit në institucionin shëndetësor
- E përditësuar	Prill – gusht 2025		
Trajnimi i intervistuesve	Gusht – shtator 2025	**Puna në terren**	Shtator – dhjetor 2025

Mostra e anketës			
Kosovë		**Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë**	
Ekonomitë familjare		Ekonomitë familjare	
- Të mostruara	7.364	- Të mostruara	1.436
- Të banuara	6.372	- Të banuara	1.247
- Të intervistuara	5.777	- Të intervistuara	1.151
- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	90,7	- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	92,3
Femrat e moshës 15–49 vjeç		Femrat e moshës 15–49 vjeç	
- Të kualifikueshme për intervistë	5.738	- Të kualifikueshme për intervistë	1.479
- Të intervistuara	4.888	- Të intervistuara	1.268
- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	85,2	- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	85,7
Meshkujt e moshës 15–49 vjeç		Meshkujt e moshës 15–49 vjeç	
- Numri në ekonomitë familjare të intervistuara	5.924	- Numri në ekonomitë familjare të intervistuara	1.554
- Të kualifikueshëm për intervistë[1]	2.986	- Të kualifikueshëm për intervistë[1]	785
- Të intervistuar	2.190	- Të intervistuar	594
- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	73,3	- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	75,7
Fëmijët nën moshën 5 vjeç		Fëmijët nën moshën 5 vjeç	
- Të kualifikueshëm	1.593	- Të kualifikueshëm	636
- Nënat/kujdestarët e intervistuar	1.393	- Nënat/kujdestarët e intervistuar	596
- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	87,4	- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	93,7
Fëmijët e moshës 5–17 vjeç		Fëmijët e moshës 5–17 vjeç	
- Numri në ekonomitë familjare të intervistuara	4.997	- Numri në ekonomitë familjare të intervistuara	1.769
- Të kualifikueshëm[2]	2.600	- Të kualifikueshëm	733
- Nënat/kujdestarët e intervistuar	2.389	- Nënat/kujdestarët e intervistuar	676
- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	91,9	- Shkalla e përgjigjes (Përqindja)	92,2

[1] Pyetësori për meshkujt e moshës 15–49 vjeç iu administrua të gjithë meshkujve të moshës 15–49 vjeç në çdo të dytën ekonomi familjare.

[2] Pyetësori për fëmijët dhe adoleshentët e moshës 5–17 vjeç iu administrua një fëmije të përzgjedhur rastësisht në secilën ekonomi familjare të intervistuar.

Populllsia e anketës			
Kosovë		**Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë**	
Madhësia mesatare e ekonomisë familjare	4,3	**Madhësia mesatare e ekonomisë familjare**	5,3
Përqindja e popullsisë nën:		**Përqindja e popullsisë nën:**	
- Moshën 5 vjeç	6,5	- Moshën 5 vjeç	10,8
- Moshën 18 vjeç	26,5	- Moshën 18 vjeç	40,5
Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç me të paktën një lindje të gjallë gjatë 2 viteve të fundit	11,4	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç me të paktën një lindje të gjallë gjatë 2 viteve të fundit	17,9
Përqindja e popullsisë që jeton në		**Përqindja e popullsisë që jeton në**	
- Vendbanime urbane	51,6	- Vendbanime urbane	62,6
- Vendbanime rurale	48,4	- Vendbanime rurale	37,4

PËRMBAJTJA

Tabela përmbledhëse e zbatimit të anketës dhe popullsisë së anketës ... **iii**

Përmbajtja ... **iii**

Lista e shkurtesave ... **xii**

Falënderimet ... **xiv**

1 Hyrje ... **15**

2 Organizimi dhe metodologjia e anketës ... **18**

2.1 Organizimi i anketës ... 18
2.2 Dizajni i mostrës ... 18
2.3 Pyetësorët ... 19
2.4 Etika ... 21
2.4.1 Procedurat e pëlqimit të informuar ... 21
2.4.2 Mbrojtja e të dhënave ... 21
2.5 Metoda e mbledhjes së të dhënave ... 21
2.6 Trajnimi ... 22
2.7 Puna në terren ... 22
2.8 Masat e kontrollit të cilësisë së punës në terren ... 23
2.9 Menaxhimi dhe editimi i të dhënave ... 23
2.10 Analiza dhe raportimi ... 23
2.11 Ndarja të dhënave ... 23
2.12 Struktura e raportit ... 24
2.13 Si të lexohen tabelat ... 24

3 Treguesit dhe përkufizimet ... **26**

4 Mbulimi i mostrës dhe karakteristikat e respondentëve ... **44**

4.1 Rezultatet e intervistave ... 44
Tabela SR.1.1: Rezultatet e intervistave të ekonomive familjare, femrave, meshkujve, fëmijëve nën moshën 5 vjeç dhe fëmijëve të moshës 5–17 vjeç ... 45
Tabela SR.1.1R: Rezultatet e intervistave të ekonomive familjare, femrave, meshkujve, fëmijëve nën moshën 5 vjeç dhe fëmijëve të moshës 5–17 vjeç ... 47
4.2 Karakteristikat e banimit dhe ekonomive familjare ... 48
Tabela SR.2.1: Karakteristikat e banimit ... 48
Tabela SR.2.2: Asetet personale dhe të ekonomisë familjare ... 50
Tabela SR.2.3: Kuintilët e pasurisë ... 51
Tabela SR.2.4: Karakteristikat e privimit material ... 52
Tabela SR.2.1R: Karakteristikat e banimit ... 53
Tabela SR.2.2R: Asetet personale dhe të ekonomisë familjare ... 54
Tabela SR.2.3R: Kuintilët e pasurisë ... 55
Tabela SR.2.4R: Karakteristikat e privimit material ... 56
4.3 Përbërja e ekonomisë familjare ... 57
Tabela SR.3.1: Përbërja e ekonomisë familjare ... 57
Tabela SR.3.2: Anëtarët e ekonomive familjare ... 59
Tabela SR.3.1R: Përbërja e ekonomisë familjare ... 60
Tabela SR.3.2R: Anëtarët e ekonomive familjare ... 61
4.4 Struktura e moshës së popullsisë së ekonomive familjare ... 62

Tabela SR.4.1: Shpërndarja e moshës së popullatës së ekonomive familjare sipas gjinisë 62
Tabela SR.4.1R: Shpërndarja e moshës së popullatës së ekonomive familjare sipas gjinisë 63
4.5 Karakteristikat e përgjithshme të respondentëve 64
Tabela SR.5.1: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve dhe femrave të moshës 15–49 vjeç 67
Tabela SR.5.1W: Karakteristikat e përgjithshme të femrave 68
Tabela SR.5.1M: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve 69
Tabela SR.5.2: Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve nën moshën 5 vjeç 70
Tabela SR.5.3: Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve të moshës 5–17 vjeç 71
Tabela SR.5.1R: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve dhe femrave të moshës 15–49 vjeç 72
Tabela SR.5.1WR: Karakteristikat e përgjithshme të femrave 73
Tabela SR.5.1MR: Karakteristikat e përgjithshme të meshkujve 74
Tabela SR.5.2R: Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve nën moshën 5 vjeç 75
Tabela SR.5.3R: Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve të moshës 5–17 vjeç 77
4.6 Përdorimi i energjisë në ekonomi familjare 79
Tabela SR.6.1: Mbështetja primare në lëndët djegëse të pastra dhe teknologjitë e gatimit 80
Tabela SR.6.2: Mbështetja primare në lëndët djegëse të ngurta për gatim 81
Tabela SR.6.3: Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për ngrohjen e hapësirës 82
Tabela SR.6.4: Mbështetja primare në lëndë djegëse dhe teknologji të pastra për ndriçim 83
Tabela SR.6.5: Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim 84
Tabela SR.6.1R: PMbështetja primare në lëndët djegëse të pastra dhe teknologjitë e gatimit 85
Tabela SR.6.2R: Mbështetja primare në lëndët djegëse të ngurta për gatim 86
Tabela SR.6.3R: Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për ngrohjen e hapësirës 87
Tabela SR.6.4R: Mbështetja primare në lëndë djegëse dhe teknologji të pastra për ndriçim 88
Tabela SR.6.5R: Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim 89
4.7 Vendi i lindjes 90
Tabela SR.7.2: Vendi i lindjes 91
Tabela SR.7.2R: Vendi i lindjes 92
4.8 Modalitetet e jetesës së fëmijëve 93
Tabela SR.9.1: Modalitetet e jetesës së fëmijëve dhe të qenit jetim 94
Tabela SR.9.2: Modalitetet e jetesës së fëmijëve dhe bashkëjetesa me prindër 95
Tabela SR.9.3: Fëmijët pa kujdesje prindërore 96
Tabela SR.9.1R: Modalitetet e jetesës së fëmijëve dhe të qenit jetim 97
Tabela SR.9.2R: Modalitetet e jetesës së fëmijëve dhe bashkëjetesa me prindër 98
Tabela SR.9.3R: Fëmijët pa kujdesje prindërore 99

5 Mbijetesa 101

Tabela CS.1: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme 102
Tabela CS.2: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme sipas karakteristikave socio-ekonomike 102
Tabela CS.3: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme sipas karakteristikave demografike 103
Tabela CS.1R: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme 104
Tabela CS.2R: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme sipas karakteristikave socio-ekonomike 105
Tabela CS.3R: Shkallët e vdekshmërisë në fëmijërinë e hershme sipas karakteristikave demografike 106

6 Zhvillimi – Shëndeti riprodhues, i nënës, i të porsalindurve dhe i të rriturve 107

6.1 Fertiliteti 107
Tabela TM.1.1: Shkalla e fertilitetit 108

Tabela TM.1.1R: Shkalla e fertilitetit 109
6.2 Lindja e hershme e fëmijëve 110
Tabela TM.2.1: Shkalla e lindjeve tek adoleshentët dhe shkalla totale e fertilitetit 111
Tabela TM.2.2W: Lindjet e fëmijëve në moshë të re (femrat e reja) 112
Tabela TM.2.3W: Trendet e lindjeve në moshë të re (femrat) 113
Tabela TM.2.1R: Shkalla e lindjeve tek adoleshentët dhe shkalla totale e fertilitetit 114
Tabela TM.2.2WR: Lindjet e fëmijëve në moshë të re (femrat e reja) 115
Tabela TM.2.3WR: Trendet e lindjeve në moshë të re (femrat) 116
6.3 Përdorimi i kontracepsionit 117
Tabela TM.3.1: Përdorimi i kontracepsionit (femra aktualisht të martuara/në bashkëjetesë) 118
Tabela TM.3.1R: Përdorimi i kontracepsionit (femra aktualisht të martuara/në bashkëjetesë) 120
6.4 Kujdesi antenatal 122
Tabela TM.5.1: Mbulueshmëria e kujdesit antenatal 123
Tabela TM.5.2: Numri i vizitave antenatale dhe koha e vizitës së parë 124
Tabela TM.5.3: Përmbajtja e kujdesit antenatal 125
Tabela TM.5.1R: Mbulueshmëria e kujdesit antenatal 126
Tabela TM.5.2R: Numri i vizitave antenatale dhe koha e vizitës së parë 127
Tabela TM.5.3R: Përmbajtja e kujdesit antenatal 128
7 Zhvillimi – Shëndeti, ushqyerja dhe zhvillimi i fëmijëve 129
7.1 Imunizimi në fëmijërinë e hershme 129
Tabela TC.1.1: Vaksinimet në vitet e para të jetës 132
Tabela TC.1.2: Vaksinimet sipas karakteristikave të përgjithshme (fëmijët e moshës 12–23 muaj) 134
Tabela TC.1.2: Vaksinimet sipas karakteristikave të përgjithshme (fëmijët e moshës 24-35 muaj) 135
Tabela TC.1.3: Të dhënat e vaksinimit të bazuara në shtëpi 136
Tabela TC.1.3A: Të dhënat e vaksinimit në institucionet shëndetësore 137
Tabela TC.1.1R: Vaksinimet në vitet e para të jetës 138
Tabela TC.1.2R: Vaksinimet sipas karakteristikave të përgjithshme (fëmijët e moshës 12-23 muaj) 140
Tabela TC.1.2R: Vaksinimet sipas karakteristikave të përgjithshme (fëmijët e moshës 24-35 muaj) 141
Tabela TC.1.3R: Regjistrat e vaksinimit të bazuar në shtëpi 142
Tabela TC.1.3AR: Të dhënat e vaksinimit në institucionet shëndetësore 143
7.2 Ushqyerja e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël 144
Tabela TC.7.1: Fillimi i ushqyerjes me gji 148
Tabela TC.7.2: Statusi i ushqyerjes me gji 149
Tabela TC.7.3: Fillimi i ushqyerjes me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta 150
Tabela TC.7.4: Praktikat e ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve të vegjël 151
Tabela TC.7.5: Varfëria ushqimore e fëmijëve 153
Tabela TC.7.6: Konsumimi i grupeve të përzgjedhura ushqimore 154
Tabela TC.7.7: Praktikat e pashëndetshme të ushqyerjes 156
Tabela TC.7.1R: Fillimi i ushqyerjes me gji 157
Tabela TC.7.2R: Statusi i ushqyerjes me gji 158
Tabela TC.7.3R: Fillimi i ushqyerjes me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta 159
Tabela TC.7.4R: Praktikat e ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve të vegjël 160
Tabela TC.7.5R: Varfëria ushqimore e fëmijëve 162
Tabela TC.7.6R: Konsumimi i grupeve të përzgjedhura ushqimore 163
Tabela TC.7.7R: Praktikat e pashëndetshme të ushqyerjes 165
7.3 Kequshqyerja 166

Tabela TC.8.1: Gjendja e ushqyerjes së fëmijëve nën moshën 5 vjeç ... 169
Tabela TC.8.2: Gjendja e të ushqyerit së fëmijëve të moshës 5-9 vjeç ... 171
Tabela TC.8.1R: Gjendja e ushqyerjes së fëmijëve nën moshën 5 vjeç ... 173
Tabela TC.8.2R: Gjendja e të ushqyerit së fëmijëve të moshës 5-9 vjeç ... 175
7.4 Kujdesi i përgjegjshëm në fëmijërinë e hershme ... 177
Tabela TC.9.1: Stimulimi i hershëm dhe kujdesi i përgjegjshëm ... 178
Tabela TC.9.2: Materialet për mësim ... 180
Tabela TC.9.3: Mbikëqyrja jo adekuate ... 181
Tabela TC.9.1R: Stimulimi i hershëm dhe kujdesi i përgjegjshëm ... 182
Tabela TC.9.2R: Materialet për mësim ... 184
Tabela TC.9.3R: Mbikëqyrja jo adekuate ... 185
7.5 Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme ... 186
Tabela TC.10.1: Indeksi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme 2030 (ECDI2030) ... 187
Tabela TC.10.1R: Indeksi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme 2030 (ECDI2030) ... 188

8 Të mësuarit dhe fitimi i shkathtësive ... 189

8.1 Edukimi në fëmijërinë e hershme ... 189
Tabela LN.1.1: Edukimi në fëmijërinë e hershme ... 191
Tabela LN.1.2: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) ... 192
Tabela LN.1.3: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore) ... 193
Tabela LN.1.1R: Edukimi në fëmijërinë e hershme ... 194
Tabela LN.1.2R: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) ... 195
Tabela LN.1.3R: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore) ... 196
8.2 Vijueshmëria ... 197
Tabela LN.2.1: Gatishmëria për shkollë ... 200
Tabela LN.2.2: Hyrja në shkollë fillore ... 201
Tabela LN.2.3: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës fillore ... 202
Tabela LN.2.4: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të ulët ... 203
Tabela LN.2.5: Mosha për klasë ... 204
Tabela LN.2.6: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të lartë ... 206
Tabela LN.2.7: Shkalla bruto e regjistrimit, përfundimit dhe tranzicionit efektiv ... 207
Tabela LN.2.8: Indekset e barazisë për vijueshmërinë ... 209
Tabela LN.2.1R: Gatishmëria për shkollë ... 210
Tabela LN.2.2R: Hyrja në shkollë fillore ... 211
Tabela LN.2.3R: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës fillore ... 212
Tabela LN.2.4R: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të ulët ... 214
Tabela LN.2.5R: Mosha për klasë ... 216
Tabela LN.2.6R: Vijueshmëria shkollore tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të lartë ... 218
Tabela LN.2.7R: Shkalla bruto e regjistrimit, përfundimit dhe tranzicionit efektiv ... 220
Tabela LN.2.8R: Indekset e barazisë për vijueshmërinë ... 222
8.3 Pajisjet e TIK-ut, përdorimi dhe aftësitë ... 223
Tabela LN.6.1: Posedimi i pajisjeve të TIK-ut nga ekonomitë familjare, qasja në internet dhe përdorimi i telefonit mobil për transaksione financiare ... 224

Tabela LN.6.1R: Posedimi i pajisjeve të TIK-ut nga ekonomitë familjare, qasja në internet dhe përdorimi i telefonit mobil për transaksione financiare ... 225

9 Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi ... 226

9.1 Regjistrimi i lindjeve ... 226
Tabela PR.1.1: Regjistrimi i lindjeve ... 227
Tabela PR.1.1R: Regjistrimi i lindjeve ... 228
9.2 Disiplinimi i fëmijëve ... 229
Tabela PR.2.1: Disiplinimi i fëmijëve ... 230
Tabela PR.2.2: Qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik ... 231
Tabela PR.2.1R: Disiplinimi i fëmijëve ... 232
Tabela PR.2.2R: Qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik ... 233
9.3 Fëmijët në punë ... 234
Tabela PR.3.1: Përfshirja e fëmijëve në aktivitete ekonomike ... 236
Tabela PR.3.2: Përfshirja e fëmijëve në punët e shtëpisë ... 237
Tabela PR.3.3: Fëmijët në punë ... 238
Tabela PR.3.4: Puna e rrezikshme ... 239
Tabela PR.3.1R: Përfshirja e fëmijëve në aktivitete ekonomike ... 241
Tabela PR.3.2R: Përfshirja e fëmijëve në punët e shtëpisë ... 243
Tabela PR.3.3R: Fëmijët në punë ... 244
Tabela PR.3.4R: Puna e rrezikshme ... 245
9.4 Martesa e fëmijëve ... 247
Tabela PR.4.1W: Martesa e fëmijëve (femrat) ... 249
Tabela PR.4.1M: Martesa e fëmijëve (meshkujt) ... 250
Tabela PR.4.2W: Trendët në martesat e fëmijëve (femrat) ... 251
Tabela PR.4.2M: Trendet në martesat e fëmijëve (meshkujt) ... 252
Tabela PR.4.3: Diferenca në moshë bashkëshortore ... 253
Tabela PR.4.1WR: Martesa e fëmijëve (femrat) ... 254
Tabela PR.4.1MR: Martesa e fëmijëve (meshkujt) ... 256
Tabela PR.4.2WR: Trendët në martesat e fëmijëve (femrat) ... 258
Tabela PR.4.2MR: Trendet në martesën e fëmijëve (meshkujt) ... 259
Tabela PR.4.3R: Diferenca në moshë bashkëshortore ... 260
9.5 Qëndrimet ndaj dhunës në familje ... 261
Tabela PR.7.1W: Qëndrimet ndaj dhunës në familje (femrat) ... 262
Tabela PR.7.1M: Qëndrimet ndaj dhunës në familje (meshkujt) ... 263

10 Jetesa në mjedis të sigurt dhe të pastër ... 268

10.1 Uji i pijshëm ... 268
Tabela WS.1.1: Përdorimi i burimeve të përmirësuara dhe të papërmirësuara të ujit ... 270
Tabela WS.1.2: Përdorimi i shërbimeve bazike dhe të kufizuara të ujit të pijshëm ... 271
Tabela WS.1.5: Disponueshmëria e ujit të pijshëm në sasi të mjaftueshme kur është i nevojshëm ... 273
Tabela WS.1.1R: Përdorimi i burimeve të përmirësuara dhe të papërmirësuara të ujit ... 274
Tabela WS.1.2R: Përdorimi i shërbimeve bazike dhe të kufizuara të ujit të pijshëm ... 275
Tabela WS.1.5R: Disponueshmëria e ujit të pijshëm në sasi të mjaftueshme kur është i nevojshëm ... 277
10.2 Sanitari ... 278
Tabela WS.3.1: Përdorimi i kanalizimeve të përmirësuara dhe të papërmirësuara ... 280
Tabela WS.3.7: Përdorimi i shërbimeve sanitare bazike dhe të kufizuara ... 281
Tabela WS.3.9: Shkallët e ujit të pijshëm dhe të kanalizimit ... 283

Tabela WS.3.1R: Përdorimi i kanalizimeve të përmirësuara dhe të papërmirësuara 284
Tabela WS.3.7R: Përdorimi i shërbimeve sanitare bazike dhe të kufizuara 285
Tabela WS.3.9R: Shkallët e ujit të pijshëm dhe të kanalizimit 287

11 Mundësi të barabarta në jetë 288

11.1 Funksionimi i fëmijëve 288
Tabela EQ.1.1: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 2-4 vjeç) 289
Tabela EQ.1.2: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 290
Tabela EQ.1.3: Përdorimi i pajisjeve ndihmëse (fëmijët e moshës 2-17 vjeç) 291
Tabela EQ.1.4: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 2-17 vjeç) 292
Tabela EQ.1.1R: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 2-4 vjeç) 293
Tabela EQ.1.2R: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 294
Tabela EQ.1.3R: Përdorimi i pajisjeve ndihmëse (fëmijët e moshës 2-17 vjeç) 296
Tabela EQ.1.4R: Funksionimi i fëmijëve (fëmijët e moshës 2-17 vjeç) 297
11.2 Transferet sociale 298
Tabela EQ.2.1W: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (femra) 299
Tabela EQ.2.1M: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (meshkuj) 300
Tabela EQ.2.2: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 301
Tabela EQ.2.3: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 302
Tabela EQ.2.4: Informimi dhe përdorimi i mbështetjes së jashtme ekonomike 303
Tabela EQ.2.5: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Të gjithë anëtarët e ekonomive familjare 304
Tabela EQ.2.6: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Fëmijët në të gjitha ekonomitë familjare 305
Tabela EQ.2.9F: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Anëtaret femra të ekonomive familjare 306
Tabela EQ.2.9M: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Anëtaret meshkuj të ekonomive familjare 307
Tabela EQ.2.1WR: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (femra) 308
Tabela EQ.2.1MR: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (meshkuj) 309
Tabela EQ.2.2R: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 310
Tabela EQ.2.3R: Mbulueshmëria me sigurim shëndetësor (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 311
Tabela EQ.2.4R: Informimi dhe përdorimi i mbështetjes së jashtme ekonomike 312
Tabela EQ.2.5R: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Të gjithë anëtarët e ekonomive familjare 313
Tabela EQ.2.6R: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Fëmijët në të gjitha ekonomitë familjare 314
Tabela EQ.2.9FR: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Anëtaret femra të ekonomive familjare 316
Tabela EQ.2.9MR: Mbulueshmëria me transferet sociale dhe përfitimet: Anëtaret meshkuj të ekonomive familjare 317
11.3 Diskriminimi dhe ngacmimi 318
Tabela EQ.3.1: Diskriminimi dhe ngacmimi 319
Tabela EQ.3.1R: Diskriminimi dhe ngacmimi 321

Shtojca A Dizajni i mostrës 323

A.1 Dizajni i mostrës për mostrën e MICS 2025 për Kosovë 323
A.1.1. Madhësia e mostrës dhe alokimi i mostrës 323

Tabela SD.1: Shpërndarja e qarqeve regjistruese dhe ekonomive familjare në kornizën e mostrimit 323
Tabela SD.2: Alokimi i mostrës 325
A.1.2. Përzgjedhja e qarqeve regjistruese (grupimeve) 325
A.1.3. Aktivitetet e listimit 325
A.1.4. Përzgjedhja e ekonomive familjare 326
A.1.5. Llogaritja e peshave të mostrës 327
A.2 Dizajni i mostrës për mostrën e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë .. 329
A.2.1. Madhësia e mostrës dhe alokimi i mostrës 330
A.2.2. Aktivitetet e listimit 330
A.2.3. Përzgjedhja e ekonomive familjare 331
A.2.4. Llogaritja e peshave të mostrës 331

Shtojca B Lista e personelit të përfshirë në anketë 334

Shtojca C Vlerësimet e gabimeve të mostrimit 337

C.1 Vlerësimet e gabimeve të mostrimit për MICS 2025 për Kosovë 339
Tabela SE.1: Gabimet e mostrimit: Mostra totale 339
Tabela SE.2: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet urbane 341
Tabela SE.3: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet rurale 343
C.2 Vlerësimet e gabimeve të mostrimit për MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 345
Tabela SE.1R: Gabimet e mostrimit: Mostra totale 345
Tabela SE.2R: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet urbane 347
Tabela SE.3R: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet rurale 349

Shtojca D Cilësia e të dhënave 351

D.1 Tabelat e cilësisë së të dhënave për MICS 2025 për Kosovë 351
D.1.1. Shpërndarja e moshës 351
Tabela DQ.1.1: Shpërndarja e popullatës së ekonomive familjare sipas moshës 351
Tabela DQ.1.2W: Shpërndarja e femrave të kualifikuara dhe të intervistuara sipas moshës 352
Tabela DQ.1.2M: Shpërndarja e meshkujve të kualifikuar dhe të intervistuar sipas moshës 353
Tabela DQ.1.3: Shpërndarja e fëmijëve të vegjël në ekonomitë familjare dhe pyetësorët për moshën nën 5 vjeç sipas moshës 354
Tabela DQ.1.4: Shpërndarja e fëmijëve të moshës 3-20 vjeç në ekonomitë familjare dhe pyetësorët 5-17 sipas moshës 355
D.1.2. Raportimi i datës së lindjes dhe moshës 356
Tabela DQ.2.1: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (anëtarët e ekonomisë familjare) 356
Tabela DQ.2.2W: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (femra) 357
Tabela DQ.2.2M: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (meshkuj) 358
Tabela DQ.2.3: Raportimi i datës së lindjes (lindjet e gjalla) 359
Tabela DQ.2.4: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 360
Tabela DQ.2.5: Shpërndarja e datës së lindjes (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 361
Tabela DQ.2.6: Raportimi i datës së lindjes (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 362
Tabela DQ.2.7: Shpërndarja e datës së lindjes (fëmijët e përzgjedhur të moshës 5-9 vjeç) 363
D.1.3. Kompletimi dhe matjet 364
Tabela DQ.3.2W: Kompletimi i informatave për datat e martesës/ bashkëjetesës (femra) 364
Tabela DQ.3.2M: Kompletimi i informatave për datat e martesës/ bashkëjetesës (meshkuj) 365
Tabela DQ.3.4: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për moshë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 366

Tabela DQ.3.5: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Gjatësia për moshë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 367
Tabela DQ.3.6: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për gjatësinë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 368
Tabela DQ.3.7: Njëanshmëritë (heaping) në matjet antropometrike (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 369
Tabela DQ.3.8: Pengesat në matjet antropometrike (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 370
Tabela DQ.3.9: Devijimi standard i vlerës z (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 371
Tabela DQ.3.10: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 372
Tabela DQ.3.11: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Gjatësia për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 373
Tabela DQ.3.12: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: BMI për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 374
Tabela DQ.3.13: Njëanshmëritë (heaping) në matjet antropometrike (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 375
Tabela DQ.3.14: Pengesat në matjet antropometrike (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 376
Tabela DQ.3.15: Devijimi standard i vlerës z (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 377
D.1.4. Vëzhgimet 378
Tabela DQ.4.2: Vëzhgimi i dokumenteve të vaksinimit në shtëpi dhe në institucione shëndetësore 378
Tabela DQ.4.3: Vëzhgimi i certifikatave të lindjes 379
D.1.5. Vijueshmëria në shkollë 380
Tabela DQ.5.1: Vijueshmëria në shkollë sipas çdo moshe 380
D.1.6. Historia e lindjeve 381
Tabela DQ.6.1: Raporti gjinor në lindje në mesin e fëmijëve të lindur ndonjëherë dhe ata të gjallë 381
Tabela DQ.6.2: Lindjet sipas periudhave para anketës 382
Tabela DQ.6.3: Raportimi i moshës së vdekjes në ditë 383
Tabela DQ.6.4: Raportimi i moshës së vdekjes në muaj 384
D.1.7. Metadata të intervistës 385
Tabela DQ.8.1: Gjuhët e intervistës 385
Tabela DQ.8.2: Privatësia gjatë intervistës 386
D.1.8. Pëlqimi për rikontaktim 387
Tabela DQ.9.1: Disponueshmëria e telefonit dhe pëlqimi për një anketë të mundshme pasuese 387
D.2 Tabelat e cilësisë së të dhënave për MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 388
D.2.1. Shpërndarja e moshës 388
Tabela DQ.1.1R: Shpërndarja e popullatës së ekonomive familjare sipas moshës 388
Tabela DQ.1.2WR: Shpërndarja e femrave të kualifikuara dhe të intervistuara sipas moshës 389
Tabela DQ.1.2MR: Shpërndarja e meshkujve të kualifikuar dhe të intervistuar sipas moshës 390
Tabela DQ.1.3R: Shpërndarja e fëmijëve të vegjël në ekonomitë familjare dhe pyetësorët për moshën nën 5 vjeç sipas moshës 391
Tabela DQ.1.4R: Shpërndarja e fëmijëve të moshës 3-20 vjeç në ekonomitë familjare dhe pyetësorët 5-17 sipas moshës 392
D.2.2. Raportimi i datës së lindjes dhe moshës 393
Tabela DQ.2.1R: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (anëtarët e ekonomisë familjare) 393
Tabela DQ.2.2WR: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (femra) 394
Tabela DQ.2.2MR: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (meshkuj) 395
Tabela DQ.2.3R: Raportimi i datës së lindjes (lindjet e gjalla) 396
Tabela DQ.2.4R: Raportimi i datës së lindjes dhe moshës (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 397

Tabela DQ.2.5R: Shpërndarja e datës së lindjes (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 398
Tabela DQ.2.6R: Raportimi i datës së lindjes (fëmijët e moshës 5-17 vjeç) 399
Tabela DQ.2.7R: Shpërndarja e datës së lindjes (fëmijët e përzgjedhur të moshës 5-9 vjeç) 400
D.2.3. Kompletimi dhe matjet 401
Tabela DQ.3.2WR: Kompletimi i informatave për datat e martesës/bashkëjetesës (femra) 401
Tabela DQ.3.2MR: Kompletimi i informatave për datat e martesës/bashkëjetesës (meshkuj) 402
Tabela DQ.3.4R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për moshë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 403
Tabela DQ.3.5R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Gjatësia për moshë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 404
Tabela DQ.3.6R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për gjatësinë (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 405
Tabela DQ.3.7R: Njëanshmëritë (heaping) në matjet antropometrike (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 406
Tabela DQ.3.8R: Pengesat në matjet antropometrike (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 407
Tabela DQ.3.9R: Devijimi standard i vlerës z (fëmijët nën moshën 5 vjeç) 408
Tabela DQ.3.10R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Pesha për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 409
Tabela DQ.3.11R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: Gjatësia për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 410
Tabela DQ.3.12R: Kompletimi i informatave për treguesit antropometrikë: BMI për moshë (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 411
Tabela DQ.3.13R: Njëanshmëritë (heaping) në matjet antropometrike (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 412
Tabela DQ.3.14R: Pengesat në matjet antropometrike (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 413
Tabela DQ.3.15R: Devijimi standard i vlerës z (fëmijët e moshës 5-9 vjeç) 414
D.2.4. Vëzhgimet 415
Tabela DQ.4.2R: Vëzhgimi i dokumenteve të vaksinimit në shtëpi dhe në institucione shëndetësore 415
Tabela DQ.4.3R: Vëzhgimi i certifikatave të lindjes 416
D.2.5. Vijueshmëria në shkollë 417
Tabela DQ.5.1R: Vijueshmëria në shkollë sipas çdo moshe 417
D.2.6. Historia e lindjeve 418
Tabela DQ.6.1R: Raporti gjinor në lindje në mesin e fëmijëve të lindur ndonjëherë dhe ata të gjallë 418
Tabela DQ.6.2R: Lindjet sipas periudhave para anketës 419
Tabela DQ.6.3R: Raportimi i moshës së vdekjes në ditë 420
Tabela DQ.6.4R: Raportimi i moshës së vdekjes në muaj 421
D.2.7. Metadata të intervistës 422
Tabela DQ.8.1R: Gjuhët e intervistës 422
Tabela DQ.8.2R: Privatësia gjatë intervistës 423
D.2.8. Pëlqimi për rikontaktim 424
Tabela DQ.9.1R: Disponueshmëria e telefonit dhe pëlqimi për një anketë të mundshme pasuese 424

Shtojca E Pyetësorët e MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 425

E.1 Pyetësori për ekonomi familjare 426
E.2 Pyetësori për femra 15-49 vjeç 452
E.3 Pyetësori për meshkuj 15-49 vjeç 471
E.4 Pyetësori për fëmijët nën pesë vjeç 483
E.4.1. Formulari i regjistrimit të vaksinimeve të bazuara në institucion 511
E.5 Pyetësori për fëmijët dhe adoleshentët e moshës 5-17 vjeç 515

LISTA E SHKURTESAVE

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BCG	Bacili Calmette-Guérin (tuberkulozi)
BMI	Indeksi i masës trupore
CAPI	Intervistimi personal i asistuar nga kompjuteri
CSPro	Sistemi i përpunimit të të dhënave të regjistrimeve të popullsisë dhe anketave
DIRC	Interpretimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit (punëtori)
DTP	Difteria, tetanosi dhe pertusi
ECARO	Zyra Rajonale e UNICEF-it për Evropë dhe Azi Qendrore
ECDI2030	Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030
EFH	Edukimi në fëmijërinë e hershme
EU-SILC	Statistikat e Bashkimit Evropian për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës
FKEE	Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë
GPS	Sistemi global i pozicionimit
HepB	Hepatiti B
Hib	Haemophilus influenzae tipi b
HML	Health Media Lab
HPV	Virusi i papillomës humane
IBGj	Indeksi i barazisë gjinore
IKShP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IPV	Vaksina e inaktivuar kundër poliomielitit
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
IYCF	Ushqyerja e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël
JMP	Programi i Përbashkët i Monitorimit i OBSH-së/UNICEF-it për furnizimin me ujë, sanitari dhe higjienë
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LPG	Gaz i lëngshëm i naftës
MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MICS	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë
MICS7	Raundi i shtatë global i programit të Anketave të Treguesve të Shumëfishtë
MMR	Fruthi, shytat dhe rubeola
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NjKM	Njësia kryesore e mostrimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ(-të)	Organizatë joqeveritare (organizata joqeveritare)
OPV	Vaksina orale kundër poliomielitit
PCV	Vaksina e konjuguar kundër pneumokokut
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PUL	Pesha e ulët në lindje
QR	Qark regjistrues
RME	Margjina relative e gabimit
SDG(-të)	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm)
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim

SPSS	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale
ShBL	Shkalla bruto e lindjeve
ShFSM(-të)	Shkalla e fertilitetit specifike për moshën (shkallët e fertilitetit specifike për moshën)
ShGF	Shkalla e përgjithshme e fertilitetit
ShNV	Shkalla neto e vijueshmërisë e adaptuar
ShTF	Shkalla totale e fertilitetit
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
TKT(-të)	Tabela e kontrollit në terren (tabelat e kontrollit në terren)
UN	Kombet e Bashkuara
UN DESA	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështje Ekonomike dhe Sociale
UNDCO	Zyra e Koordinatorit për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VN	Vdekshmëria neonatale
VNN	Vdekshmëria post-neonatale
WASH	Uji, sanitari dhe higjiena
ZPS	Zyra e Planifikimit Strategjik
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

FALËNDERIMET

Realizimi i Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ishte një ndërmarrje e rëndësishme, e cila kërkoi koordinim dhe bashkëpunim të gjerë ndërmjet shumë akterëve të përfshirë. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dëshiron t'u shprehë mirënjohjen dhe t'i falënderojë të gjithë ata që kontribuuan, pasi përfundimi me sukses i të dyja anketave dhe përgatitja e këtij raporti janë rezultat i përpjekjeve të tyre të përbashkëta.

Realizimi i anketave u mundësua përmes mbështetjes financiare të Qeverisë së Kosovës, Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim – Ambasadës së Zvicrës në Kosovë, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDCO) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

Dëshirojmë t'i falënderojmë anëtarët e Komitetit Teknik të MICS për këshillat dhe udhëzimet e tyre gjatë realizimit të anketave: Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Zyrën e Planifikimit Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASh), Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShP), Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Drejtësisë (MD), Institucionin e Avokatit të Popullit, Universitetin e Prishtinës, Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF dhe UNICEF-in.

Gjithashtu, falënderojmë stafin dhe konsulentët e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Zyrës Rajonale të UNICEF-it për Evropë dhe Azi Qendrore (ECARO) dhe Ekipit Global të MICS në Zyrën Qendrore të UNICEF-it për mbështetjen e tyre teknike gjatë gjithë anketave.

Mirënjohje e veçantë u shprehet intervistuesve, matësve, mbikëqyrësve dhe ekipeve të listimit të MICS për përkushtimin dhe angazhimin e tyre në mbledhjen e të dhënave.

ASK-ja dëshiron t'u shprehë mirënjohjen e saj të gjithë individëve dhe ekonomive familjare në mbarë Kosovën, të cilët i mirëpritën me bujari ekipet tona në shtëpitë e tyre dhe ofruan kohën dhe vëmendjen e tyre për të mundësuar realizimin e këtyre anketave. Gjetjet e MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, si dhe ky raport, nuk do të ishin të mundura pa pjesëmarrjen e tyre – atyre u shprehim mirënjohjen tonë më të thellë.

Shpresojmë që gjetjet e paraqitura në këtë raport – dhe të dhënat e MICS në kuptim më të gjerë – të ndihmojnë në orientimin e politikave dhe vendimmarrjes drejt përmirësimit të jetës së të gjithë fëmijëve dhe femrave në Kosovë.

1 HYRJE

Ky raport bazohet në Anketën e Treguesve të Shumëfishtë (MICS) për Kosovë dhe MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, të realizuara në vitin 2025 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Anketat ofrojnë të dhëna statistikisht të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e politikave dhe programeve të bazuara në dëshmi, si dhe për monitorimin e progresit drejt qëllimeve kombëtare dhe zotimeve globale.

Zotimi për veprim: Përgjegjësitë kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit

Më shumë se dy dekada më parë, **Plani i Veprimit për Zbatimin e Deklaratës Botërore për Mbijetesën, Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve në vitet 1990** bëri thirrje që:

> *"Secili vend duhet të krijojë mekanizma të përshtatshëm për mbledhjen, analizën dhe publikimin e rregullt dhe në kohë të të dhënave të nevojshme për monitorimin e treguesve përkatës shoqërorë që lidhen me mirëqenien e fëmijëve.... Treguesit e zhvillimit njerëzor duhet të rishikohen periodikisht nga udhëheqësit dhe vendimmarrësit kombëtarë, ashtu siç bëhet aktualisht me treguesit e zhvillimit ekonomik..."*

Programi i Anketave të Treguesve të Shumëfishtë u zhvillua pak kohë më pas, në mesin e viteve 1990, për t'i mbështetur vendet në këtë përpjekje.

Qeveritë që nënshkruan **Deklaratën dhe Planin e Veprimit "Një botë e përshtatshme për fëmijët"** u zotuan gjithashtu për monitorimin e progresit drejt qëllimeve dhe objektivave:

> *"Ne do të monitorojmë rregullisht në nivel kombëtar dhe, sipas rastit, në nivel rajonal, si dhe do të vlerësojmë progresin drejt qëllimeve dhe objektivave të këtij Plani të Veprimit në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Rrjedhimisht, do të forcojmë kapacitetet tona kombëtare statistikore për mbledhjen, analizimin dhe zbërthimin e të dhënave, përfshirë sipas gjinisë, moshës dhe faktorëve të tjerë përkatës që mund të shkaktojnë pabarazi, si dhe do të mbështesim një gamë të gjerë hulumtimesh me fokus fëmijët" (**Një botë e përshtatshme për fëmijët**, paragrafi 60)*

Në mënyrë të ngjashme, **Deklarata e Mijëvjeçarit** (paragrafi 31) bëri thirrje për raportim periodik mbi progresin:

> *"...Ne i kërkojmë Asamblesë së Përgjithshme që të rishikojë rregullisht progresin e arritur në zbatimin e dispozitave të kësaj Deklarate dhe i kërkojmë Sekretarit të Përgjithshëm të nxjerrë raporte periodike për shqyrtim nga Asambleja e Përgjithshme dhe si bazë për veprime të mëtejshme."*

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, e miratuar më 25 shtator 2015, **"Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm"**, përcakton se, për suksesin e agjendës universale të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve),

> *"do të nevojiten të dhëna cilësore, të qasshme, në kohë, të besueshme dhe të zbërthyera për të ndihmuar në matjen e progresit dhe për të siguruar që askush të mos mbetet prapa" (paragrafi 48); pranon se "...të dhënat bazë për disa prej objektivave vazhdojnë të jenë të padisponueshme..." dhe bën thirrje për "...forcimin e mbledhjes së të dhënave dhe ngritjen e kapaciteteve në Shtetet Anëtare..."*

Mungesa e të dhënave të përditësuara dhe të besueshme për të informuar vendimmarrjen e bazuar në dëshmi vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova sot. Kjo pengon monitorimin efektiv të progresit drejt përmirësimit të rezultateve për grupe të caktuara të popullsisë, përfshirë pakicat, vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe personat e prekur nga migrimi.

Dy raundet e mëparshme të MICS, të realizuara në vitet 2013–2014 dhe 2019–2020 me popullsinë e përgjithshme dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, siguruan një burim gjithëpërfshirës dhe të përdorur gjerësisht të të dhënave për fëmijët. Këto të dhëna luajtën rol thelbësor në hartimin e strategjive dhe programeve kryesore kombëtare, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijës 2019–2023, Planin Strategjik të Arsimit 2022–2026 dhe strategji të tjera sektoriale. Të dhënat e MICS luajtën gjithashtu rol vendimtar në orientimin e vendimeve të rëndësishme për financim dhe investimeve zhvillimore në Kosovë, përfshirë alokimet e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) dhe investimet e Qeverisë në edukimin në fëmijërinë e hershme, imunizim dhe fusha të tjera prioritare.

Pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës të Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në vitin 2018 dhe themelimit të Këshillit për SDG-të për të koordinuar ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përkatëse përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e SDG-ve, të dhënat e MICS 2025, si për popullsinë e përgjithshme, ashtu edhe për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, do të ofrojnë dëshmi thelbësore për të informuar më tej agjendën kombëtare të zhvillimit dhe për të monitoruar progresin drejt arritjes së SDG-ve në Kosovë.

MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë kanë këto objektiva kryesore:

- Të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë për vlerësimin e gjendjes së fëmijëve, adoleshentëve, femrave dhe ekonomive familjare në Kosovë;
- Të sigurojnë të dhënat e nevojshme për monitorimin e progresit drejt qëllimeve kombëtare, si bazë për veprime të ardhshme;
- Të mbledhin të dhëna të zbërthyera për identifikimin e pabarazive, me qëllim informimin e politikave që synojnë përfshirjen sociale të personave më të cenueshëm;
- Të validojnë të dhënat nga burime të tjera dhe rezultatet e ndërhyrjeve të fokusuara;
- Të gjenerojnë të dhëna për treguesit kombëtarë dhe globalë të SDG-ve;
- Të gjenerojnë të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht për vlerësimin e progresit të arritur në fusha të ndryshme dhe për të ndërmarrë përpjekje shtesë në fushat që kërkojnë më shumë vëmendje;
- Të gjenerojnë të dhëna për sjelljet dhe qëndrimet, të cilat nuk janë të disponueshme nga burime të tjera të të dhënave.

Ky raport paraqet rezultatet e MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Tabelat që paraqesin gjetjet e MICS 2025 për Kosovë kanë tituj me ngjyrë të zezë, ndërsa tabelat që paraqesin gjetjet e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë kanë tituj me ngjyrë të kaltër.

Pas Kapitullit 2 mbi organizimin dhe metodologjinë e anketës, përfshirë dizajnin dhe zbatimin e mostrës, të gjithë treguesit e mbuluar nga anketat, së bashku me përkufizimet e tyre, paraqiten në Kapitullin 3, "Treguesit dhe përkufizimet". Para paraqitjes së rezultateve të anketës, të organizuara në kapituj tematikë, mbulimi i mostrës dhe karakteristikat kryesore të respondentëve trajtohen në Kapitullin 4, "Mbulimi i mostrës dhe karakteristikat e respondentëve".

Duke filluar nga Kapitulli 5, të gjitha rezultatet e anketës paraqiten në shtatë kapituj tematikë. Në secilin kapitull, një hyrje e shkurtër për temën dhe përshkrimi i të gjitha tabelave pasohen nga tabulimet. Kapitulli 5, "Mbijetesa", përfshin gjetjet mbi vdekshmërinë e fëmijëve nën moshën 5 vjeç.

Ky pasohet nga Kapitulli 6, "Zhvillimi – Shëndeti riprodhues, i nënës, i të porsalindurve dhe i të rriturve", i cili paraqet gjetjet mbi fertilitetin, lindjen e hershme të fëmijëve, përdorimin e kontraceptivëve dhe kujdesin antenatal.

Kapitulli pasues, Kapitulli 7, "Zhvillimi – Shëndeti, ushqyerja dhe zhvillimi i fëmijëve", paraqet gjetjet mbi imunizimin në fëmijërinë e hershme, ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, kequshqyerjen, zhvillimin në fëmijërinë e hershme dhe indeksin e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.

"Të mësuarit dhe fitimi i shkathtësive" është tema e Kapitullit 8, ku trajtohen gjetjet e anketës mbi edukimin në fëmijërinë e hershme dhe vijueshmërinë.

Kapitulli pasues, Kapitulli 9, "Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi", përfshin rezultatet e anketës mbi regjistrimin e lindjeve, disiplinimin e fëmijëve, fëmijët në punë, martesën e fëmijëve dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje.

Kapitulli 10, "Jetesa në mjedis të sigurt dhe të pastër", mbulon temat e ujit të pijshëm dhe sanitarisë.

Kapitulli i fundit tematik, Kapitulli 11, trajton barazinë. I titulluar "Mundësitë e barabarta në jetë", kapitulli paraqet gjetjet mbi një sërë temash që lidhen me barazinë, përfshirë funksionimin e fëmijëve, transferet sociale, diskriminimin dhe ngacmimin.

Raporti përfundon me shtojcat, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme mbi dizajnin e mostrës, personelin e përfshirë në anketa, vlerësimet e gabimeve të mostrimit, cilësinë e të dhënave dhe pyetësorët e përdorur.

2 ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA E ANKETËS

2.1 ORGANIZIMI I ANKETËS

MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë u realizuan nga një Ekip për Menaxhimin e Anketës, i formuar dhe i udhëhequr nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Vendimet dhe proceset teknike u orientuan dhe u mbështetën nga Komiteti Teknik.[3] Ekipi Global i MICS i UNICEF-it ofroi mbështetje dhe shqyrtime në terren dhe nga distanca gjatë fazave kryesore të anketës, në përputhje me Kornizën standarde të Bashkëpunimit Teknik të programit global MICS dhe Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet ASK-së dhe UNICEF-it.

2.2 DIZAJNI I MOSTRËS

Objektivi kryesor i dizajnit të mostrës është të prodhojë vlerësime statistikisht të besueshme për treguesit kryesorë në nivel kombëtar, urban dhe rural. Gjithashtu, duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta socio-demografike, u prodhuan vlerësime të veçanta edhe për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Për këtë arsye, u përdor një qasje dyfazëshe e mostrimit të stratifikuar në grupime, me dy mostra të pavarura: njëra përfaqësuese e popullsisë së përgjithshme dhe tjetra për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Mostra për Kosovë

Mostra e MICS 2025 për Kosovë u dizajnua për të prodhuar vlerësime për një numër të madh treguesish mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave në nivel kombëtar, si dhe për vendbanimet urbane dhe rurale. Vendbanimet urbane dhe rurale brenda secilit prej shtatë rajoneve administrative, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë, u përcaktuan si shtresat kryesore të mostrimit, ndërsa mostra e ekonomive familjare u përzgjodh në dy faza. Brenda secilës shtresë, një numër i caktuar i qarqeve regjistruese (QR) të Regjistrimit të Popullsisë u përzgjodh në mënyrë sistematike, me probabilitet proporcional me madhësinë. Pas realizimit të listimit të ekonomive familjare në qarqet regjistruese të përzgjedhura, në secilin qark regjistrues të mostrës u përzgjodh një mostër sistematike prej 20 ekonomish familjare. Madhësia e përgjithshme e mostrës për MICS 2025 për Kosovë u llogarit në 7.320 ekonomi familjare, me gjithsej 366 QR të përzgjedhura në fazën e parë të mostrimit. Meqenëse mostra nuk është e vetëpeshuar, për raportimin e rezultateve të anketës përdoren peshat e mostrës. Një përshkrim më i hollësishëm i dizajnit të mostrës mund të gjendet në Shtojcën A: Dizajni i mostrës.

Mostra për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Mostra e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë u dizajnua për të prodhuar vlerësime për një numër të madh treguesish mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave në nivel kombëtar, si dhe për vendbanimet urbane dhe rurale. Njësitë kryesore të mostrimit (NjKM) të përzgjedhura në fazën e parë ishin QR-të e Regjistrimit të Popullsisë 2024 që kishin të paktën 10 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane. Gjithsej u përzgjodhën 80 QR, prej të cilave 16 QR me 66 ose më shumë ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane u përzgjodhën me probabilitet 1, ndërsa 64 QR-të e mbetura u përzgjodhën në mënyrë sistematike nga pjesa e mbetur e kornizës, me probabilitet proporcional me madhësinë. Të 16 QR-të vetëpërfaqësuese përbënin shtresën e parë, ndërsa 64 QR-të e mbetura përbënin shtresën e dytë. Përzgjedhja urbane/rurale u realizua duke përdorur stratifikim të nënkuptuar brenda secilës prej dy shtresave kryesore.

Pas realizimit të listimit të ekonomive familjare në QR-të e përzgjedhura, me qëllim identifikimin e ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, në secilin QR të mostrës u përzgjodh një mostër sistematike prej 20 ekonomish familjare. Në QR-të me më pak se 20 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, të gjitha ekonomitë familjare u përfshinë në mostër. Një QR nuk kishte asnjë ekonomi familjare Rome, Ashkali ose

[3] Anëtarët e Ekipit për Menaxhimin e Anketës dhe të Komiteteve Teknike janë renditur në Shtojcën B.

Egjiptiane dhe u përjashtua nga mostra. Numri përfundimtar i ekonomive familjare të mostrës për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ishte 1.436. Meqenëse mostra nuk është e vetëpeshuar, për raportimin e rezultateve të anketës përdoren peshat e mostrës. Një përshkrim më i hollësishëm i dizajnit të mostrës mund të gjendet në Shtojcën A.2: Dizajni i mostrës për MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.

2.3 PYETËSORËT

Në anketë u përdorën pesë pyetësorë:

1) një pyetësor për ekonominë familjare, për mbledhjen e informacionit bazë demografik për të gjithë anëtarët *de jure* të ekonomisë familjare (banorët e zakonshëm), ekonominë familjare dhe njësinë e banimit;
2) një pyetësor për femrat, i administruar në secilën ekonomi familjare për të gjitha femrat e moshës 15–49 vjeç;
3) një pyetësor për meshkujt, i administruar në çdo të dytën ekonomi familjare për të gjithë meshkujt e moshës 15–49 vjeç;
4) një pyetësor për fëmijët nën moshën 5 vjeç, i administruar nënave (ose kujdestarëve) të të gjithë fëmijëve nën moshën 5 vjeç që jetonin në ekonominë familjare; ndërsa për të gjithë fëmijët e moshës 0–2 vjeç për të cilët ishte plotësuar Pyetësori për Fëmijët nën Moshën 5 Vjeç, u përdor Formulari i të Dhënave të Vaksinimit në Institucionin Shëndetësor për regjistrimin e vaksinave nga regjistrat e institucioneve shëndetësore; dhe
5) një pyetësor për fëmijët dhe adoleshentët e moshës 5–17 vjeç, i administruar nënës (ose kujdestarit) të një fëmije të moshës 5–17 vjeç, të përzgjedhur rastësisht, që jeton në ekonominë familjare.[4]

[4] Fëmijët e moshës 15–17 vjeç që jetonin pa nënën e tyre dhe pa ndonjë kujdestar të identifikuar në ekonominë familjare u konsideruan të emancipuar dhe Pyetësori për Fëmijët dhe Adoleshentët e Moshës 5–17 Vjeç iu administrua drejtpërdrejt atyre. Ky pyetësor, i riformuluar lehtësisht dhe që përfshin vetëm modulet Të Dhënat e Përgjithshme të Fëmijës, Fëmijët në Punë dhe Funksionimi i Fëmijëve, nuk është përfshirë në Shtojcën E: Pyetësorët.

Pyetësorët përfshinin modulet në vijim:

Pyetësori për ekonominë familjare
Lista e anëtarëve të ekonomisë familjare
Arsimimi: Arritjet arsimore
Arsimimi: Vijueshmëria
Karakteristikat e ekonomisë familjare
Privimi material
Përdorimi i energjisë në ekonominë familjare
Transferet sociale
Uji
Sanitaria

Pyetësori për femrat e moshës 15–49 vjeç
Të dhënat e përgjithshme të femrës
Sigurimi shëndetësor
Fertiliteti/Historia e lindjeve
Kujdesi antenatal
Fillimi i gjidhënies
Kontracepsioni
Qëndrimet ndaj dhunës në familje
Diskriminimi
Martesa/Bashkëjetesa

Pyetësori për fëmijët dhe adoleshentët e moshës 5–17 vjeç
Të dhënat e përgjithshme të fëmijës
Sigurimi shëndetësor
Fëmijët në punë
Disiplinimi i fëmijëve
Funksionimi i fëmijëve
Antropometria

Pyetësori për meshkujt e moshës 15–49 vjeç
Të dhënat e përgjithshme të mashkullit
Sigurimi shëndetësor
Qëndrimet ndaj dhunës në familje
Diskriminimi
Martesa/Bashkëjetesa

Pyetësori për fëmijët nën moshën 5 vjeç
Të dhënat e përgjithshme të fëmijës nën moshën 5 vjeç
Sigurimi shëndetësor
Regjistrimi i lindjes
Zhvillimi në fëmijërinë e hershme
Disiplinimi i fëmijëve
Funksionimi i fëmijëve
Gjidhënia dhe marrja e ushqimeve
Imunizimi
Antropometria
Formulari i të Dhënave të Vaksinimit në Institucionin Shëndetësor

Përveç administrimit të pyetësorëve, ekipet e punës në terren matën peshën dhe gjatësinë e fëmijëve nën moshën 5 vjeç dhe të fëmijëve të moshës 5–9 vjeç. Hollësitë dhe gjetjet e këtyre matjeve paraqiten në seksionet përkatëse të raportit.

Modulet dhe pyetjet specifike të anketës

Modulet dhe pyetjet në vijim, të cilat nuk janë pjesë e pyetësorëve standardë globalë të MICS7, u përfshinë bazuar në nevojat kombëtare:

Pyetësori për ekonominë familjare

Karakteristikat e ekonomisë familjare dhe privimi material: Një përzgjedhje pyetjesh nga Statistikat e Bashkimit Evropian për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (EU-SILC), të përdorura për vlerësimin e privimit material, iu shtuan modulit Karakteristikat e Ekonomisë Familjare dhe u përfshinë si modul i veçantë për Privimin Material, për të plotësuar llogaritjen e indeksit të pasurisë.

Pyetësori për femrat e moshës 15–49 vjeç

Kujdesi antenatal: Ky modul përfshinte pyetje specifike të anketës për përmbajtjen e kujdesit antenatal, konkretisht për matjen e lartësisë së mitrës dhe ekzaminimin me ultrazë.

Pyetësorët u bazuan në pyetësorët standardë të MICS7.[5] Duke u nisur nga versioni model i MICS7 në gjuhën angleze, pyetësorët u përshtatën dhe u përkthyen në gjuhën shqipe dhe serbe dhe më pas u testuan paraprakisht

[5] https://mics.unicef.org/tools#survey-design

në rajonin e Prishtinës gjatë periudhës qershor–korrik 2025. Testimi paraprak u realizua së bashku me testimin e aplikacionit CAPI, pasi që nga MICS 2019–2020 nuk ishte përfshirë asnjë modul i ri. Bazuar në rezultatet e testimit paraprak, u bënë ndryshime në formulimin dhe përkthimin e pyetësorëve. Një kopje e pyetësorëve të MICS 2025 për Kosovë paraqitet në Shtojcën E.

2.4 ETIKA

Protokolli i mbrojtjes për MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë identifikoi rreziqet gjatë gjithë ciklit të anketës në fushat në vijim: dëmet dhe përfitimet e mundshme për pjesëmarrësit, procesi i pëlqimit të informuar, privatësia dhe konfidencialiteti, rreziqet për intervistuesit, si dhe trajtimi i ankesave dhe shqetësimeve të pjesëmarrësve. Protokolli përcaktoi gjithashtu masat dhe procedurat e miratuara për trajtimin ose zbutjen e këtyre rreziqeve. Ai u hartua dhe u shqyrtua si pjesë e procesit më të gjerë të sigurimit të cilësisë së anketës nga Komitetet Teknike të MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Plani i anketës, pyetësorët dhe protokolli i mbrojtjes iu nënshtruan shqyrtimit etik dhe u miratuan nga Bordi i Shqyrtimit Institucional i Laboratorit të Medias së Shëndetit (ang. Health Media Lab – HML) në gusht 2025.

2.4.1 PROCEDURAT E PËLQIMIT TË INFORMUAR

Pëlqimi verbal i informuar u mor nga të gjithë respondentët. Para intervistimit të adoleshentëve, nga respondenti i Pyetësorit për Ekonominë Familjare u mor gjithashtu leja për intervistimin e anëtarëve të ekonomisë familjare të moshës 15–17 vjeç.

Si pjesë e procesit të pëlqimit të informuar, të gjithë respondentët u informuan për qëllimin e anketës, se pjesëmarrja ishte vullnetare, se përgjigjet e tyre do të mbeteshin konfidenciale dhe anonime dhe se kishin të drejtë të refuzonin t'i përgjigjeshin çdo pyetjeje ose ta ndërprisnin intervistën në çdo kohë.

Në përfundim të secilit pyetësor, respondentët u ftuan të jepnin pëlqimin verbal për të marrë pjesë në një anketë vijuese të realizuar përmes telefonit. Ata u informuan se pjesëmarrja ishte tërësisht vullnetare, se informacioni i tyre do të mbetej anonim dhe se kishin të drejtë të tërhiqeshin në çdo kohë. Nëse jepej pëlqimi, respondentëve u kërkohej të jepnin numrin e tyre personal të telefonit ose numrin e përbashkët të telefonit të ekonomisë familjare, me udhëzimin e qartë që të mos jepnin numra telefoni që u përkisnin anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare ose personave jashtë ekonomisë së tyre familjare.

2.4.2 MBROJTJA E TË DHËNAVE

Gjatë mbledhjes së të dhënave, tabletët e përdorur për regjistrimin e intervistave mbrohen me fjalëkalim dhe janë të pajisur me protokolle të enkriptimit për të garantuar sigurinë e të gjitha përgjigjeve të regjistruara. Të dhënat transmetohen në mënyrë të sigurt në serverin qendror duke përdorur platformën CSWeb të CSPro-së (Sistemi i Përpunimit të Regjistrimeve të Popullsisë dhe Anketave), e cila mundëson transferimin e enkriptuar të të dhënave përmes kanaleve të sigurta. Pas pranimit, të dhënat ruhen në serverë të mbrojtur me qasje të kufizuar. Para çdo analize ose shpërndarjeje, grupi i të dhënave i nënshtrohet një procesi sistematik të anonimizimit. Ky proces përfshin largimin e çdo informacioni personalisht identifikues ose konfidencial, duke ruajtur të gjitha variablat e bazuara në pyetësor që janë të nevojshme për analiza statistikore të vlefshme.[6]

2.5 METODA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Anketat MICS përdorin Intervistimin Personal të Asistuar nga Kompjuteri (CAPI). Aplikacioni për mbledhjen e të dhënave u bazua në programin CSPro, Versioni 7.7.3, duke përfshirë një platformë të dedikuar për MICS për

[6] Për hollësi të mëtejshme mbi anonimizimin dhe ndarjen e të dhënave, shihni gjithashtu Seksionin 2.11 më poshtë.

menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave, të zhvilluar në Power BI dhe të integruar në platformën Microsoft Teams. Procedurat dhe programet standarde[7] të zhvilluara në kuadër të programit global MICS u përshtatën me pyetësorët përfundimtarë të MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë dhe u përdorën gjatë gjithë procesit. Pyetësorët dhe aplikacioni CAPI u testuan në rajonin e Prishtinës, në Lipjan – zonë gjysmë-urbane, Graçanicë – zonë urbane dhe Fushë Kosovë – zonë rurale, nga 26 qershori deri më 4 korrik 2025. Bazuar në rezultatet e testimit të kombinuar paraprak dhe të testimit të CAPI-t, u bënë ndryshime në pyetësorë dhe në aplikacion.

2.6 TRAJNIMI

Trajnimi për punën në terren u realizua për 23 ditë gjatë periudhës gusht–shtator 2025. Trajnimi përfshiu ligjërata mbi teknikat e intervistimit dhe përmbajtjen e pyetësorëve, si dhe intervista simuluese ndërmjet pjesëmarrësve në trajnim, për të fituar përvojë praktike në parashtrimin e pyetjeve. Pjesëmarrësit fillimisht përfunduan trajnimin e plotë për pyetësorët në letër, të pasuar nga trajnimi për aplikacionin CAPI. Pjesëmarrësit në trajnim kaluan dy ditë në praktikë në terren dhe dy ditë në një anketë të plotë pilot në rajonin e Prishtinës. Agjenda e trajnimit u bazua në shabllonin e agjendës së trajnimit të MICS7[5].

Të gjithë matësit ndoqën trajnime të posaçme. Për antropometrinë, trajnimi zgjati gjithsej pesë ditë, duke përfshirë dy ditë praktikë në terren dhe në institucione, teste të veçanta të standardizimit[8], dhe anketën pilot. Nga 13 pjesëmarrësit e trajnuar si matës, për punën në terren të anketës u përzgjodhën gjithsej 11 matës, bazuar në performancën e tyre.

Mbikëqyrësit në terren ndoqën trajnim shtesë mbi detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrjes së ekipit.

2.7 PUNA NË TERREN

Të dhënat u mblodhën nga 11 ekipe; secili ekip përbëhej nga katër intervistues (tri intervistuese femra dhe një intervistues mashkull), një vozitës, një matës dhe një mbikëqyrës. Puna në terren filloi më 8 shtator 2025 dhe përfundoi më 16 dhjetor 2025. Për shkak të problemeve të performancës të identifikuara gjatë monitorimit në terren, dy ekipe u shpërndanë në fund të tetorit, ndërsa anëtarët me performancën më të mirë u integruan në ekipet e mbetura.

Të dhënat u mblodhën duke përdorur kompjuterë tabletë me sistemin operativ Android 14 dhe një aplikacion Bluetooth për operacionet në terren, i cili mundësonte transferimin e detyrave dhe pyetësorëve të përfunduar ndërmjet tabletëve të mbikëqyrësve dhe intervistuesve.

[7] http://mics.unicef.org/tools#data-processing

[8] Testet e standardizimit janë matje të strukturuara të një grupi fëmijësh, ku secili pjesëmarrës në trajnim mat secilin fëmijë. Kjo u mundëson trajnerëve ekspertë t'i vlerësojnë në mënyrë sasiore pjesëmarrësit në trajnim, duke krahasuar rezultatet e testimit ndërmjet tyre dhe me matjet e ekspertëve. Këto teste shërbejnë gjithashtu si mundësi për vëzhgime më cilësore, të cilat u mundësojnë trajnerëve ekspertë të korrigjojnë mënyrën e ndërveprimit me fëmijët dhe nënat, respektimin e protokolleve të matjes dhe të theksojnë rigorozitetin e nevojshëm për çdo matje, edhe kur kushtet nuk janë ideale.

2.8 MASAT E KONTROLLIT TË CILËSISË SË PUNËS NË TERREN

Mbikëqyrësit e ekipeve ishin përgjegjës për monitorimin e përditshëm të punës në terren. Në secilin grupim u zbatua detyrimisht riintervistimi i një ekonomie familjare. Çdo ditë u realizuan vëzhgime të aftësive dhe performancës së intervistuesve.

Gjatë periudhës së punës në terren, secili ekip u vizitua disa herë nga anëtarët e Ekipit për Menaxhimin e Anketës, ndërsa u organizuan edhe vizita në terren për anëtarët e Ekipit të MICS të UNICEF-it.

Gjatë gjithë punës në terren, tabelat e kontrollit në terren (TKT) u prodhuan çdo javë për analizë dhe ndërmarrje veprimesh me ekipet në terren. TKT-të ishin versione të përshtatura të tabelave standarde të prodhuara nga Programi MICS.[9]

Përveç kësaj, Ekipi për Menaxhimin e Anketës përdori përmbledhje të të dhënave në kohë reale përmes panelit të kontrollit, si dhe monitorim të hollësishëm të performancës së intervistuesve. Të dyja këto ishin qasje të reja për zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së të dhënave, të zhvilluara nga Programi MICS.

2.9 MENAXHIMI DHE EDITIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat u pranuan në zyrën e ASK-së përmes CSWeb, një sistem për menaxhimin e të dhënave i bazuar në internet, i dizajnuar për të funksionuar me CSPro dhe i integruar në aplikacionin e menaxhimit në tabletët e mbikëqyrësve. Kurdo që ishte e mundur nga aspekti logjistik, sinkronizimi kryhej çdo ditë. Zyra qendrore ua komunikonte ekipeve në terren përditësimet e aplikacionit përmes këtij sistemi.

Gjatë mbledhjes së të dhënave dhe pas përfundimit të punës në terren, të dhënat editoheshin sipas procesit të editimit të përshkruar hollësisht në Udhëzuesin për Editimin e të Dhënave, një version i përshtatur i dokumentacionit standard të MICS.[7]

2.10 ANALIZA DHE RAPORTIMI

Peshat e mostrës dhe karakteristikat e përgjithshme u llogaritën dhe iu shtuan të dhënave përfundimtare. Analiza u realizua duke përdorur programin Paketa Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS), versioni 25. Për këtë qëllim u përshtatën dhe u përdorën sintaksa model dhe plani i tabulimit të zhvilluara nga UNICEF-i.[10]

Raporti i Gjetjeve të Anketës dhe pasqyrat e shkurtra informative statistikore shoqëruese u hartuan bazuar në shabllonet e zhvilluara nga programi global MICS.[11] Ato iu paraqitën ekspertëve të fushave përkatëse dhe u shqyrtuan prej tyre gjatë Punëtorisë për Interpretimin e të Dhënave dhe Përpilimin e Raportit (DIRC), të mbajtur në Prishtinë më 20–24 prill 2026. Finalizimi i Raportit të Gjetjeve të Anketës dhe pasqyrave të shkurtra informative statistikore u menaxhua nga Ekipi për Menaxhimin e Anketës, me udhëzimin e Komitetit Teknik dhe të pjesëmarrësve në Punëtorinë DIRC.

2.11 NDARJA TË DHËNAVE

Identifikuesit unikë, si vendndodhja dhe të dhënat personale të mbledhura gjatë intervistave, u hoqën nga grupet e të dhënave për të siguruar privatësinë.[12] Këta skedarë të anonimizuar të të dhënave vihen në dispozicion në faqen e internetit të MICS [13] dhe mund të shkarkohen lirisht për qëllime legjitime kërkimore. Përdoruesve u

[9] http://mics.unicef.org/tools#data-collection
[10] http://mics.unicef.org/tools#analysis
[11] http://mics.unicef.org/tools#reporting
[12] Shihni gjithashtu Seksionin 2.4.2 më sipër për mbrojtjen e të dhënave.
[13] https://mics.unicef.org/surveys

kërkohet t'ua dërgojnë punimin përfundimtar kërkimor subjekteve të renditura në skedarin shoqërues ReadMe, vetëm për qëllime informimi.

Gjeokodi, d.m.th. gjerësia dhe gjatësia gjeografike, është në dispozicion për secilin grupim të anketës. Për të siguruar mbrojtjen e respondentëve, koordinatat GPS (Sistemi Global i Pozicionimit) në nivel grupimi zhvendosen në mënyrë të rastësishme.[14] Gjeokodet e anonimizuara vihen në dispozicion në faqen e internetit të MICS[15], siç tregohet në skedarin ReadMe që shoqëron të dhënat. Zbatohen kushte të veçanta të përdorimit, siç është paraqitja e fushëveprimit të hulumtimit.

Kufijtë e anketës, d.m.th. kufijtë e fushave gjeografike të raportimit, janë në dispozicion pa pagesë në faqen e internetit të MICS[15].

Përveç kësaj, një grup të dhënash me kovariate gjeohapësinore, i cili përmban tregues mjedisorë, klimatikë, të qasshmërisë dhe socio-ekonomikë, të ndërlidhur me grupimet e anketës dhe me nivelin e Kosovës, është i qasshëm në faqen e internetit të MICS-it[15] për të mbështetur analizat hapësinore dhe kontekstuale. [16]

2.12 STRUKTURA E RAPORTIT

Ky raport paraqet gjetjet nga MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Megjithëse këto janë dy anketa të pavarura, u vendos që gjetjet e tyre të paraqiten së bashku për të lehtësuar përdorimin dhe krahasueshmërinë e të dhënave. Secili kapitull fillon me një hyrje të përbashkët, të pasuar nga seksionet që paraqesin përkatësisht gjetjet nga MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Për të bërë dallimin vizual ndërmjet dy anketave, tabelat e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë hijezuar me një ngjyrë tjetër.

2.13 SI TË LEXOHEN TABELAT

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Arsimimi

Kur arsimimi përdoret si karakteristikë e përgjithshme, nivelet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë përkufizohen në përputhje me klasifikimin aktual të sistemit arsimor të Kosovës: pesë klasë të shkollës fillore, katër klasë të shkollës së mesme të ulët dhe tri klasë të shkollës së mesme të lartë. Në MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, gjetjet për kategorinë e arsimit "I lartë" bazohen kryesisht në më pak se 25 raste të papeshuara, që janë shumë pak për t'u paraqitur veçmas. Prandaj, kjo kategori është kombinuar me kategorinë "I mesëm i lartë" dhe paraqitet si "I mesëm i lartë ose i lartë".

[14] Gashi, N., Burdziej, J. dhe Beshanski-Pedersen, B. Procedurat e zhvendosjes gjeografike dhe shpërndarja e të dhënave të gjeokoduara në Programin e Anketave të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) (ang. Geographic Displacement Procedures and Dissemination of Geocoded Data in the Multiple Indicator Cluster Surveys (MICS) Programme). Dokumente Metodologjike të MICS, nr. 12 Versioni 2), Seksioni i të Dhënave dhe Analitikës, Zyra për Strategji dhe Evidencë, UNICEF. Itali: UNICEF, 2026. MICS Methodological paper 12 (Version 2)_Geographic Displacement Procedures and Dissemination of Geocoded Data in MICS.pdf

[15] https://mics.unicef.org/mics-gis/mics-gis-results

[16] Gashi, N., Burdziej, J., and Beshanski-Pedersen B. Kovariatet gjeohapësinore – procedura e nxjerrjes. Dokumentet Metodologjike të MICS-it, Nr. 13, Seksioni i të Dhënave dhe Analitikës, Divizioni i të Dhënave, Analitikës, Planifikimit dhe Monitorimit, UNICEF. Nju Jork: UNICEF, 2025. Dokumenti Metodologjik i MICS-it Nr. 13, 2025 – Kovariatet gjeohapësinore: Procedurat e nxjerrjes

Grupmoshat

Grupmoshat e paraqitura në këtë raport përfshijnë kufirin e sipërm. Për shembull, grupmosha 15–49 vjeç përfshin personat që kishin mbushur plot 49 vjeç, ndërsa grupmosha 20–23 muaj përfshin fëmijët që kishin mbushur plot 23 muaj.

Përkatësia etnike

Në tabelat e MICS 2025 për Kosovë, kategoritë e përkatësisë etnike, përveç kategorive "Shqiptare" dhe "Serbe", kombinohen në kategorinë "Grupe të tjera etnike" për shkak të numrit të vogël të rasteve të papeshuara. Numri i rasteve për kategoritë individuale paraqitet në Tabelat SR.3.1, SR.5.1, SR.5.1W, SR.5.1M, SR.5.2 dhe SR.5.3. Tabelat e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ndjekin të njëjtin parim, duke kombinuar kategori të ndryshme për shkak të numrit të vogël të rasteve.

Indeksi i pasurisë

Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare dhe supozohet se pasqyron pasurinë afatgjatë bazë, duke i renditur ekonomitë familjare nga më të varfrat te më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas për MICS për Kosovë dhe për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat specifike për secilën mostër. Si rrjedhojë, rezultatet e pasurisë të llogaritura janë specifike për secilën mostër dhe nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme ndërmjet dy anketave. Kur madhësitë e mostrës për kuintilët e indeksit të pasurisë janë shumë të vogla për t'i paraqitur rezultatet veçmas, të dhënat e bazuara në rezultatet e pasurisë të llogaritura për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ndonjëherë bashkohen në dy grupe: 60 përqindëshi më i varfër (tre kuintilët e poshtëm) dhe 40 përqindëshi më i pasur (dy kuintilët e sipërm).

SHENJAT E PËRDORURA NË TABELA

Tabelat përmbajnë gjithashtu shenja të veçanta që përdoren në mënyrë të njëtrajtshme për të treguar si në vijim:

( ): Shifra në kllapa bazohet në 25–49 raste të papeshuara; 125–249 vite ekspozimi të papeshuara të femrave për vlerësimet e fertilitetit; dhe 250–499 vite ekspozimi të papeshuara të personave ndaj rrezikut të vdekjes për vlerësimet e vdekshmërisë.

(*): Ylli në tabela tregon se përqindja ose proporcioni bazohet në më pak se 25 raste të papeshuara; më pak se 125 vite ekspozimi të papeshuara të femrave për vlerësimet e fertilitetit; dhe më pak se 250 vite ekspozimi të papeshuara të personave ndaj rrezikut të vdekjes për vlerësimet e vdekshmërisë.

"–": Viza tregon se nuk kishte raste në kategorinë e caktuar të përgjigjes, d.m.th. emëruesi është i barabartë me 0.

Nuk aplikohet, e shkurtuar si "na", tregon se informacioni nuk paraqitet, sepse pyetja ose kategoria e përgjigjes nuk është relevante për rastin e caktuar.

"W" dhe "M": Shkronjat "W" dhe "M" pas numrit të tabelës tregojnë se ajo i referohet përkatësisht gjetjeve për femrat ose meshkujt nga intervistat individuale me femra dhe meshkuj.

"R": Shkronja "R" pas numrit të tabelës tregon se ajo i referohet mostrës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

3 TREGUESIT DHE PËRKUFIZIMET

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
MBULIMI I MOSTRËS DHE KARAKTERISTIKAT E RESPONDENTËVE							
Treguesit bazë të pyetësorit[21]							
SR.1	Qasja në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike	7.1.1	HC	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare me qasje në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike	SR.2.1	100,0	99,3
SR.18	Modalitetet e jetesës së fëmijëve		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-17 vjeç që jetojnë pa asnjërin prind biologjik	SR.9.1 / SR.9.3	0,5	2,1
SR.19	Prevalenca e fëmijëve me një ose të dy prindërit e vdekur		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-17 vjeç me një ose të dy prindërit biologjikë të vdekur	SR.9.1	1,7	3,9

[17] Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), http://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/. Metadata për treguesit e SDG përditësohen rregullisht. MICS mbulon shumë tregues të SDG me një përputhje të saktë të përkufizimeve të tyre, ndërsa disa tregues mbulohen vetëm pjesërisht. Rastet e fundit përfshihen këtu për sa kohë që metodologjia aktuale ndërkombëtare lejon vetëm përkufizimin e Treguesit MICS dhe/ose një pjesë e rëndësishme e Treguesit SDG mund të gjenerohet nga Treguesi MICS. Për më shumë informacion mbi metadata e treguesve të SDG, shihni http://unstats.un.org/sdgs/metadata/

[18] Disa tregues janë ndërtuar duke përdorur pyetje në më shumë se një temë/modul në pyetësorët MICS. Në raste të tilla, tregohet vetëm tema(t)/moduli(et) që përmbajnë(et) shumicën e informacionit të nevojshëm.

[19] Të gjithë treguesit MICS janë ose mund të ndahen, sipas rastit, sipas kuintileve të pasurisë, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migrimit, aftësisë së kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike (sipas fushave të raportimit) ose karakteristikave të tjera, siç rekomandohet nga Grupi Ndërinstitucional dhe i Ekspertëve për Treguesit e SDG: Korniza globale e treguesve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe synimet e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm

[20] Në raport, numrat e tabelave që përfundojnë me shkronjën "R" i referohen mostrës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

[21] Lista e Treguesve të MICS7 paraqitet sipas kapitujve të Raportit të Gjetjeve të Anketës. Brenda secilit kapitull, lista ndahet në tregues të nxjerrë përmes pyetësorëve bazë dhe ata që janë të disponueshëm përmes temave plotësuese të pyetësorit.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
SR.20	Fëmijët me të paktën një prind që jeton jashtë vendit		HL	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-17 vjeç me të paktën një prind biologjik që jeton jashtë vendit	SR.9.2	5,2	1,3
Treguesit e temave plotësuese të pyetësorit[21]							
SR.601	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për gatim		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që mbështeten kryesisht në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për gatim (që jetojnë në ekonomitë familjare që kanë raportuar se gatuajnë)	SR.6.1	80,4	46,9
SR.602	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për ngrohjen e hapësirës		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që mbështeten kryesisht në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për ngrohjen e hapësirës (që jetojnë në familje që kanë raportuar përdorimin e ngrohjes së hapësirës)	SR.6.3	53,2	16,0
SR.603	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për ndriçim		EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që mbështeten kryesisht në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për ndriçim (që jetojnë në familje që kanë raportuar përdorimin e ndriçimit)	SR.6.4	100,0	99,4
SR.604	Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për gatim, ngrohjen e hapësirës dhe ndriçim	7.1.2	EU	Përqindja e anëtarëve të ekonomisë familjare që mbështeten kryesisht në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për gatimin, ngrohjen e hapësirës dhe ndriçimin[22]	SR.6.5	50,6	15,0

[22]Anëtarët e ekonomise familjare që jetojnë në ekonomi familjare që raportojnë se nuk gatuajnë, nuk përdorin ngrohje të hapësirës ose nuk përdorin ndriçim nuk përjashtohen nga numëruesi.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
MBIJETESA[23]							
CS.1	Shkalla e vdekshmërisë neonatale	3.2.2	BH	Probabiliteti i vdekjes brenda muajit të parë të jetës	CS.1-3	8	15
CS.2	Shkalla e vdekshmërisë post-neonatale		BH	Diferenca ndërmjet shkallës së vdekshmërisë së foshnjave dhe shkallës së vdekshmërisë neonatale	CS.1-3	5	10
CS.3	Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave		CM / BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së parë	CS.1-3	13	25
CS.4	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve		BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet ditëlindjes së parë dhe ditëlindjes së pestë	CS.1-3	0	3
CS.5	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeç	3.2.1	CM / BH	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe ditëlindjes së pestë	CS.1-3	13	28

[23] Treguesit e vdekshmërisë llogariten për periudhën e fundit pesëvjeçare.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
ZHVILLIMI – SHËNDETI RIPRODHUES, I NËNËS, I TË PORSALINDURVE DHE I TË RRITURVE							
Treguesit bazë të pyetësorit[21]							
TM.1a TM.1b	Shkalla e lindjeve tek adoleshentet	3.7.2	CM / BH	Shkalla e fertilitetit specifik për moshën (a) 10-14 vjeç[24] (b) 15-19 vjeç	TM.1.1 TM.1.1-2	0 4	4 64
TM.2	Lindja e fëmijëve në moshë të hershme		CM / BH	Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeç që kanë pasur lindje të gjallë para moshës 18 vjeç	TM.2.2W	0,9	12,7
TM.5a TM.5b TM.5c	Mbulueshmëria e kujdesit antenatal	3.8.1	MN	Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilat gjatë shtatzënisë së lindjes së gjallë më të fundit ishin kontrolluar (a) të paktën një herë nga personeli i kualifikuar shëndetësor (b) të paktën katër herë nga cilido ofrues i kujdesit (c) të paktën tetë herë nga cilido ofrues i kujdesit	TM.5.1 TM.5.2 TM.5.2	98,9 98,0 82,7	98,4 91,5 54,6
TM.6	Përmbajtja e kujdesit antenatal		MN	Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilat gjatë shtatzënisë së lindjes së gjallë më të fundit, të paktën një herë, kanë matur shtypjen e gjakut dhe kanë dhënë mostra të urinës dhe gjakut si pjesë e kujdesit antenatal.	TM.5.3	90,0	88,8
Treguesit e temave plotësuese të pyetësorit[21]							
TM.3	Shkalla e prevalencës kontraceptive		CP	Përqindja e femrave të moshës 15–49 vjeç aktualisht të martuara ose në bashkëjetesë që përdorin (ose partnerët e të cilave përdorin) metoda kontraceptive (moderne ose tradicionale)	TM.3.1	26,1	25,4

[24] Shkallët e lindjeve tek adoleshentet llogariten nga të dhënat e mbledhura përmes modulit Historia e lindjeve në Pyetësorin për femrat, i administruar për të gjitha femrat e moshës 15–49 vjeç. Prandaj, shkallët për grupmoshën 10–14 vjeç llogariten në bazë të të dhënave retrospektive të historisë së lindjeve të femrave të moshës 15–17 vjeç.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
ZHVILLIMI - SHËNDETI, USHQYERJA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE							
Treguesit bazë të pyetësorit[21]							
TC.1	Mbulueshmëria me imunizim kundër tuberkulozit		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë vaksinën që përmban BCG në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	95,6	92,2
TC.2	Mbulueshmëria me imunizim kundër poliomielitit		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë tri doza të vaksinës së inaktivuar kundër poliomielitit (IPV) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	83,3	56,3
TC.3	Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, tetanusit dhe pertusisit (DTaP)	3.b.1 & 3.8.1	IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës që përmban DTaP (DTPa3) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	85,8	56,3
TC.4	Mbulueshmëria me imunizim kundër hepatitit B		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës që përmban hepatitin B (HepB3) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	85,9	58,5
TC.5	Mbulueshmëria me imunizim kundër *Haemophilus influenzae* e tipit b (Hib)		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e tretë të vaksinës që përmban Hib (Hib3) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	83,8	55,6

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.S1	Mbulueshmëria me imunizim kundër pneumokokut (konjuguar)	3.b.1	IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–35 muaj që kanë marrë dozën e dytë të vaksinës së konjuguar kundër pneumokokut (PCV2) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	87,9	61,5
TC.7	Mbulueshmëria me imunizim kundër rotavirusit		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë dozën e dytë të vaksinës kundër rotavirusit (Rota2) në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	80,4	48,5
TC.8	Mbulueshmëria me imunizim kundër rubeolës		IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–35 muaj që kanë marrë vaksinën që përmban rubeolën në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	82,8	56,8
TC.S2	Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit	3.b.1	IM	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–35 muaj që kanë marrë dozën e dytë të vaksinës që përmban fruthin në çfarëdo kohe para anketës	TC.1.1-2	82,8	56,8
TC.11a TC.11b	Mbulueshmëria e plotë me imunizim[25]		IM	Përqindja e fëmijëve të cilët në moshën: a) 12-23 muaj kishin marrë të gjitha imunizimet bazë në çfarëdo kohe para anketës b) 24-35 muaj kishin marrë të gjitha imunizimet e rekomanduara në kalendarin kombëtar të imunizimit	TC.1.1-2	82,5 76,1	56,3 43,5

[25] Vaksinimet bazë përfshijnë: BCG, 3 doza të vaksinës kundër poliomielitit, 3 doza të vaksinës DTP dhe 1 dozë të vaksinës kundër fruthit. Të gjitha vaksinimet përfshijnë të gjitha dozat e vaksinave të rekomanduara për fëmijët nën moshën 3 vjeç në kalendarët e imunizimit që zbatohen në Kosovë, duke përjashtuar rivaksinimet, PCV-në dhe vaksinën kundër rotavirusit; kjo përfshin BCG, 3 doza të vaksinës kundër poliomielitit, 3 doza të vaksinës DTaP, 3 doza të vaksinës Hib, 3 doza të vaksinës HepB dhe nga 1 dozë të vaksinave kundër rubeolës dhe fruthit.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.44a TC.44b	Prevalenca e nënpeshës		AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për moshën sipas standardit të OBSH-së	TC.8.1	1,2 0,2	5,7 0,7
TC.45a TC.45b	Prevalenca e ngecjes në rritje	2.2.1	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të gjatësisë mesatare për moshën sipas standardit të OBSH-së	TC.8.1	4,5 1,3	16,4 3,2
TC.46a TC.46b	Prevalenca e peshës së vogël për gjatësi	2.2.2	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për gjatësinë sipas standardit të OBSH-së	TC.8.1	2,4 0,8	2,3 0,6
TC.47a TC.47b	Prevalenca e mbipeshës	2.2.2	AN	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që janë mbi (a) dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) tri devijime standarde (e rëndë) të peshës mesatare për gjatësinë sipas standardit të OBSH-së	TC.8.1	7,7 2,7	3,9 0,9
TC.49a TC.49b TC.49c	Stimulimi i hershëm dhe kujdesi i përgjegjshëm		EC	Përqindja e fëmijëve të moshës 24–59 muaj që gjatë 3 ditëve të fundit janë përfshirë në katër ose më shumë aktivitete për stimulimin e hershëm dhe kujdesin e përgjegjshëm me (a) Cilindo anëtar të rritur të ekonomisë familjare (b) Babanë (c) Nënën	TC.9.1	79,4 18,7 70,9	49,9 4,5 38,7
TC.50	Disponueshmëria e librave për fëmijë		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që kanë tre ose më shumë libra për fëmijë	TC.9.2	46,2	5,1
TC.51	Disponueshmëria e lodrave		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç që luajnë me dy ose më shumë lloje lodrash	TC.9.2	69,0	62,1

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.52	Mbikëqyrja joadekuate		EC	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç të mbetur vetëm ose nën mbikëqyrjen e një fëmije tjetër më të vogël se 10 vjeç për më shumë se një orë të paktën një herë në javën e fundit	TC.9.3	5,3	4,8
TC.53	Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030	4.2.1	EC	Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç që janë në rrugën e duhur në zhvillimin e tyre në aspektin e shëndetit, të nxënit dhe mirëqenies psikosociale	TC.10.1	88,9	73,6
Treguesit e temave plotësuese të pyetësorit[21]							
TC.30	Fëmijët e ushqyer ndonjëherë me gji		MN	Përqindja e fëmijëve të fundit të lindur të gjallë nga femrat me lindje të gjallë në 2 vitet e fundit që janë ushqyer ndonjëherë me gji	TC.7.1	91,6	88,0
TC.31	Fillimi i hershëm i ushqyerjes me gji		MN	Përqindja e fëmijëve më të fundit të lindur të gjallë nga femrat me lindje të gjalla në 2 vitet e fundit që u vendosën në gji brenda një ore pas lindjes	TC.7.1	37,0	38,8
TC.32	Ushqyerja ekskluzive me gji nën 6 muaj		BD	Përqindja e foshnjave nën 6 muaj që ushqehen ekskluzivisht me gji[26]	TC.7.2	41,9	20,2
TC.38	Fillimi i ushqyerjes me ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta		BD	Përqindja e foshnjave të moshës 6–8 muaj që kanë marrë ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta gjatë ditës së mëparshme	TC.7.3	96,7	(*)
TC.39	Ushqyeshmëria minimale e pranueshme		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–23 muaj që kishin të paktën llojllojshmërinë minimale ushqyese dhe shpeshtësinë minimale të shujtave gjatë ditës së mëparshme	TC.7.4	34,8	23,0

[26] Foshnjat që marrin qumësht gjiri dhe nuk marrin lëngje apo ushqime të tjera, me përjashtim të solucionit të rihidrimit oral, vitaminave, suplementeve minerale dhe ilaçeve.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.40	Shpeshtësia minimale e ushqyerjes me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6–23 muaj që nuk ushqehen me gji dhe që kanë marrë të paktën 2 ushqyerje me qumësht gjatë ditës së mëparshme	TC.7.4	84,5	80,7
TC.41	Llojllojshmëria minimale ushqyese	2.2.4	BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që kanë marrë ushqime nga 5 ose më shumë nga 8 grupet e përcaktuara ushqimore[27] gjatë ditës së mëparshme	TC.7.4	41,5	27,2
TC.42	Shpeshtësia minimale e shujtave		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që kanë marrë ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta dhe të buta (plus ushqime me qumësht për fëmijët që nuk ushqehen me gji) numrin minimal[28] ose më shumë herë gjatë ditës së mëparshme	TC.7.4	79,6	79,7
TC.43	Ushqyerja me shishe (biberon)		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 0-23 muaj të cilët janë ushqyer me shishe/biberon një ditë më parë	TC.7.2	68,0	79,2
TC.702	Ushqyerja ekskluzive me qumësht gjiri gjatë dy ditëve të para pas lindjes		MN	Përqindja e fëmijëve të lindur të gjallë më të fundit nga femrat që kanë pasur lindje të gjallë në 2 vitet e fundit, të cilët janë ushqyer ekskluzivisht me qumësht gjiri gjatë dy ditëve të para pas lindjes	TC.7.1	48,9	59,2
TC.703	Ushqyerja e kombinuar me qumësht nën moshën 6 muaj		BD	Përqindja e foshnjave nën moshën 6 muaj që kanë marrë formulë dhe/ose qumësht shtazor krahas qumështit të gjirit gjatë ditës së mëparshme	TC.7.2	11,5	32,2
TC.704	Vazhdimi i ushqyerjes me gji në moshën 12-23 muaj		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 12–23 muaj që kanë marrë qumësht gjiri gjatë ditës së mëparshme	TC.7.2	37,1	50,2

[27] 8 grupet e përcaktuara ushqimore janë: 1) qumështi i gjirit, 2) drithërat, rrënjët dhe zhardhokët, 3) bishtajoret dhe arrat, 4) produktet e qumështit (qumështi, formula për foshnja, kosi dhe djathi), 5) ushqimet me mish (mishi, peshku, shpezët dhe mëlçia/mishi i organeve), 6) vezët, 7) frutat dhe perimet e pasura me vitaminë A dhe 8) frutat dhe perimet e tjera.

[28] Fëmijët që ushqehen me gji: Ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta, dy herë për foshnjat 6-8 muajsh dhe tre herë për fëmijët 9-23 muajsh; Fëmijët që nuk ushqehen me gji: Ushqime të ngurta, gjysmë të ngurta ose të buta, ose ushqime me qumësht, katër herë për fëmijët 6-23 muajsh.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.705	Varfëria ushqimore e fëmijëve		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që kanë marrë ushqime nga 4 ose më pak prej 8 grupeve të përcaktuara ushqimore[27] gjatë ditës së mëparshme	TC.7.5	58,5	72,8
TC.706	Konsumimi i vezëve dhe/ose mishit		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që konsumuan ushqim me vezë dhe/ose mish gjatë ditës së mëparshme	TC.7.6	57,4	47,5
TC.707	Konsumimi i pijeve të ëmbla		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që kanë konsumuar një pije të ëmbël gjatë ditës së mëparshme	TC.7.7	41,8	71,7
TC.708	Konsumimi i ushqimeve jo të shëndetshme		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që konsumuan ushqime të pashëndetshme[29] gjatë ditës së mëparshme	TC.7.7	56,6	79,7
TC.709	Moskonsumimi i perimeve ose frutave		BD	Përqindja e fëmijëve të moshës 6-23 muaj që nuk konsumuan asnjë perime ose frut gjatë ditës së mëparshme	TC.7.7	8,7	18,7
TC.710a TC.710b	Prevalenca e dobësisë (mosha 5–9 vjeç)		FA	Përqindja e fëmijëve të moshës 5–9 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tri devijime standarde (e rëndë) të medianës së Indeksit të Masës Trupore (BMI)-për moshën sipas Referencës së Rritjes të OBSH-së 2007 për fëmijët dhe adoleshentët e moshës shkollore	TC.8.2	1,8 0,1	2,8 0,3
TC.711a TC.711b	Prevalenca e mbipeshës (mosha 5–9 vjeç)		FA	Përqindja e fëmijëve të moshës 5–9 vjeç që janë mbi (a) plus një devijim standard (e moderuar dhe e rëndë) (b) plus dy devijime standarde (e rëndë) të medianës së Indeksit të Masës Trupore (BMI)-për moshën sipas Referencës së Rritjes të OBSH-së 2007 për fëmijët dhe adoleshentët e moshës shkollore	TC.8.2	24,1 11,4	32,4 15,7

[29]Në kontekstin e këtij treguesi, "ushqime jo të shëndetshme" janë ushqimet ose kategoritë e ushqimeve (p.sh., "ëmbëlsirat" ose "bonbonet") që ka të ngjarë të konsumohen nga foshnjat dhe fëmijët e vegjël dhe janë të pasura me sheqer, kripë dhe/ose yndyrna të pashëndetshme. Referojuni tabelave për informacion më të detajuar.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Modul[i18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TC.712a TC.712b	Gjatësia e ulët për moshën (5-9 vjeç)		FA	Përqindja e fëmijëve të moshës 5-9 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tre devijime standarde (e rëndë) të medianës së gjatësisë për moshën sipas referencës së rritjes të OBSH-së 2007 për fëmijët dhe adoleshentët e moshës shkollore	TC.8.2	2,7 1,0	5,1 2,3
TC.713a TC.713b	Pesha e ulët për moshën (5-9 vjeç)		FA	Përqindja e fëmijëve të moshës 5-9 vjeç që janë nën (a) minus dy devijime standarde (e moderuar dhe e rëndë) (b) minus tre devijime standarde (e rëndë) të medianës së peshës për moshën sipas referencës së rritjes të OBSH-së 2007 për fëmijët dhe adoleshentët e moshës shkollore	TC.8.2	3,6 0,1	5,7 1,7
(*): Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.							

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
TË MËSUARIT DHE FITIMI I SHKATHTËSIVE							
Treguesit bazë të pyetësorit[21]							
LN.1	Vijueshmëria në edukimin në fëmijëri të hershme		UB	Përqindja e fëmijëve të moshës 36–59 muaj që vijojnë një program të edukimit në fëmijërinë e hershme	LN.1.1	35,5	6,9
LN.2	Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) (e adaptuar)	4.2.2[30]	ED	Përqindja e fëmijëve të grupmoshës përkatëse (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) që vijojnë një program të edukimit në fëmijërinë e hershme ose shkollën fillore	LN.1.2	87,5	45,4
LN.S1	Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollën fillore)		ED	Përqindja e fëmijëve të moshës 3–5 vjeç që vijojnë një program të edukimit në fëmijërinë e hershme	LN.1.3A	53,1	18,1
LN.3	Gatishmëria për shkollë		ED	Përqindja e fëmijëve që vijojnë klasën e parë të shkollës fillore dhe që kanë vijuar një program të edukimit në fëmijërinë e hershme gjatë vitit paraprak shkollor	LN.2.1	91,5	61,5
LN.4	Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor		ED	Përqindja e fëmijëve në moshën e hyrjes në shkollë fillore që regjistrohen në klasën e parë të shkollës fillore	LN.2.2	87,4	63,4

[30] Ky tregues i SDG-ve paraqitet me indekset e barazisë sipas treguesit 4.5.1 të SDG-së, domethënë sipas gjinisë (femër/mashkull), zonë (rurale/urbane), kuintilin e pasurisë familjare (më të varfërit/më të pasurit) dhe të tjera ku është e mundur.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
LN.5a LN.5b LN.5c	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar)[31]		ED	Përqindja e fëmijëve të (a) moshës së shkollës fillore që aktualisht ndjek shkollën fillore, të mesme të ulët ose të lartë (b) moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht ndjek shkollën e mesme të ulët ose më të lartë (c) moshës së shkollës së mesme të lartë që aktualisht ndjek shkollën e mesme të lartë ose më të lartë	LN.2.3 LN.2.4 LN.2.6	96,0 94,7 88,8	83,2 65,1 27,4
LN.6a LN.6b LN.6c	Shkalla e fëmijëve jashtë shkollës		ED	Përqindja e fëmijëve të (a) moshës së shkollës fillore të cilët nuk ndjekin asnjë nivel arsimor (b) moshës së shkollës së mesme të ulët të cilët nuk ndjekin asnjë nivel arsimor (c) moshës së shkollës së mesme të lartë të cilët nuk ndjekin asnjë nivel arsimor	LN.2.3 LN.2.4 LN.2.6	1,6 1,3 10,9	13,5 22,9 61,7
LN.7a LN.7b	Shkalla bruto e regjistrimit në klasën e fundit[31]		ED	Raporti i fëmijëve që ndjekin klasën e fundit për herë të parë ndaj fëmijëve të moshës së duhur për klasën e fundit (a) shkolla fillore (b) shkolla e mesme e ulët	LN.2.7	95,5 91,8	83,9 53,2
LN.8a LN.8b LN.8c	Shkalla e përfundimit	4.1.2[30]	ED	Përqindja e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç mbi moshën e parashikuar për klasën e fundit që kanë përfunduar atë klasë (a) shkolla fillore (b) shkolla e mesme e ulët (c) shkolla e mesme e lartë	LN.2.7	99,0 98,1 90,0	82,5 61,9 30,0
LN.9	Shkalla efektive e tranzicionit në shkollën e mesme të ulët[31]		ED	Përqindja e fëmijëve që vijojnë klasën e fundit të shkollës fillore gjatë vitit shkollor paraardhës dhe që nuk përsëriten vitin aktual shkollor që ndjekin klasën e parë të shkollës së mesme të ulët në vitin aktual shkollor	LN.2.7	86,2	93,5

[31] Indekset e barazisë për këtë tregues janë paraqitur në tabelën e treguesve sipas gjinisë (femër/mashkull), zonë (rurale/urbane) dhe kuintilit të pasurisë familjare (më e varfër/më e pasur).

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
LN.10a LN.10b	Mbi moshë për klasën		ED	Përqindja e fëmijëve që ndjekin shkollën që janë të paktën 2 vjet mbi moshën e parashikuar për klasën që ndjekin (a) shkolla fillore (b) shkolla e mesme e ulët	LN.2.5	2,4 1,2	15,2 15,0
LN.S2	Ekonomitë familjare me televizor[32]		HC	Përqindja e familjeve që kanë televizor	LN.6.1	97,5	90,7
LN.S3	Ekonomitë familjare me telefon[33]		HC	Përqindja e familjeve që kanë telefon (telefon fiks ose telefon mobil)	LN.6.1	99,8	98,3
LN.607	Ekonomitë familjare me kompjuter		HC	Përqindja e familjeve që kanë kompjuter	LN.6.1	54,3	18,5
LN.608	Ekonomitë familjare me internet		HC	Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet nga shtëpia përmes çfarëdo pajisjeje	LN.6.1	99,0	98,0

[32] I referohet vetëm televizorëve me ekran të sheshtë në MICS 2025 për Kosovë dhe në MICS 2025 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.

[33] Në MICS 2025 për Kosovë dhe në MICS 2025 për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, ky tregues llogaritet vetëm duke përdorur të dhëna në nivel të ekonomisë familjare të mbledhura përmes Pyetësorit për Ekonomi Familjare.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
MBROJTJA NGA DHUNA DHE SHFRYTËZIMI							
Treguesit bazë të pyetësorit[21]							
PR.2	Disiplinimi i dhunshëm	16.2.1	UCD – FCD	Përqindja e fëmijëve të moshës 1–14 vjeç që gjatë muajit të fundit kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike nga anëtarët e rritur të ekonomisë familjare	PR.2.1	64,2	73,9
PR.3	Fëmijët në punë	8.7.1	CL	Përqindja e fëmijëve të moshës 5–17 vjeç që klasifikohen si fëmijë në punë[34]	PR.3.3	9,3	9,3
PR.4a PR.4b	Martesa e fëmijëve	5.3.1	MA – MMA	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 20-24 vjeç që janë martuar ose bashkëjetojnë për herë të parë Femrat (a) para moshës 15 vjeçare (b) para moshës 18 vjeçare Meshkujt (a) para moshës 15 vjeçare (b) para moshës 18 vjeçare	 PR.4.1W PR.4.1W PR.4.1M PR.4.1M	 0,3 3,4 0,0 0,4	 7,8 28,7 0,0 10,6
PR.5	Të rinjtë e moshës 15–19 vjeç aktualisht të martuar ose në bashkëjetesë		MA – MMA	Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15-19 vjeç që janë të martuar ose në bashkëjetesë Femrat Meshkujt	 PR.4.1W PR.4.1M	 1,7 1,5	 15,8 12,2

[34] Fëmijët në punë përkufizohen si fëmijë të përfshirë në aktivitete ekonomike ose punë shtëpiake mbi pragjet specifike sipas moshës. Ndonëse koncepti i fëmijëve në punë përfshin ekspozimin ndaj kushteve të rrezikshme të punës, dhe ky informacion mblidhet në MICS dhe ishte përfshirë më parë në treguesin e raportuar, përkufizimi aktual, i cili përdoret gjithashtu për raportimin e SDG-ve, nuk përfshin fëmijët që punojnë në kushte të rrezikshme. Për informacione më të hollësishme mbi pragjet dhe klasifikimet, referojuni tabelave.

TREGUESI MICS		SDG[17]	Tema/ Moduli[18]	Përkufizimi[19]	Numri i tabelës[20]	Kosovë	Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë
PR.7a PR.7b	Diferenca në moshë bashkëshortore		MA	Përqindja e femrave që janë aktualisht të martuara ose në bashkëjetesë dhe bashkëshorti ose partneri i të cilave është 10 ose më shumë vjet më i moshuar (a) mosha 15-19 vjeç (b) mosha 20-24 vjeç	PR.4.3	 (*) 9,2	 (0,0) 2,7
Treguesit e temave plotësuese të pyetësorit[21]							
PR.1	Regjistrimi i lindjeve	16.9.1	BR	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç, lindjet e të cilëve raportohet se janë regjistruar pranë autoriteteve civile	PR.1.1	99,9	98,2
2-4	0,5	5,4	5,9	1.270
Arsimimi i nënës				
Parafillor ose nuk ka arsimim	0,0	2,9	2,9	531
Fillor	1,0	5,9	6,4	487
I mesëm i ulët	0,5	4,2	4,7	799
I mesëm i lartë ose i lartë	2,7	3,2	5,9	230
Vështirësitë funksionale (mosha 2–4 vjeç)				
Ka vështirësi funksionale	(0,0)	(5,9)	(5,9)	100
Nuk ka vështirësi funksionale	0,5	5,4	5,9	1.170
Grupi etnik i kryefamiljarit				
Rom	1,5	4,9	5,8	472
Ashkali	0,8	3,4	4,1	1.104
Egjiptian	0,0	5,9	5,9	421
Shqiptar	(*)	(*)	(*)	50
Kuintili i indeksit të pasurisë				
Më të varfërit	0,5	4,4	4,4	548
Të dytët	0,0	5,3	5,3	484
Mesatar	0,0	3,0	3,0	437
Të katërtit	1,4	4,1	5,5	324
Më të pasurit	3,2	3,6	6,8	253
Indeksi i pasurisë				
60 përqindëshi më i varfër	0,2	4,3	4,3	1.470
40 përqindëshi më i pasur	2,2	3,9	6,1	577

[1] **Treguesi MICS TC.52 - Mbikëqyrja jo adekuate**

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

7.5 INDEKSI I ZHVILLIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme është rezultat shumëdimensional i një progresioni të renditur të aftësive dhe kapaciteteve motorike, kognitive, gjuhësore, socio-emocionale dhe rregullatore të fituara gjatë viteve të hershme.[73] Ndonëse këto janë fusha të veçanta të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, ato janë të ndërlidhura. Kultivimi dhe mbështetja e të gjitha këtyre dimensioneve në mënyrë holistike është kyçe për të siguruar që fëmijët të kenë mundësinë më të mirë për të arritur potencialin e tyre të plotë.[74]

Moduli i Indeksit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030 (ECDI2030) pasqyron arritjen e etapave kyçe të zhvillimit nga fëmijët ndërmjet moshave 24 dhe 59 muaj. Të dhënat e gjeneruara nga ECDI2030 mund të përdoren për monitorimin dhe raportimin mbi treguesin e SDG-ve 4.2.1, si dhe për të informuar përpjekjet e qeverisë për përmirësimin e rezultateve zhvillimore tek fëmijët.

Matja përfshin 20 pyetje për mënyrën se si sillen fëmijët në situata të caktuara të përditshme, si dhe për aftësitë dhe njohuritë që kanë fituar, duke pasqyruar vështirësinë në rritje të aftësive që fëmijët fitojnë ndërsa rriten. Njëzet pyetjet janë të organizuara sipas tri fushave të përgjithshme: shëndeti, të mësuarit dhe mirëqenia psikosociale. Një fëmijë konsiderohet se është në rrugë të duhur zhvillimore nëse ka arritur numrin minimal të etapave të pritshme për grupmoshën e tij/saj. Secila nga tri fushat e përgjithshme përbëhet nga një grup nënfushash kryesore:

- Nënfushat e shëndetit: aftësitë motorike të përgjithshme, aftësitë motorike fine dhe kujdesi për veten.
- Nënfushat e të mësuarit: gjuha shprehëse, shkrim-leximi, numërimi, para-shkrimi dhe funksionimi ekzekutiv.
- Nënfushat e mirëqenies psikosociale: aftësitë emocionale, aftësitë sociale, sjellja internalizuese dhe sjellja eksternalizuese.

Moduli ECDI2030 nuk është i dizajnuar për të raportuar veçmas për fusha individuale. Përkundrazi, ai synon të prodhojë një rezultat të vetëm përmbledhës që pasqyron konceptet e ndërlidhura të zhvillimit të përfshira në tri fushat e përmendura në SDG 4.2.1.[75]

Treguesi i nxjerrë nga moduli ECDI2030 është përqindja e fëmijëve të moshës 2–4 vjeç që janë në rrugë të duhur zhvillimore në aspektin e shëndetit, të të mësuarit dhe të mirëqenies psikosociale.[76] Gjetjet janë paraqitur në Tabelat TC.10.1 dhe TC.10.1R.

[73] UNICEF et al. Avancimi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme: Nga Shkenca në Zbatim në Shkallë të Gjerë. Përmbledhje Ekzekutive, The Lancet, 2016.
https://www.thelancet.com/pb-assets/Lancet/stories/series/ecd/Lancet_ECD_Executive_Summary.pdf

[74] Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF). Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme. Vizioni i UNICEF-it për Çdo Fëmijë. UNICEF, Nju Jork, 2023.

[75] Për detaje mbi zhvillimin e modulit ECDI2030 dhe treguesit përkatës, shihni "ECDI2030 – Pyetjet e Bëra Shpesh" (ang. "ECDI2030-Frequently-Asked-Questions"): https://data.unicef.org/resources/early-childhood-development-index-2030-ecdi2030/

[76] Treguesi i gjeneruar nga moduli ECDI2030 nuk është plotësisht i krahasueshëm me treguesin e gjeneruar nga moduli ECDI, i cili u prezantua në anketat MICS në vitin 2009. Për më shumë informacion, shihni "ECDI2030 – Pyetjet e Bëra Shpesh" (ang. "ECDI2030-Frequently-Asked-Questions").

Tabela TC.10.1: Indeksi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme 2030 (ECDI2030)

Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç që janë në rrugë të duhur zhvillimore në shëndet, të mësuarit dhe mirëqenie psikosociale, Kosovë, 2025

	Rezultati i indeksit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030[1]	Numri i fëmijëve të moshës 2-4 vjeç
Totali	**88,9**	**840**
Gjinia		
Meshkuj	85,9	435
Femra	92,1	405
Vendbanimi		
Urban	89,0	413
Rural	88,8	427
Mosha		
2	89,5	262
3	91,7	289
4	85,5	289
Vijimi i edukimit në fëmijërinë e hershme[A]		
E vijon	91,9	205
Nuk e vijon	86,8	373
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	13
Fillor	(*)	14
I mesëm i ulët	79,1	188
I mesëm i lartë	89,4	271
I lartë	94,6	355
Vështirësitë funksionale		
Ka vështirësi funksionale	(*)	19
Nuk ka vështirësi funksionale	89,8	821
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Shqiptar	89,1	782
Serb	(*)	23
Grupe të tjera etnike	(79,6)	36
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	77,4	163
Të dytët	88,3	169
Mesatar	93,5	163
Të katërtit	88,8	163
Më të pasurit	95,6	184

[1] Treguesi MICS TC.53 - Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030; tregues i SDG-ve 4.2.1

[A] Fëmijët e moshës 2 vjeç përjashtohen, pasi pjesëmarrja në edukimin në fëmijërinë e hershme mblidhet vetëm për moshat 3-4 vjeç.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela TC.10.1R: Indeksi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme 2030 (ECDI2030)

Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç që janë në rrugë të duhur zhvillimore në shëndet, të mësuarit dhe mirëqenie psikosociale, Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2025

	Rezultati i indeksit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030[1]	Numri i fëmijëve të moshës 2-4 vjeç
Totali	**73,6**	**1.270**
Gjinia		
Meshkuj	67,1	642
Femra	80,2	627
Vendbanimi		
Urban	70,6	821
Rural	79,1	449
Mosha		
2	81,0	394
3	78,0	457
4	61,8	419
Vijimi i edukimit në fëmijërinë e hershme[A]		
E vijon	(*)	61
Nuk e vijon	70,3	815
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	64,8	328
Fillor	74,2	352
I mesëm i ulët	75,5	480
I mesëm i lartë ose i lartë	(89,7)	110
Vështirësitë funksionale		
Ka vështirësi funksionale	(10,7)	100
Nuk ka vështirësi funksionale	79,0	1.170
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Rom	68,7	299
Ashkali	76,2	687
Egjiptian	69,5	257
Shqiptar	(*)	27
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	65,7	315
Të dytët	68,7	299
Mesatar	77,8	290
Të katërtit	85,3	206
Më të pasurit	(75,6)	161
Indeksi i pasurisë		
60 përqindëshi më i varfër	70,6	903
40 përqindëshi më i pasur	81,1	366

[1] **Treguesi MICS TC.53 - Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030; tregues i SDG-ve 4.2.1**

[A] Fëmijët e moshës 2 vjeç përjashtohen, pasi pjesëmarrja në edukimin në fëmijërinë e hershme mblidhet vetëm për moshat 3-4 vjeç.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

8 TË MËSUARIT DHE FITIMI I SHKATHTËSIVE

8.1 EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Programet e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH) janë të dizajnuara për të promovuar zhvillimin kognitiv, social, emocional dhe fizik të fëmijëve të vegjël dhe për t'i futur ata në mësim të organizuar jashtë kontekstit familjar[77]. Programet e EFH-së synojnë të zhvillojnë aftësitë socio-emocionale të nevojshme për pjesëmarrje në shoqëri dhe aftësitë akademike të nevojshme për hyrje në arsimin fillor, duke luajtur rol kyç në promovimin e gatishmërisë për shkollë. EFH korrespondon me Nivelin 0 të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) dhe përfshin dy kategori (zhvillimin arsimor në fëmijërinë e hershme, të dizajnuar për fëmijët e moshës 0 deri në 2 vjeç, dhe arsimin parafillor për fëmijët nga mosha 3 vjeç deri në fillimin e arsimit fillor). Programet e EFH-së mund të emërtohen në shumë mënyra: edukimi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme, shkolla e lojës, klasa pritëse, parafillor ose parashkollor. Programet për fëmijët më të vegjël që ofrohen në çerdhe, qendra të kujdesit ditor, ose kopshte, të cilat nuk përfshijnë komponentë të mësimit të organizuar (si shërbimet e kujdesit për fëmijë) nuk i përmbushin kriteret e klasifikimit për nivelin 0 të ISCED-it.[77]

EFH në Kosovë përbën nivelin e parë të arsimit parauniversitar, që korrespondon me nivelin 0 të ISCED-it. Ai përfshin programe për fëmijët e moshës 0-5 vjeç (duke përfshirë arsimin parafillor për fëmijët e moshës 5 vjeç). Shërbimet e EFH-së ofrohen përmes institucioneve publike, private dhe me bazë në komunitet.

Në vitet e fundit, Qeveria e Kosovës i ka dhënë prioritet zgjerimit të EFH-së përmes reformës së politikave dhe legjislacionit. Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i miratuar në vitin 2023, ka vendosur kornizën ligjore për organizimin dhe rregullimin e shërbimeve të EFH-së, me qëllim përmirësimin e qasjes, cilësisë dhe përfshirjes. Pas miratimit të tij, arsimi parafillor për fëmijët e moshës 5–6 vjeç u bë i detyrueshëm duke filluar nga viti shkollor 2024/2025, ndërsa në vitin 2025 u miratua një kurrikulë e re e EFH-së që mbulon moshat 0–6 vjeç.

Prioritetet kryesore kombëtare përfshijnë zgjerimin e infrastrukturës së EFH-së, prezantimin e modeleve alternative të shërbimeve, zbatimin e kurrikulës së EFH-së dhe përforcimin e standardeve të cilësisë. Këto prioritete pasqyrohen në kornizat kryesore të politikave, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe Strategjinë e Arsimit 2022–2026.

Tabelat LN.1.1 dhe LN.1.1R tregojnë përqindjen e fëmijëve të moshës 3 dhe 4 vjeç që aktualisht vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme. Fëmija që aktualisht vijon shkollën është fëmija që vijon rregullisht shkollën në kohën e anketës. Nëse fëmija nuk vijon shkollën në kohën e intervistës për shkak të pushimeve shkollore ose ndërprerjeve, por fëmija zakonisht e vijon rregullisht shkollën, fëmija konsiderohet se aktualisht vijon shkollën. Ky tregues bazohet në pyetjen UB8 në Pyetësorin për fëmijët nën moshën 5 vjeç.

Tabelat LN.1.2 dhe LN.1.2R shqyrtojnë ekspozimin e fëmijëve ndaj programeve të mësimit të organizuar në vitin para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore. Mosha zyrtare e regjistrimit në shkollë fillore në Kosovë është 6 vjeç. Prandaj, Tabelat LN.1.2 dhe LN.1.2R u referohen fëmijëve që ishin 5 vjeç në fillim të vitit shkollor.[78] Në Kosovë, viti shkollor fillon në shtator.

---

[77] UNESCO (2012). Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit (ISCED 2011). Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Qasur më 7 korrik 2025. https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf.

[78] Në MICS, mosha e anëtarëve të ekonomive familjare regjistrohet si mosha e tyre në kohën e anketës. Kjo moshë përdoret për të përcaktuar kualifikueshmërinë për pyetësorët individualë, modulet dhe pyetjet, si dhe shërben për të përcaktuar numëruesit dhe emëruesit për shumë tregues. Megjithatë, kur vlerësohen treguesit që lidhen me arsimin dhe që bazohen në moshën e fëmijëve, siç janë shkallët neto të vijueshmërisë të adaptuara, shkallët e përfundimit dhe të tjerë, krijohet një variabël për të pasqyruar moshën e fëmijës në fillim të vitit shkollor. Kjo qasje trajton çështjet e mundshme që lidhen me kohën dhe kohëzgjatjen e punës në terren të anketës dhe siguron që gjetjet të jenë të krahasueshme ndërmjet vendeve, duke marrë gjithashtu parasysh kriteret e moshës për regjistrim në shkollë. Në tabelat e këtij kapitulli, "Mosha në fillim të vitit shkollor"

Treguesi korrespondon me treguesin e SDG-ve 4.2.2: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) dhe llogaritet si shkallë neto e vijueshmërisë e adaptuar[79] (ShNVA). Ky tregues bazohet në pyetjen UB8 në Pyetësorin për fëmijët nën moshën 5 vjeç.

Për më tepër, Tabelat LN.1.2 dhe LN.1.2R paraqesin indekset e barazisë sipas gjinisë, pasurisë dhe vendbanimit për treguesin e SDG-ve 4.2.2. Këto indekse kontribuojnë në treguesin e SDG-ve 4.5.1: Indekset e barazisë (femra/meshkuj, rural/urban, kuintili më i ulët/më i lartë i pasurisë dhe të tjerë, si statusi i aftësisë së kufizuar, popujt indigjenë dhe të prekurit nga konflikti, kur të dhënat bëhen të disponueshme) për të gjithë treguesit e arsimit që mund të zbërthehen. Në përgjithësi, kur një vlerë e indeksit të barazisë bie ndërmjet 0,97 dhe 1,03, ajo konsiderohet si barazi ndërmjet dy grupeve. Grupi që ka gjasa të jetë më i pafavorizuar, p.sh. femrat, të varfrit dhe ruralët, vendoset në numërues, prandaj vlerat e indeksit të barazisë nën 0,97 tregojnë disavantazh për këto grupe. Për shembull, në indeksin e barazisë gjinore (IBGj), një vlerë ndërmjet 0,97 dhe 1,03 tregon barazi ndërmjet gjinive, një vlerë e IBGj-së më e ulët se 0,97 tregon disavantazh për femrat, ndërsa një vlerë më e madhe se 1,03 sugjeron disavantazh për meshkujt. Sa më larg nga 1,00 të jetë indeksi i barazisë, aq më e madhe është pabarazia ndërmjet grupeve. Indekset nuk tregojnë nivelet e përgjithshme të treguesit, pasi barazia mund të arrihet ndërkohë që nivelet e përgjithshme për të dy grupet janë të ulëta.

Indekset e barazisë paraqiten gjithashtu në Tabelat LN.2.8 dhe LN.2.8R për vijueshmërinë në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë.

Tabelat LN.1.3 dhe LN.1.3R paraqesin shkallën e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar të fëmijëve të moshës 3 vjeç deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore.

specifikohet në rreshta dhe kolona aty ku është e zbatueshme, duke e dalluar nga termi “mosha”, i cili i referohet moshës së fëmijës në kohën e anketës.

[79] Shkallët e paraqitura në këtë tabelë janë “të adaptuara”, pasi numëruesi përfshin fëmijët një vit më të vegjël se mosha zyrtare e regjistrimit në shkollë fillore që vijojnë ose EFH-në ose arsimin fillor.

Tabela LN.1.1: Edukimi në fëmijërinë e hershme

Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj që aktualisht vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme, Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme[1,A]	Numri i fëmijëve të moshës 36-59 muaj
Totali	**35,5**	**578**
Gjinia		
Meshkuj	40,1	297
Femra	30,6	281
Vendbanimi		
Urban	47,0	292
Rural	23,7	286
Mosha (në muaj)		
36-47	34,8	289
48-59	36,1	289
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	8
Fillor	(*)	11
I mesëm i ulët	13,9	125
I mesëm i lartë	22,8	199
I lartë	60,1	236
Vështirësitë funksionale të fëmijës		
Ka vështirësi funksionale	(*)	12
Nuk ka vështirësi funksionale	35,2	566
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Shqiptar	35,3	539
Serb	(*)	13
Grupe të tjera etnike	(*)	26
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	7,0	111
Të dytët	24,5	119
Mesatar	37,5	110
Të katërtit	46,8	115
Më të pasurit	59,3	123

[1] **Treguesi MICS LN.1 - Vijueshmëria në edukimin në fëmijërinë e hershme**

[A] Vini re se ky tregues është një masë e vijueshmërisë aktuale, d.m.th., vijueshmërisë në kohën e intervistës. Prandaj, nuk është drejtpërdrejt i krahasueshëm me shkallën neto të adaptuar të vijueshmërisë në nivelet më të larta të arsimit të paraqitura në këtë kapitull.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.1.2: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore)

Shpërndarja në përqindje e fëmijëve që janë një vit më të rinj se mosha zyrtare e regjistrimit në shkollë fillore në fillim të vitit shkollor, sipas nivelit të arsimit që vijojnë, dhe përqindja që vijojnë mësimin e organizuar (edukimi në fëmijërinë e hershme ose arsimi fillor) (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar), Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve:					
	Vijojnë një program të edukimit në fëmijërinë e hershme	Vijojnë arsimin fillor	Nuk vijojnë asnjë nivel arsimor (jashtë shkollës)	Totali	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Mësimi i organizuar[1,2]	Numri i fëmijëve të moshës 5 vjeç në fillim të vitit shkollor
Totali	**77,7**	**9,9**	**12,5**	**100,0**	**87,5**	**361**
Gjinia						
Meshkuj	79,5	6,2	14,3	100,0	85,7	164
Femra	76,2	12,9	10,9	100,0	89,1	197
Vendbanimi						
Urban	76,3	9,1	14,6	100,0	85,4	189
Rural	79,2	10,7	10,1	100,0	89,9	172
Arsimimi i nënës						
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	6
Fillor	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	9
I mesëm i ulët	73,8	11,2	15,0	100,0	85,0	81
I mesëm i lartë	80,8	11,0	8,2	100,0	91,8	110
I lartë	82,0	7,5	10,5	100,0	89,5	155
Grupi etnik i kryefamiljarit						
Shqiptar	80,2	10,0	9,8	100,0	90,2	329
Serb	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	11
Grupe të tjera etnike	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	20
Kuintili i indeksit të pasurisë						
Më të varfërit	59,4	13,0	27,5	100,0	72,5	73
Të dytët	78,2	12,2	9,7	100,0	90,3	64
Mesatar	91,1	4,1	4,8	100,0	95,2	78
Të katërtit	84,3	6,4	9,2	100,0	90,8	75
Më të pasurit	74,3	14,5	11,2	100,0	88,8	71
Indekset e barazisë[2]						
Femra/Meshkuj	0,96	2,09	0,76	na	1,04	na
Rural/Urban	1,04	1,17	0,69	na	1,05	na
Më të varfërit/Më të pasurit	0,80	0,90	2,45	na	0,82	na

[1] Treguesi MICS LN.2 - Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) (e adaptuar); treguesi i SDG-ve 4.2.2

[2] Indekset e barazisë - Treguesi MICS LN.2; treguesi i SDG-ve 4.5.1

na: nuk aplikohet

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.1.3: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore)

Përqindja e fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor, përqindja që vijojnë arsimin fillor dhe përqindja jashtë shkolle, sipas gjinisë, Kosovë, 2025

	Meshkuj				Femra				Totali			
		Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:		
	Shkalla neto e vijueshmërisë	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë[1]	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[2.A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor
Totali	**55,6**	**2,0**	**42,2**	**497**	**50,6**	**4,8**	**44,4**	**529**	**53,1**	**3,5**	**43,3**	**1026**
Vendbanimi												
Urban	60,1	2,5	37,5	270	61,8	4,1	33,7	256	60,9	3,3	35,6	527
Rural	50,4	1,5	47,8	227	40,2	5,4	54,4	273	44,8	3,7	51,4	500
Mosha në fillim të vitit shkollor												
3	43,5	0,0	56,2	178	31,7	0,0	67,7	159	37,9	0,0	61,6	336
4	44,4	0,0	55,6	156	39,0	0,0	61,0	173	41,6	0,0	58,4	329
5	79,5	6,2	14,3	164	76,2	12,9	10,9	197	77,7	9,9	12,5	361
Arsimimi i nënës												
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	6	(*)	(*)	(*)	9	(*)	(*)	(*)	15
Fillor	(*)	(*)	(*)	10	(*)	(*)	(*)	12	(*)	(*)	(*)	22
I mesëm i ulët	42,1	1,6	56,3	99	30,8	6,3	62,0	120	35,9	4,2	59,5	218
I mesëm i lartë	52,1	1,8	45,7	163	37,9	5,5	56,6	166	45,0	3,7	51,2	329
I lartë	67,5	2,2	30,3	220	74,0	3,0	22,9	223	70,8	2,6	26,6	443
Grupi etnik i kryefamiljarit												
Shqiptar	56,7	1,8	41,4	463	51,4	5,1	43,6	486	54,0	3,5	42,5	950
Serb	(*)	(*)	(*)	12	(*)	(*)	(*)	15	(*)	(*)	(*)	26
Grupe të tjera etnike	(19,3)	(7,7)	(73,0)	22	(17,5)	(3,1)	(75,9)	28	18,3	5,1	74,6	50
Kuintili i indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	30,6	1,7	67,7	95	24,7	7,6	67,8	104	27,5	4,8	67,7	200
Të dytët	44,6	0,8	54,6	79	39,0	6,2	54,0	116	41,2	4,0	54,3	195
Mesatar	62,5	1,3	35,6	101	59,7	1,7	38,6	106	61,0	1,5	37,1	207
Të katërtit	66,6	1,2	32,2	115	62,5	3,6	33,9	95	64,7	2,3	32,9	210
Më të pasurit	67,9	4,8	27,3	107	69,0	4,8	26,2	108	68,5	4,8	26,8	215

[1] Treguesi MICS LN.S1 - Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore)

[A] Përqindja e fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme jashtë shkolle janë ata që nuk vijojnë asnjë nivel të arsimit.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.1.1R: Edukimi në fëmijërinë e hershme

Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj që aktualisht vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme, Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme[1,A]	Numri i fëmijëve të moshës 36-59 muaj
Totali	**6,9**	**876**
Gjinia		
Meshkuj	5,9	430
Femra	7,9	446
Vendbanimi		
Urban	8,7	546
Rural	4,0	330
Mosha (në muaj)		
36-47	2,5	457
48-59	11,7	419
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	4,0	248
Fillor	8,4	242
I mesëm i ulët	6,6	310
I mesëm i lartë ose i lartë	(*)	76
Vështirësitë funksionale të fëmijës		
Ka vështirësi funksionale	(*)	54
Nuk ka vështirësi funksionale	6,9	822
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Rom	7,9	203
Ashkali	6,1	480
Egjiptian	6,6	173
Shqiptar	(*)	20
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	0,9	234
Të dytët	4,2	208
Mesatar	(7,7)	181
Të katërtit	(5,8)	132
Më të pasurit	(23,0)	122
Indeksi i pasurisë		
60 përqindëshi më i varfër	4,0	622
40 përqindëshi më i pasur	14,1	254

[1] **Treguesi MICS LN.1 - Vijueshmëria në edukimin në fëmijërinë e hershme**

[A] Vini re se ky tregues është një masë e vijueshmërisë aktuale, d.m.th., vijueshmërisë në kohën e intervistës. Prandaj, nuk është drejtpërdrejt i krahasueshëm me shkallën neto të adaptuar të vijueshmërisë në nivelet më të larta të arsimit të paraqitura në këtë kapitull.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.1.2R: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore)

Shpërndarja në përqindje e fëmijëve që janë një vit më të rinj se mosha zyrtare e regjistrimit në shkollë fillore në fillim të vitit shkollor, sipas nivelit të arsimit që vijojnë, dhe përqindja që vijojnë mësimin e organizuar (edukimi në fëmijërinë e hershme ose arsimi fillor) (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar), Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve:					
	Vijojnë një program të edukimit në fëmijërinë e hershme	Vijojnë arsimin fillor	Nuk vijojnë asnjë nivel arsimor (jashtë shkollës)	Totali	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Mësimi i organizuar[1,2]	Numri i fëmijëve të moshës 5 vjeç në fillim të vitit shkollor
Totali	**38,7**	**6,7**	**54,6**	**100,0**	**45,4**	**131**
Gjinia						
Meshkuj	43,5	5,0	51,6	100,0	48,4	68
Femra	33,6	8,5	57,9	100,0	42,1	63
Vendbanimi						
Urban	34,8	5,5	59,6	100,0	40,4	84
Rural	45,8	8,8	45,4	100,0	54,6	46
Arsimimi i nënës						
Parafillor ose nuk ka arsimim	(18,2)	(5,9)	(75,9)	100,0	(24,1)	32
Fillor	(35,1)	(10,5)	(54,4)	100,0	(45,6)	31
I mesëm i ulët	46,4	5,3	48,3	100,0	51,7	55
I mesëm i lartë ose i lartë	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	12
Grupi etnik i kryefamiljarit						
Rom	(33,8)	(8,5)	(57,7)	100,0	(42,3)	35
Ashkali	33,0	2,8	64,2	100,0	35,8	67
Egjiptian	(56,0)	(15,2)	(28,8)	100,0	(71,2)	25
Shqiptar	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	3
Kuintili i indeksit të pasurisë						
Më të varfërit	(26,8)	(5,1)	(68,0)	100,0	(32,0)	28
Të dytët	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	23
Mesatar	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	25
Të katërtit	(51,5)	(1,7)	(46,8)	100,0	(53,2)	38
Më të pasurit	(*)	(*)	(*)	100,0	(*)	17
Indeksi i pasurisë						
60 përqindëshi më i varfër	29,4	6,9	63,7	100,0	36,3	75
40 përqindëshi më i pasur	(51,3)	(6,4)	(42,4)	100,0	(57,6)	56
Indekset e barazisë[2]						
Femra/Meshkuj	0,77	1,72	1,12	na	0,87	na
Rural/Urban	1,31	1,59	0,76	na	1,35	na
Më të varfërit/Më të pasurit	(*)	(*)	(*)	na	(*)	na

[1] Treguesi MICS LN.2 - Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të regjistrimit në shkollë fillore) (e adaptuar); treguesi i SDG-ve 4.2.2

[2] Indekset e barazisë - Treguesi MICS LN.2; treguesi i SDG-ve 4.5.1

na: nuk aplikohet

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.1.3R: Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore)

Përqindja e fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor, përqindja që vijojnë arsimin fillor dhe përqindja jashtë shkolle, sipas gjinisë, Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2025

	Meshkuj				Femra				Totali			
		Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:		
	Shkalla neto e vijueshmërisë	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë[1]	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[2.A]	Numri i fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme (3-5 vjeç) në fillim të vitit shkollor
Totali	**19,7**	**1,7**	**78,6**	**198**	**16,5**	**2,7**	**80,9**	**201**	**18,1**	**2,2**	**79,8**	**398**
Vendbanimi												
Urban	20,4	1,1	78,5	129	15,9	2,7	81,5	121	18,2	1,9	79,9	249
Rural	18,3	2,8	78,9	69	17,4	2,6	80,0	80	17,8	2,7	79,5	149
Mosha në fillim të vitit shkollor												
3	5,5	0,0	94,5	63	2,8	0,0	97,2	71	4,0	0,0	96,0	134
4	8,9	0,0	91,1	66	14,9	0,0	85,1	67	11,9	0,0	88,1	134
5	43,5	5,0	51,6	68	33,6	8,5	57,9	63	38,7	6,7	54,6	131
Arsimimi i nënës												
Parafillor ose nuk ka arsimim	(10,6)	(0,0)	(89,4)	58	7,7	3,6	88,7	53	9,2	1,7	89,1	111
Fillor	18,1	1,4	80,5	55	(13,5)	(4,7)	(81,8)	52	15,9	3,0	81,1	106
I mesëm i ulët	24,7	2,8	72,4	69	21,3	1,3	77,4	77	22,9	2,0	75,1	146
I mesëm i lartë ose i lartë	(*)	(*)	(*)	16	(*)	(*)	(*)	19	(32,3)	(1,8)	(65,9)	35
Grupi etnik i kryefamiljarit												
Rom	(19,7)	(3,8)	(76,5)	52	(15,8)	(2,0)	(82,2)	49	17,8	2,9	79,3	101
Ashkali	16,7	0,6	82,7	103	13,0	1,2	85,8	105	14,9	0,9	84,2	208
Egjiptian	(24,8)	(2,1)	(73,1)	38	(22,2)	(7,3)	(70,4)	42	23,5	4,9	71,7	80
Shqiptar	(*)	(*)	(*)	6	(*)	(*)	(*)	5	(*)	(*)	(*)	10
Kuintili i indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	(10,4)	(0,0)	(89,6)	51	5,0	2,5	92,5	57	7,6	1,3	91,1	107
Të dytët	(15,4)	(2,1)	(82,5)	37	(13,5)	(0,0)	(86,5)	49	14,3	0,9	84,7	85
Mesatar	(21,1)	(4,3)	(74,6)	45	(9,0)	(3,4)	(87,5)	29	16,4	4,0	79,7	75
Të katërtit	(26,6)	(1,6)	(71,8)	39	(33,1)	(0,0)	(66,9)	35	29,7	0,9	69,5	74
Më të pasurit	(30,8)	(0,0)	(69,2)	26	(30,3)	(9,3)	(60,4)	31	30,5	5,1	64,4	57
Indeksi i pasurisë												
60 përqindëshi më i varfër	15,5	2,1	82,5	133	8,9	1,8	89,3	135	12,2	1,9	85,9	267
40 përqindëshi më i pasur	28,3	1,0	70,7	65	31,8	4,4	63,8	66	30,0	2,7	67,3	131

[1] Treguesi MICS LN.S1 - Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (fëmijët deri në moshën e regjistrimit në shkollë fillore)

[A] Përqindja e fëmijëve në moshën e edukimit në fëmijërinë e hershme jashtë shkolle janë ata që nuk vijojnë asnjë nivel të arsimit.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

8.2 VIJUESHMËRIA

Një nga synimet e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm është të sigurohet që të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm. Arsimi është parakusht thelbësor për luftimin e varfërisë, fuqizimin e grave, rritjen ekonomike, mbrojtjen e fëmijëve nga puna e rrezikshme dhe shfrytëzuese dhe nga shfrytëzimi seksual, promovimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, mbrojtjen e mjedisit dhe ndikimin në rritjen e popullsisë.

Në Kosovë, fëmijët hyjnë në shkollë fillore në moshën 6 vjeç, në shkollën e mesme të ulët në moshën 11 vjeç dhe në shkollën e mesme të lartë në moshën 15 vjeç. Shkolla fillore ka 5 klasë, kurse shkolla e mesme ka 4 + 3 klasë. Në shkollën fillore, klasat referohen si klasa 1 deri në klasën 5. Për shkollën e mesme të ulët, klasat referohen si klasa 6 deri në klasën 9, ndërsa në shkollën e mesme të lartë si klasa 10 deri në klasën 12. Viti shkollor zakonisht zgjat nga shtatori i një viti deri në qershor të vitit pasues.

Për të arritur krahasueshmëri ndërmjet sistemeve dhe klasifikimeve të ndryshme kombëtare të arsimit në mbarë botën, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) përdor kornizën statistikore ISCED. Nivelet dhe kodimi i përcaktuar në të përdoren në llogaritjen e treguesve të MICS-it.[80] Duke qenë se treguesit përqendrohen në përfundimin e arsimit fillor dhe të mesëm, tabela e klasifikimeve më poshtë paraqet nivelet 0–3.

ISCED 2011		**Sistemi arsimor në Kosovë**	
Niveli	Emri ISCED	**Emri i nivelit të arsimit në:**	
		Shqip	Anglisht
0	Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme	Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (mosha <6 vjeç)	Early Childhood Education (<6 years old)
1	Arsimi fillor	Arsimi Fillor (klasat 1–5)	Primary Education (grades 1–5)
2	Arsimi i mesëm i ulët	Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6–9)	Lower Secondary Education (grades 6–9)
3	Arsimi i mesëm i lartë	Arsimi i mesëm i lartë (klasa 10–12) – Gjimnaz	Upper Secondary Education (grades 10–12) – Gymnasium
		Arsimi i mesëm i lartë (klasa 10–12) – Arsim dhe aftësim profesional	Upper Secondary Education (grades 10–12) – Vocational Education and Training
Nivelet pas të mesmes 4–8 nuk janë detajuar në këtë tabelë, por përfshijnë 4: arsimin pas të mesmes joterciar, 5: arsimin terciar me cikël të shkurtër, 6: bachelor ose ekuivalent, 7: master ose ekuivalent dhe 8: doktoratë ose ekuivalent.			

Vijueshmëria në arsimin parafillor është e rëndësishme për gatishmërinë e fëmijëve për shkollë. Tabelat LN.2.1 dhe LN.2.1R tregojnë proporcionin e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore, pavarësisht nga mosha, që kanë vijuar një program të edukimit në fëmijërinë e hershme gjatë vitit paraprak.[81]

[80] ISCED rishikohet periodikisht nga UNESCO, më së fundi në vitin 2011, në konsultim me vendet. Hartëzimet kombëtare të ISCED-it publikohen këtu, qasur më 7 korrik 2025: https://isced.uis.unesco.org/data-mapping/.

[81] Llogaritja e treguesit nuk i përjashton përsëritësit. Prandaj, ajo përfshin si fëmijët që vijojnë shkollën fillore për herë të parë, ashtu edhe ata që ishin në klasën e parë të shkollës fillore vitin e kaluar shkollor dhe po e përsërisin atë. Fëmijët përsëritës mund të kenë vijuar arsimin parafillor para vitit shkollor gjatë të cilit kanë vijuar klasën e parë të shkollës fillore për herë të parë; këta fëmijë nuk kapen në numëruesin e treguesit.

Tabelat LN.2.2 dhe LN.2.2R paraqesin përqindjen e fëmijëve në moshën e regjistrimit në shkollë fillore që hyjnë në klasën e parë.

Tabelat LN.2.3 dhe LN.2.3R ofrojnë përqindjen e fëmijëve të moshës së shkollës fillore (6 deri në 10 vjeç) që vijojnë shkollën fillore ose shkollën e mesme të ulët[82], si dhe ata që janë jashtë shkollës. Në mënyrë të ngjashme, Tabelat LN.2.4 dhe LN.2.4R paraqesin përqindjen e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët (mosha 11 deri në 14 vjeç) që vijojnë shkollën e mesme të ulët ose arsimin e mesëm të lartë[83], si dhe ata që janë jashtë shkollës.

Në Tabelat LN.2.5 dhe LN.2.5R, fëmijët shpërndahen sipas moshës së tyre kundrejt klasës aktuale që vijojnë (mosha për klasë). Për shembull, një fëmijë 8-vjeçar në fillim të vitit shkollor pritet të jetë në klasën e 3-të, sipas moshës zyrtare të synuar për klasë. Nëse ky fëmijë aktualisht është në klasën e 1-rë, ai/ajo do të klasifikohet si mbi moshën zyrtare për 2 vite. Tabela përfshin si nivelin fillor ashtu edhe atë të mesëm të ulët.

Tabelat LN.2.6 dhe LN.2.6R paraqesin përqindjen e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë (mosha 15 deri në 17 vjeç) që vijojnë shkollën e mesme të lartë ose nivel më të lartë[84], si dhe ata që janë jashtë shkollës.

Raporti bruto i hyrjes në klasën e fundit të shkollës fillore, shkalla e përfundimit të shkollës fillore dhe shkalla e tranzicionit në arsimin e mesëm paraqiten në Tabelat LN.2.7 dhe LN.2.7R. Raporti bruto i hyrjes është raporti i numrit të përgjithshëm të nxënësve, pavarësisht nga mosha, që hyjnë për herë të parë në klasën e fundit të shkollës fillore, ndaj numrit të fëmijëve në moshën e përfundimit të shkollës fillore në fillim të vitit shkollor aktual ose më të fundit.

Shkalla e përfundimit të arsimit fillor i referohet përqindjes së një kohorte fëmijësh që janë 3 deri në 5 vjet mbi moshën zyrtare të synuar për klasën e fundit të arsimit fillor që kanë përfunduar arsimin fillor. Mosha e synuar për klasën e fundit të arsimit fillor është mosha në të cilën fëmijët do të hynin në klasën e fundit të shkollës fillore nëse do të kishin filluar shkollën në moshën zyrtare të hyrjes në shkollë fillore dhe do të kishin përparuar pa përsëritur apo kapërcyer klasë. Në Kosovë, mosha zyrtare e hyrjes në shkollë fillore është 6 vjeç. Me 5 klasë në shkollën fillore, mosha e synuar për klasën e fundit të fillores është prandaj 10 vjeç, dhe grupi referent për shkallën e përfundimit të arsimit fillor janë fëmijët e moshës 13 deri në 15 vjeç. Shkallët e përfundimit paraqiten gjithashtu për arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Mosha zyrtare e synuar për klasat e fundit të shkollës së mesme të ulët dhe të mesme të lartë është përkatësisht 14 dhe 17 vjeç. Prandaj, emëruesit për shkallët e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë fëmijët e moshës 17 deri në 19 vjeç dhe fëmijët e moshës 20 deri në 22 vjeç, përkatësisht.

Tabelat gjithashtu japin shkallën "efektive" të tranzicionit[85], të përkufizuar si përqindja e fëmijëve që vazhduan në nivelin e ardhshëm të arsimit – numri i fëmijëve që vijojnë klasën e parë të nivelit më të lartë të arsimit në vitin shkollor aktual dhe që ishin në klasën e fundit të nivelit më të ulët të arsimit vitin paraprak, pjesëtuar me numrin e fëmijëve që ishin në klasën e fundit të nivelit më të ulët të arsimit gjatë vitit shkollor paraprak dhe që nuk po e përsërisin atë klasë në vitin aktual.

Shkalla e ulët efektive e tranzicionit tregon se një përqindje e ulët e nxënësve po kalojnë në nivelin tjetër të arsimit. Kjo sjell në pah ekzistencën e pengesave të mundshme në sistemin arsimor, duke përfshirë: barrën financiare, si tarifat e regjistrimit ose detyrimin për të blerë libra shkollorë ose uniforma shkollore; çështjet e ofrimit dhe cilësisë së arsimit, si numri i kufizuar i mësimdhënësve ose klasave (dhomave të mësimit) dhe cilësia e

[82] Shkallët e paraqitura në këtë tabelë janë "të adaptuara", pasi në numërues përfshijnë jo vetëm vijueshmërinë në shkollën fillore, por edhe vijueshmërinë në shkollën e mesme të ulët dhe të mesme të lartë.
[83] Shkallët e paraqitura në këtë tabelë janë "të adaptuara", pasi në numërues përfshijnë jo vetëm vijueshmërinë në shkollën e mesme të ulët, por edhe vijueshmërinë në nivele më të larta të arsimit.
[84] Shkallët e paraqitura në këtë tabelë janë "të adaptuara", pasi në numërues përfshijnë jo vetëm vijueshmërinë në shkollën e mesme të lartë, por edhe vijueshmërinë në nivele më të larta të arsimit.
[85] Shkalla e thjeshtë e tranzicionit, e cila nuk llogaritet më në MICS, ka prirje ta nënvlerësojë përparimin e nxënësve drejt shkollës së mesme, pasi supozon se përsëritësit nuk arrijnë kurrë në shkollën e mesme.

ulët e mësimdhënies; si dhe bindjet shoqërore dhe individuale mbi arsimin, si pritshmëritë e ulëta për përfitimet nga avancimi në arsim.

Tabelat LN.2.8 dhe LN.2.8R paraqesin indekset e barazisë gjinore (IBGj) për shkallët neto të vijueshmërisë të adaptuara në arsimin fillor dhe të mesëm, të paraqitura në Tabelat LN.2.3, LN.2.3R, LN.2.4, LN.2.4R, LN.2.6 dhe LN.2.6R. Ato gjithashtu paraqesin indekse shtesë të barazisë që kontribuojnë në SDG 4.5.1, siç përshkruhet për Tabelat LN.1.2 dhe LN.1.2R.

Tabela LN.2.1: Gatishmëria për shkollë

Përqindja e fëmijëve që vijojnë klasën e parë të shkollës fillore dhe që kanë vijuar një program të edukimit në fëmijërinë e hershme gjatë vitit paraprak shkollor, Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve që vijojnë klasën e parë të shkollës fillore dhe që kanë vijuar një program të edukimit në fëmijërinë e hershme gjatë vitit paraprak shkollor[1]	Numri i fëmijëve që vijojnë klasën e parë të shkollës fillore
Totali	**91,5**	**366**
Gjinia		
Meshkuj	89,9	169
Femra	92,8	197
Vendbanimi		
Urban	89,2	213
Rural	94,6	153
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	8
Fillor	(*)	10
I mesëm i ulët	92,8	98
I mesëm i lartë	90,8	104
I lartë	93,0	146
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Shqiptar	92,6	339
Serb	(*)	5
Grupe të tjera etnike	(*)	21
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	89,4	75
Të dytët	89,8	62
Mesatar	92,3	90
Të katërtit	82,5	52
Më të pasurit	99,1	86

[1] **Treguesi MICS LN.3 - Gatishmëria për shkollë**

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.2.2: Hyrja në shkollë fillore

Përqindja e fëmijëve të moshës së fillimit të shkollës fillore që regjistrohen në klasën e parë (shkalla neto e regjistrimit), Kosovë, 2025

	Përqindja e fëmijëve në moshën e hyrjes në shkollë fillore që regjistrohen në klasën e parë[1]	Numri i fëmijëve në moshën e hyrjes në shkollë fillore
Totali	**87,4**	**365**
Gjinia		
Meshkuj	82,8	188
Femra	92,3	177
Vendbanimi		
Urban	87,0	202
Rural	88,0	163
Arsimimi i nënës		
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	10
Fillor	(*)	4
I mesëm i ulët	91,6	93
I mesëm i lartë	79,7	121
I lartë	92,3	133
Mungon/ND	(*)	5
Grupi etnik i kryefamiljarit		
Shqiptar	88,7	335
Serb	(*)	10
Grupe të tjera etnike	(*)	21
Kuintili i indeksit të pasurisë		
Më të varfërit	87,3	67
Të dytët	92,3	67
Mesatar	87,2	98
Të katërtit	83,0	54
Më të pasurit	86,6	79

[1] **Treguesi MICS LN.4 - Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor**

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.2.3: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës fillore

Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore në fillim të vitit shkollor që vijojnë shkollën fillore, të mesme të ulët ose të mesme të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar), përqindja që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme dhe përqindja jashtë shkolle, sipas gjinisë, Kosovë, 2025

	Meshkuj				Femra				Totali			
		Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:		
	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Fillore	Që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës fillore në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Fillore	Që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës fillore në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Fillore[1]	Që vijojnë edukimin në fëmijërinë e hershme	Jashtë shkolle[2,A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës fillore në fillim të vitit shkollor
Totali	**94,8**	**3,4**	**1,8**	**961**	**97,2**	**1,5**	**1,3**	**879**	**96,0**	**2,5**	**1,6**	**1.841**
Vendbanimi												
Urban	94,1	4,4	1,5	481	96,7	1,6	1,7	456	95,4	3,0	1,6	937
Rural	95,5	2,3	2,2	481	97,8	1,4	0,8	423	96,6	1,9	1,5	904
Mosha në fillim të vitit shkollor												
6	82,8	13,9	3,2	188	92,3	5,5	2,2	177	87,4	9,8	2,7	365
7	95,7	2,6	1,6	198	97,8	2,2	0,0	155	96,7	2,4	0,9	353
8	97,7	0,5	1,8	203	99,3	0,0	0,7	169	98,4	0,3	1,3	373
9	98,3	0,0	1,7	179	98,7	0,0	1,3	184	98,5	0,0	1,5	363
10	99,1	0,0	0,9	194	98,1	0,0	1,9	194	98,6	0,0	1,4	387
Arsimimi i nënës												
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	21	(*)	(*)	(*)	20	(79,0)	(2,1)	(18,9)	40
Fillor	(*)	(*)	(*)	21	(95,4)	(0,0)	(4,6)	21	97,7	0,0	2,3	42
I mesëm i ulët	96,2	1,8	2,0	297	99,1	0,7	0,2	266	97,5	1,3	1,2	563
I mesëm i lartë	91,1	5,8	3,1	293	98,8	1,2	0,0	273	94,8	3,6	1,6	567
I lartë	96,6	2,7	0,7	329	96,5	2,7	0,8	295	96,5	2,7	0,8	624
Mungon/ND	-	-	-	0	(*)	(*)	(*)	5	(*)	(*)	(*)	5
Grupi etnik i kryefamiljarit												
Shqiptar	95,7	3,0	1,3	893	97,8	1,5	0,7	805	96,7	2,3	1,1	1.698
Serb	(*)	(*)	(*)	24	(96,0)	(4,0)	(0,0)	33	83,4	10,6	6,0	58
Grupe të tjera etnike	(92,9)	(1,9)	(5,1)	45	(87,2)	(0,0)	(12,8)	41	90,2	1,0	8,8	86
Kuintili i indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	95,9	0,9	3,2	191	95,0	2,1	2,9	198	95,4	1,5	3,1	389
Të dytët	95,6	3,2	1,2	207	99,6	0,4	0,0	161	97,4	1,9	0,7	368
Mesatar	93,9	4,1	2,0	202	97,7	1,5	0,9	184	95,7	2,9	1,4	387
Të katërtit	95,3	3,6	1,0	169	95,3	1,8	2,8	137	95,3	2,8	1,8	305
Më të pasurit	93,4	4,9	1,7	193	98,4	1,6	0,0	199	95,9	3,2	0,8	392

1 Treguesi MICS LN.5a - Shkalla neto e vijueshmërisë në shkollën fillore (e adaptuar)

[2] Treguesi MICS LN.6a - Shkalla e fëmijëve jashtë shkolle për fëmijët e moshës së shkollës fillore

[A] Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore jashtë shkolle janë ata që nuk vijojnë asnjë nivel të arsimit.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

"–" Tregon 0 raste të papeshuara në emërues.

Tabela LN.2.4: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të ulët

Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët në fillim të vitit shkollor që vijojnë shkollën e mesme të ulët ose më të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar), përqindja që vijojnë shkollën fillore dhe përqindja jashtë shkolle, sipas gjinisë, Kosovë, 2025

	Meshkuj				Femra				Totali			
		Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:				Përqindja e fëmijëve:		
	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e ulët	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e ulët	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët në fillim të vitit shkollor	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e ulët[1]	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[2,A]	Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët në fillim të vitit shkollor
Totali	**94,3**	**4,5**	**1,2**	**828**	**95,2**	**3,5**	**1,3**	**776**	**94,7**	**4,0**	**1,3**	**1.604**
Vendbanimi												
Urban	90,7	7,1	2,1	420	95,1	2,6	2,3	390	92,8	4,9	2,2	810
Rural	97,9	1,8	0,3	408	95,4	4,4	0,2	386	96,7	3,0	0,3	794
Mosha në fillim të vitit shkollor												
11	83,3	15,8	0,9	222	88,1	11,7	0,2	203	85,6	13,8	0,5	425
12	97,4	0,9	1,6	215	97,1	1,3	1,5	178	97,3	1,1	1,6	394
13	99,7	0,0	0,3	184	98,6	0,0	1,4	203	99,1	0,0	0,9	387
14	98,0	0,0	2,0	207	97,4	0,4	2,1	191	97,7	0,2	2,1	398
Arsimimi i nënës[B]												
Parafillor ose nuk ka arsimim	(*)	(*)	(*)	15	(62,7)	(20,5)	(16,8)	26	(68,0)	(13,9)	(18,0)	41
Fillor	(85,2)	(8,0)	(6,8)	35	(92,4)	(7,6)	(0,0)	31	88,6	7,8	3,6	66
I mesëm i ulët	95,7	3,8	0,6	326	96,5	2,1	1,4	288	96,0	3,0	1,0	614
I mesëm i lartë	95,1	4,4	0,4	277	96,9	3,1	0,0	256	96,0	3,8	0,2	533
I lartë	93,6	5,4	1,0	176	96,1	3,1	0,8	175	94,9	4,2	0,9	351
Grupi etnik i kryefamiljarit												
Shqiptar	94,6	4,6	0,8	762	97,4	2,1	0,5	702	95,9	3,4	0,6	1.464
Serb	(*)	(*)	(*)	25	(*)	(*)	(*)	36	(90,5)	(8,6)	(0,9)	61
Grupe të tjera etnike	(85,8)	(5,2)	(9,0)	41	(65,1)	(17,8)	(17,1)	38	75,8	11,3	12,9	79
Kuintili i indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	92,8	4,1	3,1	188	91,6	4,8	3,7	178	92,2	4,4	3,4	366
Të dytët	95,6	3,5	0,8	152	97,5	2,1	0,5	178	96,6	2,7	0,6	330
Mesatar	96,9	1,9	1,1	172	95,4	4,2	0,5	145	96,2	3,0	0,8	317
Të katërtit	91,7	8,0	0,3	149	97,7	1,3	1,0	118	94,4	5,0	0,6	267
Më të pasurit	94,3	5,3	0,4	167	95,0	4,7	0,4	157	94,6	5,0	0,4	324

[1] Treguesi MICS LN.5b - Shkalla neto e vijueshmërisë në shkollën e mesme të ulët (e adaptuar)

[2] Treguesi MICS LN.6b - Shkalla e fëmijëve jashtë shkolle për fëmijët e moshës së shkollës së mesme të ulët

[A] Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët jashtë shkolle janë ata që nuk vijojnë asnjë nivel të arsimit.

[B] Zbërthimi sipas arsimit të nënës nuk është i disponueshëm për fëmijët e moshës 15-17 vjeç të identifikuar si të emancipuar ose ata të moshës 18 vjeç në kohën e intervistës.

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

Tabela LN.2.5: Mosha për klasë

Shpërndarja në përqindje e fëmijëve që vijojnë shkollën fillore dhe shkollën e mesme të ulët që janë nën moshën zyrtare, në moshën zyrtare dhe mbi moshën zyrtare për 1 vit dhe 2 ose më shumë vite për klasën që vijojnë, Kosovë, 2025

	Shkolla fillore						Shkolla e mesme e ulët					
	Përqindja e fëmijëve sipas klasës që vijojnë:						Përqindja e fëmijëve sipas klasës që vijojnë:					
	Nën moshë	Në moshë zyrtare	Mbi moshë për 1 vit	Mbi moshë për 2 ose më shumë vite[1]	Totali	Numri i fëmijëve që vijojnë shkollën fillore	Nën moshë	Në moshë zyrtare	Mbi moshë për 1 vit	Mbi moshë për 2 ose më shumë vite[2]	Totali	Numri i fëmijëve që vijojnë shkollën e mesme të ulët
Totali	**11,0**	**74,6**	**12,0**	**2,4**	**100,0**	**1.811**	**21,0**	**68,5**	**9,3**	**1,2**	**100,0**	**1.527**
Gjinia												
Meshkuj	10,0	75,1	12,7	2,2	100,0	936	21,0	67,5	10,5	1,0	100,0	775
Femra	12,1	74,1	11,3	2,6	100,0	875	21,0	69,6	8,0	1,4	100,0	753
Vendbanimi												
Urban	9,7	73,8	13,4	3,2	100,0	903	19,7	67,8	10,9	1,6	100,0	749
Rural	12,4	75,5	10,6	1,5	100,0	908	22,2	69,2	7,7	0,9	100,0	778
Arsimimi i nënës[A]												
Parafillor ose nuk ka arsimim	(0,0)	(66,6)	(21,7)	(11,7)	100,0	35	(23,4)	(59,0)	(5,0)	(12,5)	100,0	31
Fillor	12,3	54,0	21,6	12,1	100,0	47	14,0	62,3	20,3	3,4	100,0	62
I mesëm i ulët	12,5	75,3	9,7	2,4	100,0	558	19,8	68,1	11,4	0,7	100,0	592
I mesëm i lartë	11,2	73,4	14,4	0,9	100,0	549	22,2	68,5	7,7	1,5	100,0	508
I lartë	9,3	77,6	10,7	2,4	100,0	618	22,4	71,5	6,1	0,0	100,0	334
Mungon/ND	(*)	(*)	(*)	(*)	100,0	5	-	-	-	-	-	0
Klasa												
1 (fillore)	9,6	76,3	10,7	3,5	100,0	366	na	na	na	na	na	na
2 (fillore)	11,6	73,6	12,7	2,0	100,0	350	na	na	na	na	na	na
3 (fillore)	11,5	73,4	13,4	1,7	100,0	374	na	na	na	na	na	na
4 (fillore)	11,3	73,1	11,3	4,3	100,0	348	na	na	na	na	na	na
5 (fillore)	11,1	76,5	11,9	0,6	100,0	373	na	na	na	na	na	na
6 (e mesme e ulët)	na	na	na	na	na	na	12,4	74,2	11,2	2,2	100,0	358
7 (e mesme e ulët)	na	na	na	na	na	na	26,6	61,2	11,3	0,8	100,0	397
8 (e mesme e ulët)	na	na	na	na	na	na	22,5	67,1	9,6	0,8	100,0	391
9 (e mesme e ulët)	na	na	na	na	na	na	21,6	72,3	4,9	1,1	100,0	381
Grupi etnik i kryefamiljarit												
Shqiptar	11,1	76,4	11,0	1,6	100,0	1.680	20,3	69,8	8,9	1,0	100,0	1.401
Serb	(11,4)	(29,6)	(41,9)	(17,1)	100,0	45	(47,3)	(48,1)	(4,6)	(0,0)	100,0	61
Grupe të tjera etnike	9,2	63,5	16,6	10,7	100,0	87	9,9	60,7	21,7	7,7	100,0	64

Tabela LN.2.5: Mosha për klasë

Shpërndarja në përqindje e fëmijëve që vijojnë shkollën fillore dhe shkollën e mesme të ulët që janë nën moshën zyrtare, në moshën zyrtare dhe mbi moshën zyrtare për 1 vit dhe 2 ose më shumë vite për klasën që vijojnë, Kosovë, 2025

	Shkolla fillore						Shkolla e mesme e ulët					
	Përqindja e fëmijëve sipas klasës që vijojnë:						Përqindja e fëmijëve sipas klasës që vijojnë:					
	Nën moshë	Në moshë zyrtare	Mbi moshë për 1 vit	Mbi moshë për 2 ose më shumë vite[1]	Totali	Numri i fëmijëve që vijojnë shkollën fillore	Nën moshë	Në moshë zyrtare	Mbi moshë për 1 vit	Mbi moshë për 2 ose më shumë vite[2]	Totali	Numri i fëmijëve që vijojnë shkollën e mesme të ulët
Kuintili i indeksit të pasurisë												
Më të varfërit	12,2	71,3	12,9	3,6	100,0	384	21,2	64,8	11,8	2,1	100,0	343
Të dytët	12,0	74,5	11,4	2,1	100,0	362	19,0	70,6	8,7	1,6	100,0	323
Mesatar	9,9	77,5	9,6	3,0	100,0	371	18,9	71,2	9,1	0,8	100,0	306
Të katërtit	10,2	73,6	14,7	1,5	100,0	300	26,7	66,0	6,7	0,6	100,0	247
Më të pasurit	10,5	76,0	11,9	1,6	100,0	395	20,3	69,8	9,1	0,8	100,0	308

[1] Treguesi MICS LN.10a - Mbi moshë për klasën (Shkolla fillore)

[2] Treguesi MICS LN.10b - Mbi moshë për klasën (Shkolla e mesme e ulët)

[A] Zbërthimi sipas arsimit të nënës nuk është i disponueshëm për fëmijët e moshës 15-17 vjeç të identifikuar si të emancipuar ose ata të moshës 18 vjeç në kohën e intervistës.

na: nuk aplikohet

( ) Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara.

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara.

"–" Tregon 0 raste të papeshuara në emërues.

Tabela LN.2.6: Vijueshmëria e shkollës tek fëmijët e moshës së shkollës së mesme të lartë

Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë në fillim të vitit shkollor që vijojnë shkollën e mesme të lartë ose më të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar), përqindja që vijojnë shkollën e mesme të ulët, përqindja që vijojnë shkollën fillore dhe përqindja jashtë shkolle, sipas gjinisë, Kosovë, 2025

	Meshkuj					Femra					Totali				
		Përqindja e fëmijëve:			Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë në fillim të vitit shkollor		Përqindja e fëmijëve:			Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë në fillim të vitit shkollor		Përqindja e fëmijëve:			Numri i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë në fillim të vitit shkollor
	Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e lartë	Që vijojnë shkollën e mesme të ulët	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]		Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e lartë	Që vijojnë shkollën e mesme të ulët	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[A]		Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar): Shkolla e mesme e lartë	Që vijojnë shkollën e mesme të ulët	Që vijojnë shkollën fillore	Jashtë shkolle[2.A]	
Totali	**87,1**	**2,5**	**0,0**	**12,0**	**550**	**90,5**	**2,1**	**0,0**	**9,7**	**565**	**88,8**	**2,3**	**0,0**	**10,9**	**1.115**
Vendbanimi															
Urban	87,5	1,6	0,0	12,6	266	90,4	2,0	0,0	9,2	290	89,0	1,8	0,0	10,9	556
Rural	86,7	3,4	0,0	11,4	284	90,5	2,1	0,0	10,3	275	88,6	2,8	0,0	10,9	559
Mosha në fillim të vitit shkollor															
15	87,8	5,6	0,0	6,6	178	87,5	6,9	0,0	5,6	160	87,7	6,2	0,0	6,1	338
16	86,3	1,2	0,0	12,5	209	93,4	0,3	0,0	6,3	218	89,9	0,7	0,0	9,3	428
Komponenti i fundit në llogaritjen e peshave të mostrës merr parasysh nivelin e mospërgjigjes për intervistat e ekonomive familjare dhe intervistat individuale sipas shtresës, si dhe shkallën e përfundimit të grupimeve të mostrës për secilën shtresë. Përshtatja (rregullimi) për mospërgjigjen në nivel të grupimit dhe ekonomisë familjare në secilën shtresë është e barabartë me:

$$\frac{n_h}{n'_h} \times \frac{1}{RR_h}$$

ku RR_h është shkalla e përgjigjes për ekonomitë familjare të mostrës në shtresën *h*, e përkufizuar si proporcioni i numrit të ekonomive familjare të intervistuara në shtresën *h* ndaj numrit të ekonomive familjare të përzgjedhura që u gjetën të banuara gjatë punës në terren në shtresën *h*. Termi n'_h është numri i grupimeve të mostrës me numërim të plotë në shtresën *h*, prandaj faktori i parë i përshtatjes korrespondon me të anasjellën e shkallës së përfundimit të grupimeve të mostrës për shtresën h. Ky faktor shtesë i përshtatjes nevojitet në rastet kur disa grupime të mostrës nuk mund të numërohen në disa shtresa për shkak të problemeve të sigurisë ose qasjes. Në rastet kur të gjitha grupimet e mostrës në secilën shtresë numërohen, ky faktor i përshtatjes së grupimeve është i barabartë me 1 për të gjitha shtresat, prandaj nuk ndikon në peshë. Kjo përshtatje e peshës së ekonomisë familjare bazuar në shkallën e përfundimit të grupimeve është përfshirë në formulat përkatëse në shablonin e MICS për llogaritjen e peshave.

Ngjashëm, përshtatja për mospërgjigje në nivel individual (femra, meshkuj dhe fëmijë nën moshën 5 vjeç) për secilën shtresë është e barabartë me:

$$\frac{1}{RR_{qh}}$$

ku RR_{qh} është shkalla e përgjigjes për pyetësorët individualë në shtresën *h*, e përkufizuar si proporcioni i individëve të kualifikueshëm (femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeç) në ekonomitë familjare të mostrës në shtresën *h*, të cilët u intervistuan me sukses.

Pas përfundimit të punës në terren, shkallët e përgjigjes u llogaritën për secilën shtresë të mostrimit. Ato u përdorën për përshtatjen e peshave të mostrës të llogaritura për secilin grupim. Shkallët e përgjigjes në MICS 2025 paraqiten në Tabelën SR.1.1 të këtij raporti.

Faktorët e përshtatjes për mospërgjigje për pyetësorët individualë të femrave dhe pyetësorët për fëmijët nën moshën 5 vjeç u aplikuan në peshat e përshtatura të ekonomive familjare. Numri i femrave dhe i fëmijëve nën moshën 5 vjeç të kualifikueshëm u mor nga lista e anëtarëve të ekonomisë familjare në Pyetësorin e Ekonomisë Familjare për ekonomitë familjare në të cilat intervistat ishin përfunduar.

Peshat për pyetësorin individual për meshkuj u llogaritën në mënyrë të ngjashme. Në këtë rast, si numërues i faktorit të përshtatjes për mospërgjigje u përdor numri i meshkujve të kualifikueshëm në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare në të gjitha ekonomitë familjare të mostrës së MICS në shtresë, ndërsa numri i pyetësorëve të përfunduar për meshkuj në shtresë u mor nga nënmostra prej 50% e ekonomive familjare. Prandaj, përveç përshtatjes për mospërgjigje ndaj pyetësorit individual për meshkuj, ky faktor i përshtatjes përfshin edhe një faktor të nënkuptuar peshimi prej 2 për nënmostrimin.

Në rastin e pyetësorit për fëmijët e moshës 5–17 vjeç, në secilën ekonomi familjare të mostrës u përzgjodh rastësisht një fëmijë nga të gjithë fëmijët e kësaj grupmoshe të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare, duke përbërë në fakt një njësi terciare të mostrimit. Pesha e ekonomisë familjare për fëmijët e moshës 5–17 vjeç përshtatet fillimisht bazuar në shkallën e përgjigjes për këtë pyetësor në nivel të shtresës. Pasi kjo peshë e përshtatur e ekonomisë familjare normalizohet siç përshkruhet më poshtë, ajo shumëzohet me numrin e fëmijëve të moshës 5–17 vjeç të regjistruar në listën e anëtarëve të ekonomisë familjare. Prandaj, peshat për fëmijët individualë të moshës 5–17 vjeç ndryshojnë sipas ekonomisë familjare të mostrës. Ky peshim i të dhënave për fëmijët e moshës 5–17 vjeç zbatohet në programet e tabulimit për tabelat përkatëse.

Peshat e plota (të papërpunuara) të MICS 2025 për ekonomitë familjare u llogaritën duke shumëzuar të anasjellën e probabiliteteve të përzgjedhjes me faktorin e përshtatjes për mospërgjigje për secilën shtresë. Këto pesha më pas u standardizuan (ose u normalizuan), ndër të tjera me qëllim që shuma e peshuar e njësive të intervistuara të mostrës të ishte e barabartë me madhësinë totale të mostrës në nivel kombëtar. Normalizimi realizohet duke pjesëtuar peshat e plota të mostrës (të përshtatura për mospërgjigje) me mesataren e këtyre peshave për të gjitha ekonomitë familjare në nivel kombëtar. Kjo kryhet duke shumëzuar peshat e mostrës me një faktor konstant, të barabartë me numrin e papeshuar të ekonomive familjare në nivel kombëtar, pjesëtuar me numrin

total të peshuar të ekonomive familjare (duke përdorur peshat e plota të mostrës të përshtatura për mospërgjigje). Një procedurë e ngjashme standardizimi u ndoq për përftimin e peshave të standardizuara për pyetësorët individualë të femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeç. Peshat e përshtatura (të normalizuara) të ekonomive familjare varionin nga 0,379315 deri në 4,813043 në 366 qarqet regjistruese (grupimet) e mostrës.

Përveç peshave individuale për llogaritjen e treguesve për femrat dhe meshkujt e moshës 15–49 vjeç, nevojitet gjithashtu tabulimi i treguesve përkatës për popullsinë e kombinuar të të rriturve të moshës 15–49 vjeç. Në këtë rast, nuk është e mundur të përdoren peshat individuale të normalizuara për meshkujt dhe femrat, pasi meshkujt dhe femrat e moshës 15–49 vjeç në mostër janë përzgjedhur me probabilitete të ndryshme përzgjedhjeje. Prandaj, është e nevojshme të llogariten pesha të tjera të normalizuara për popullsinë e kombinuar të moshës 15–49 vjeç. Peshat e plota (të papërpunuara) të përshtatura për femrat dhe meshkujt e moshës 15–49 vjeç pasqyrojnë probabilitetet përkatëse të këtyre individëve në raport me kornizën e mostrimit. Rrjedhimisht, është e nevojshme të llogariten peshat për popullsinë e të rriturve duke normalizuar në nivel kombëtar peshat e papërpunuara të përshtatura, të kombinuara për femrat dhe meshkujt. Kjo realizohet duke llogaritur peshën mesatare të papërpunuar të përshtatur nga shuma e peshave të kombinuara të femrave dhe meshkujve dhe duke pjesëtuar të gjitha peshat individuale të papërpunuara të përshtatura për femrat dhe meshkujt me këtë mesatare të kombinuar. Në këtë rast, peshat e popullsisë së të rriturve normalizohen duke shumëzuar peshat individuale të papërpunuara të përshtatura për femrat dhe meshkujt me një faktor të barabartë me shumën e numrit total (të papeshuar) të femrave dhe meshkujve të moshës 15–49 vjeç në mostër, të intervistuar në nivel kombëtar, pjesëtuar me shumën e numrit total të peshuar të femrave dhe meshkujve, duke përdorur peshat përkatëse të papërpunuara të përshtatura. Shablloni i MICS për llogaritjen e peshave ka kolona të veçanta për peshat e standardizuara të popullsisë për femrat dhe meshkujt, dhe këto pesha të standardizuara bashkohen me të dhënat përkatëse për femrat dhe meshkujt që përdoren për tabulimin e treguesve për popullsinë e kombinuar.

Peshat e mostrës iu shtuan të gjitha grupeve të të dhënave dhe analizat u kryen duke peshuar të dhënat për ekonomitë familjare, femrat, meshkujt, femrat dhe meshkujt së bashku, fëmijët nën moshën 5 vjeç, si dhe fëmijët dhe adoleshentët e moshës 5–17 vjeç. Për vlerësimet e popullsisë së kombinuar të femrave dhe meshkujve, grupet përkatëse të të dhënave u bashkëngjitën dhe u kombinuan përkohësisht, ndërsa gjatë analizës u aplikuan peshat përkatëse.

A.2 DIZAJNI I MOSTRËS PËR MOSTRËN E MICS 2025 PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

Për përzgjedhjen e mostrës së anketës u përdor një qasje dyfazëshe e mostrimit të stratifikuar në grupime. Korniza e mostrimit u bazua në Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave të Kosovës të vitit 2024.

Mostra e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë u dizajnua për të prodhuar vlerësime për një numër të madh treguesish mbi gjendjen e fëmijëve dhe femrave në nivel kombëtar, si dhe për vendbanimet urbane dhe rurale. Njësitë kryesore të mostrimit (NjKM) të përzgjedhura në fazën e parë ishin QR-të e përcaktuara për Regjistrimin e Popullsisë 2024, të cilat kishin të paktën 10 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane. Gjithsej u përzgjodhën 80 QR, prej të cilave 16 QR me 66 ose më shumë ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane u përzgjodhën me probabilitet 1, ndërsa 64 QR-të e mbetura u përzgjodhën në mënyrë sistematike nga pjesa e mbetur e kornizës, me probabilitet proporcional me madhësinë. Të 16 QR-të vetëpërfaqësuese përbënin shtresën e parë, ndërsa 64 QR-të e mbetura përbënin shtresën e dytë. Përzgjedhja urbane/rurale u realizua duke përdorur stratifikim të nënkuptuar brenda secilës prej dy shtresave kryesore.

Pas realizimit të listimit të ekonomive familjare në QR-të e përzgjedhura, me qëllim identifikimin e ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, në secilin QR të mostrës u përzgjodh një mostër sistematike prej 20 ekonomish familjare. Në QR-të me më pak se 20 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, të gjitha ekonomitë familjare u përfshinë në mostër. Një QR nuk kishte asnjë ekonomi familjare Rome, Ashkali ose

Egjiptiane dhe u përjashtua nga mostra. Meqenëse mostra nuk është e vetëpeshuar, për raportimin e rezultateve të anketës përdoren peshat e mostrës.

A.2.1. MADHËSIA E MOSTRËS DHE ALOKIMI I MOSTRËS

Madhësia fillestare e mostrës për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë u llogarit në rreth 1.488 ekonomi familjare, sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë. Për mbulimin e kësaj nënpopullsie nevojitej një lloj i veçantë i kornizës së mostrimit, siç përshkruhet më poshtë:

Sipas Regjistrimit të Popullsisë të Kosovës të vitit 2024, në Kosovë kishte vetëm 7.125 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, ose rreth 2 përqind të të gjitha ekonomive familjare. Ekonomia familjare Rome, Ashkali ose Egjiptiane përkufizohet si ekonomi familjare me të paktën një person nga grupet etnike Rom, Ashkali ose Egjiptian. Për të shqyrtuar shpërndarjen gjeografike të ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, stafi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tabuloi, sipas QR-së, numrin total të ekonomive familjare me të paktën një person nga këto grupe etnike. Gjithsej u identifikuan 1.767 QR me të paktën një ekonomi familjare Rome, Ashkali ose Egjiptiane, por më shumë se një e treta e tyre (650 QR) kishin vetëm një deri në tri ekonomi familjare Rom, Ashkali ose Egjiptiane. QR-të u renditën në rend zbritës sipas numrit të ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane. U konstatua se 180 QR kishin 10 ose më shumë ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane dhe se këto QR përfshinin 75,2 përqind të të gjitha ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë.

U vendos se do të ishte me kosto të efektshme dhe e përshtatshme nga pikëpamja analitike që MICS për popullsinë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të kufizohej në QR-të me 10 ose më shumë ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane. Pesë QR kishin më shumë se 100 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, ndërsa 23 QR të tjera kishin ndërmjet 50 dhe 99 ekonomi familjare me persona nga këto grupe etnike. Kishte 152 QR me ndërmjet 10 dhe 49 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane.

Një pjesë e popullsisë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të identifikuar në Regjistrimin e Popullsisë të Kosovës të vitit 2024 mund të jetë zhvendosur që nga ajo kohë, duke pasur parasysh shkallën potencialisht më të lartë të migrimit të këtij grupi të popullsisë në kërkim të mundësive në zona të tjera të Kosovës ose në vendet e rajonit. Prandaj, numri aktual i ekonomive familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në QR-të e mostrës do të dihet vetëm pas një listimi të ri të ekonomive familjare, me qëllim identifikimin e atyre që kanë të paktën një anëtar Rom, Ashkali ose Egjiptian.

A.2.2. AKTIVITETET E LISTIMIT

Duke pasur parasysh se kishte pasur ndryshime në ekonomitë familjare të regjistruara në Regjistrimin e Popullsisë 2024, para përzgjedhjes së ekonomive familjare u realizua një listim i ri i ekonomive familjare në të gjitha qarqet regjistruese të mostrës. Për këtë qëllim, ekipet e listimit u trajnuan për të vizituar të gjitha qarqet regjistruese të përzgjedhura dhe për të listuar të gjitha ekonomitë familjare në secilin qark regjistrues. Ato gjithashtu pyetën nëse në ekonominë familjare jetonte ndonjë person nga grupet etnike Rom, Ashkali ose Egjiptian, me qëllim përcaktimin e numrit total të ekonomive familjare nga i cili do të përzgjidheshin rastësisht 20 ekonomi familjare. Në mars 2025 u mbajt një trajnim i veçantë katërditor për listimin, i cili përfshiu edhe një anketë pilot në zona urbane, gjysmë-urbane dhe rurale, në përputhje me procedurat e rekomanduara të MICS. Të njëjtët listues që punuan në mostrën kombëtare mbuluan edhe mostrën për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Aktiviteti i listimit për 80 QR-të u realizua gjatë periudhës prill–korrik 2025. Për më shumë informacion mbi aktivitetin e listimit, shihni Seksionin A.1.3 të kësaj shtojce.

Gjatë aktivitetit të listimit, një QR i mostrës nuk kishte asnjë ekonomi familjare Rome, Ashkali ose Egjiptiane, ndërsa 22 QR të mostrës kishin më pak se 20 ekonomi familjare (18 QR urbane dhe 4 QR rurale). Të gjitha ekonomitë familjare të listuara në këto 20 QR të mostrës u përzgjodhën në mostër, duke e çuar madhësinë përfundimtare të mostrës në 1.436 ekonomi familjare gjatë mbledhjes së të dhënave, pasi u konstatua se disa adresa përmbanin më shumë se një ekonomi familjare.

A.2.3. PËRZGJEDHJA E EKONOMIVE FAMILJARE

Bazuar në procesin e hartëzimit dhe listimit, listat e ekonomive familjare u përgatitën për secilin qark regjistrues. Më pas, ekonomitë familjare u numërtuan në mënyrë sekuenciale nga 1 deri në M_{hi} (numri total i ekonomive familjare në secilin qark regjistrues) në ASK, ku përzgjedhja e 20 ekonomive familjare në secilin qark regjistrues u krye duke përdorur procedurat e përzgjedhjes sistematike të rastësishme. Për këtë qëllim u përshtat Shablloni i MICS për përzgjedhjen sistematike të rastësishme të ekonomive familjare[105].

Nëse në një QR të caktuar të mostrës ishin listuar më pak se 20 ekonomi familjare Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, të gjitha u përzgjodhën drejtpërdrejt dhe, rrjedhimisht, ka grupime me më pak se 20 ekonomi familjare të mostrës. Për këtë qëllim u përshtat shablloni i tabelës së MICS6 për përzgjedhjen sistematike të rastësishme të ekonomive familjare[106].

Gjatë përzgjedhjes së QR-ve për MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, gjithsej 14 QR u përzgjodhën rastësisht për të dyja mostrat, atë të Kosovës dhe atë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Prandaj, nga këto QR u përzgjodh nga një mostër sistematike e veçantë prej 20 ekonomish familjare për secilën anketë. Ekonomitë familjare të përzgjedhura për të dyja mostrat u mbajtën në të dy grupet e të dhënave.

Anketa përfshiu gjithashtu një pyetësor individual për meshkuj, i cili duhej të administrohej në gjysmën e mostrës së ekonomive familjare. Shablloni i MICS për përzgjedhjen e ekonomive familjare përfshin një opsion për të specifikuar proporcionin e ekonomive familjare që do të përzgjidhen për administrimin e pyetësorit individual për meshkuj, ndërsa tabela automatikisht përzgjodhi nënmostrën përkatëse të ekonomive familjare. Të gjithë meshkujt e moshës 15–49 vjeç në ekonomitë familjare të përzgjedhura ishin të kualifikueshëm për intervistë.

A.2.4. LLOGARITJA E PESHAVE TË MOSTRËS

Mostra e MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë nuk është e vetëpeshuar. Disa nga QR-të e mostrës u përzgjodhën me probabilitet 1 në fazën e parë të mostrimit, ndërsa numri i ekonomive familjare të listuara në secilin QR përgjithësisht ndryshonte nga numri përkatës në kornizën e regjistrimit të popullsisë. Për këtë arsye, peshat e mostrës u llogaritën dhe u përdorën në analizat pasuese të të dhënave të anketës. Në thelb, në mostrën e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ka 16 QR vetëpërfaqësuese dhe 64 QR jo vetëpërfaqësuese. Këtu, shtresa i referohet secilit prej QR-ve vetëpërfaqësuese dhe një shtrese kryesore për QR-të jo vetëpërfaqësuese.

Komponenti kryesor i peshës është reciproku i fraksionit të mostrimit të përdorur për përzgjedhjen e numrit të ekonomive familjare të mostrës në atë shtresë të veçantë të mostrimit (h) dhe NjKM (i):

$$W_{hi} = \frac{1}{f_{hi}}$$

[106] Në dispozicion këtu: "MICS7 TOOLS", Home – UNICEF MICS. Qasur më 31 gusht 2018. https://mics.unicef.org/tools#survey-design.

Termi f_{hi}, probabiliteti i mostrimit për ekonomitë familjare në NjKM-në e *i*-të të mostrës në shtresën e *h*-të, është produkti i probabiliteteve të përzgjedhjes në çdo fazë në secilën shtresë të mostrimit:

$$f_{hi} = p_{1hi} \times p_{2hi} \times p_{3hi}$$

ku p_{shi} është probabiliteti i përzgjedhjes së njësisë së mostrimit në fazën *s* për NjKM-në e *i*-të të mostrës në shtresën e *h*-të të mostrimit. Bazuar në dizajnin e mostrës, probabilitetet u llogaritën si në vijim:

p_{1hi} = $\frac{n_h \times M_{hi}}{M_h}$; në rastin e QR-ve vetëpërfaqësuese të përzgjedhura në fazën e parë të mostrimit, ky probabilitet është 1.

n_h = numri i NjKM-ve të mostrës të përzgjedhura në shtresën *h*

M_{hi} = numri i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë 2024 për NjKM-në e *i*-të të mostrës në shtresën *h*

M_h = numri total i ekonomive familjare në kornizën e Regjistrimit të Popullsisë 2024 për shtresën *h*

p_{2hi} = proporcioni i NjKM-së së *i*-të të mostrës në shtresën *h* që është përfshirë në listim (në rastin e NjKM-ve që janë segmentuar); për NjKM-të e pasegmentuara, p_{2hi} = 1

p_{3hi} = $\frac{20}{M'_{hi}}$

M'_{hi} = numri i ekonomive familjare të listuara në NjKM-në e *i*-të të mostrës në shtresën *h*

Meqenëse numri i ekonomive familjare në secilin qark regjistrues (NjKM), sipas kornizës së Regjistrimit të Popullsisë 2024 të përdorur për përzgjedhjen në fazën e parë, dhe numri i përditësuar i ekonomive familjare në QR nga listimi janë përgjithësisht të ndryshëm, u llogaritën probabilitetet e përgjithshme individuale të përzgjedhjes për ekonomitë familjare në secilin QR të mostrës (grupim).

Komponenti i fundit në llogaritjen e peshave të mostrës merr parasysh nivelin e mospërgjigjes për intervistat e ekonomive familjare dhe intervistat individuale sipas shtresës, si dhe shkallën e përfundimit të grupimeve të mostrës për secilën shtresë. Përshtatja për mospërgjigjen në nivel të grupimit dhe ekonomisë familjare në secilën shtresë është e barabartë me:

$$\frac{n_h}{n'_h} \times \frac{1}{RR_h}$$

ku RR_h është shkalla e përgjigjes për ekonomitë familjare të mostrës në shtresën h, e përkufizuar si proporcioni i numrit të ekonomive familjare të intervistuara në shtresën *h* ndaj numrit të ekonomive familjare të përzgjedhura që u gjetën të banuara gjatë punës në terren në shtresën *h*. Termi n'_h është numri i grupimeve të mostrës me numërim të plotë në shtresën *h*, prandaj faktori i parë i përshtatjes korrespondon me të anasjellën e shkallës së përfundimit të grupimeve të mostrës për shtresën *h*. Ky faktor shtesë i përshtatjes nevojitet në rastet kur disa grupime të mostrës nuk mund të numërohen në disa shtresa për shkak të problemeve të sigurisë ose qasjes. Në rastet kur të gjitha grupimet e mostrës në secilën shtresë numërohen, ky faktor i përshtatjes së grupimeve është i barabartë me 1 për të gjitha shtresat, prandaj nuk ndikon në peshë. Kjo përshtatje e peshës së ekonomisë familjare bazuar në shkallën e përfundimit të grupimeve është përfshirë në formulat përkatëse në shabllonin e MICS për llogaritjen e peshave.

Ngjashëm, përshtatja për mospërgjigje në nivel individual (femra, meshkuj dhe fëmijë nën moshën 5 vjeç) për secilën shtresë është e barabartë me:

$$\frac{1}{RR_{qh}}$$

ku RR_{qh} është shkalla e përgjigjes për pyetësorët individualë në shtresën *h*, e përkufizuar si proporcioni i individëve të kualifikueshëm (femrave, meshkujve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeç) në ekonomitë familjare të mostrës në shtresën *h*, të cilët u intervistuan me sukses.

Pas përfundimit të punës në terren, shkallët e përgjigjes u llogaritën për secilën shtresë të mostrimit. Këto u përdorën për të përshtatur peshat e mostrës të llogaritura për secilin grupim. Shkallët e përgjigjes në MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë paraqiten në Tabelën SR.1.1R të këtij raporti.

Procedurat për përshtatjen e peshave bazë të ekonomive familjare dhe peshave individuale për mospërgjigje, si dhe për normalizimin e peshave për MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, janë të njëjta me ato të përshkruara në Seksionin A.1.5.

SHTOJCA B LISTA E PERSONELIT TË PËRFSHIRË NË ANKETË

Anëtarët e Komitetit Teknik	
Aliriza Arënliu	Profesor i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës
Arjeta Gjikolli	Zyrtare për Monitorim dhe Vlerësim, UNICEF
Armenda Berani Shala	Zyrtare e Lartë për Planifikim të Politikave, ZQM
Arta Haliti	Konsulente vendore për MICS, UNICEF
Blerina Thaçi	Zyrtare për Përfitime Sociale dhe Përfitime për Fëmijë, MF
Diella Shabani	Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (FKEE)
Enver Mekolli	Zyrtar për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), MASh
Fetije Fetaj	Udhëheqëse e Imunizimit, IKShP
Igballe Rrahmani	Drejtore e Departamentit për të Drejtat e Fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit
Kaltrina Kelmendi	Profesore e Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës
Keriman Sadikay	Zyrtare e Lartë për Komunitete Joshumicë (Rom, Ashkali dhe Egjiptian), ZQM
Labërie Luzha	Zyrtare për EFH, MASh
Magbule Koci	Divizioni për Mbrojtjen e Fëmijëve, MD
Merita Vuthaj	Shëndeti i nënës dhe fëmijës, MSh
Qëndresa Ibra Zariqi	Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Fëmijëve, ZQM
Servete Muriqi	Koordinatore Kombëtare e MICS[107] dhe staf tjetër i ASK-së sipas nevojës
Shqipe Bruqi	Zëvendësdrejtore e Departamentit për Digjitalizim, MASh

Agjencia e Statistikave të Kosovës	
Avni Kastrati	Drejtor
Advie Uka	Metodologe dhe trajnuese
Arbert Abdyli	Metodolog dhe trajnues
Arijeta Sojeva	Metodologe dhe trajnuese
Bekim Canolli	Ekspert i mostrimit për MICS
Burim Gashi	Zyrtar për GIS dhe listim në MICS dhe mbikëqyrës i listimit
Burim Limolli	Mbikëqyrës i përpunimit të të dhënave dhe i menysë qendrore për MICS
Drita Sylejmani	Metodologe dhe trajnuese
Guxim Neziri	Zyrtar për përpunimin e të dhënave dhe furnizim
Hazbije Qeriqi	Eksperte e komunikimit
Idriz Hoxha	Zyrtar për përpunimin e të dhënave dhe furnizim
Idriz Shala	Ekspert për GIS dhe listim në MICS
Mentor Shala	Ekspert i përpunimit të të dhënave për MICS
Naime Rexhepi	Metodologe dhe trajnuese
Servete Muriqi	Koordinatore e anketës MICS dhe eksperte e mostrimit
Shpetim Bullatovci	Zyrtar për monitorimin e punës në terren dhe trajnues
Valdete Navakazi	Koordinatore e punës në terren për MICS dhe metodologe

[107] Staf shtesë i ASK-së mori pjesë në takimet e Komitetit Teknik sipas nevojës.

Zyra e UNICEF-it në Kosovë	
Arjeta Gjikolli	Zyrtare për Monitorim dhe Vlerësim
Arta Haliti	Konsulente Vendore për MICS
Donat Rexha	Konsulent për Punën në Terren për MICS
Ema Rraci	Zyrtare për Arsim
Fiona Kelmendi	Konsulente për Përkthim dhe Redaktim për MICS
Miloš Slavković	Konsulent Administrativ për MICS
Teuta Halimi	Specialiste për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve

Zyra Qendrore e UNICEF-it dhe Zyra Rajonale për Evropë dhe Azi Qendrore	
Andrea Rossi	Udhëheqës i Mbledhjes së të Dhënave dhe Koordinator Global i MICS, Zyra Qendrore e UNICEF-it
Bo Robert Beshanski-Pedersen	Specialist për Statistika dhe Monitorim, Zyra Qendrore e UNICEF-it
Turgay Ünalan	Specialist për Statistika dhe Monitorim, Zyra Qendrore e UNICEF-it
Ivana Bjelić	Menaxhere për Statistika dhe Monitorim (Përpunimi i të Dhënave), Zyra Qendrore e UNICEF-it
Yadigar Coskun	Specialist për Statistika dhe Monitorim (Përpunimi i të Dhënave), Zyra Qendrore e UNICEF-it
Ikhtier Kholmatov	Specialist për Përpunimin e të Dhënave, Zyra Qendrore e UNICEF-it
Nazim Gashi	Specialist për GIS, Zyra Qendrore e UNICEF-it
Siraj Mahmudlu	Specialist për Planifikim dhe Monitorim, Zyra Rajonale e UNICEF-it
Deepak Kumar Dey	Specialist për Monitorim dhe Vlerësim dhe Koordinator Rajonal i MICS, Zyra Rajonale e UNICEF-it
Ahmet Sinan Türkyılmaz	Specialist i Mostrimit, Zyra Rajonale e UNICEF-it
Ana Abdelbasit	Specialiste për Anketat e Ekonomive Familjare, Zyra Rajonale e UNICEF-it

Ekipet e listimit dhe hartëzimit		
Mbikëqyrësit	**Listuesit dhe hartëzuesit**	
Donat Rexha	Andi Gjocaj	Fahrie Rushiti
Miloš Slavković	Anita Gashi	Fjona Alijaj
Marigona Mehluli	Arjeta Neziri	Granit Hysaj
Burim Gashi	Atdhetare Bunjaku	Hykmete Mehmeti
	Boban Miljković	Kaltrina Beka
	Bojan Maksimović	Mirsade Morina
	Dragiša Radić	Ornela Dakaj
	Drita Pllana	Sanja Nikolčević
	Elda Hajdini	Selma Skenderović
	Eljesa Qerkini	Sibel Ibrahimi
	Elsa Mustafaj	Vesa Musaj
	Era Bejtullahu	

Ekipet e punës në terren			
Ekipi 1		**Ekipi 2**	
Adi Berisha	Mbikëqyrës	Lejla Zushi	Mbikëqyrëse
Artan Visoka	Intervistues	Anita Maxhuni	Intervistuese
Arianë Dukolli	Intervistuese	Driat Hasani	Intervistues
Erdona Kadriolli	Intervistuese	Ermira Sfishta	Intervistuese
Rina Ferizi	Intervistuese	Qemire Arifi	Intervistuese
Rinesë Obrazhda	Intervistuese	Rita Potoku	Matëse
Donjeta Haxhoviti	Matëse		
Ekipi 3		**Ekipi 4**	
Svetlana Baldini	Mbikëqyrëse	Elda Hajdini	Mbikëqyrëse
Anđela Mihajlović	Intervistuese	Agnesë Hasani	Intervistuese
Anđelija Vučinić	Intervistuese	Arlinda Hiseni	Intervistuese
Pravda Božović	Intervistuese	Bleriana Kadriolli	Intervistuese
Miloš Slavković	Intervistues	Skender Krasniqi	Intervistues
Suada Plakolli	Matëse	Flakë Ahmeti	Matëse
Ekipi 5		**Ekipi 6**	
Emrah Cermjani	Mbikëqyrës	Vesa Musaj	Mbikëqyrëse
Defrim Puraj	Intervistues	Bardha Alija	Intervistuese
Laureta Halili	Intervistuese	Edona Thaçi	Intervistuese
Maria Gojani	Intervistuese	Genita Boja	Intervistuese
Qëndresa Karaxha	Intervistuese	Rilind Çejku	Intervistues
Mergita Hoti	Matëse	Dion Dauti	Matës
Ekipi 7		**Ekipi 8**	
Ejona Neziri	Mbikëqyrëse	Arian Musa	Mbikëqyrës
Besnik Bislimi	Intervistues	Agon Gashi	Intervistues
Beta Mirena	Intervistuese	Blerinë Bytyqi	Intervistuese
Edona Selmani	Intervistuese	Rinesa Balaj	Intervistuese
Rinesë Rashiti	Intervistuese	Rudina Kastrati	Intervistuese
Elmedina Kastrati	Matëse	Learta Sylaj	Matëse
Ekipi 9		**Ekipi 10**	
Valtrim Hasani	Mbikëqyrës	Albulena Hashani	Mbikëqyrëse
Ardit Muçolli	Intervistues	Adelina Tahiri	Intervistuese
Ediola Telaku	Intervistuese	Gëzime Livoreka	Intervistuese
Erza Isufi	Intervistuese	Gyltene Osmani	Intervistuese
Prene Gojani	Intervistuese	Shkëlqim Tahiri	Intervistues
Ensar Jetishi	Matës	Jehonë Asllani	Matëse
Ekipi 11			
Kreshnik Kurteshi	Mbikëqyrës		
Blerina Halili	Intervistuese		
Elfete Krasniqi Bajrami	Intervistuese		
Krenare Dibrani	Intervistuese		
Vjosa Hashani	Intervistuese		
Riarda Murseli	Matëse		

SHTOJCA C VLERËSIMET E GABIMEVE TË MOSTRIMIT

Mostra e respondentëve të përzgjedhur në MICS 2025 për Kosovë dhe MICS 2025 për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është vetëm një nga mostrat që mund të ishte përzgjedhur nga të njëjtat popullata, duke përdorur të njëjtin dizajn dhe madhësi. Secila nga këto mostra do të jepte rezultate që do të dallonin deri diku nga rezultatet e bazuara në mostrën faktike të përzgjedhur. Gabimet e mostrimit janë masë e ndryshueshmërisë ndërmjet vlerësimeve nga të gjitha mostrat e mundshme. Shkalla e ndryshueshmërisë nuk dihet saktësisht, por mund të vlerësohet statistikisht nga të dhënat e anketës.

Masat e mëposhtme të gabimeve të mostrimit paraqiten në këtë shtojcë për secilin nga treguesit e përzgjedhur:

- *Gabimi standard* (*se*): Gabimi standard është rrënja katrore e variancës së vlerësimit. Për treguesit e anketës që janë mesatare, proporcione ose raporte, metoda e linearizimit sipas serive të Taylor-it përdoret për vlerësimin e gabimeve standarde. Për statistika më komplekse, siç janë shkallët e fertilitetit dhe vdekshmërisë, metoda Jackknife e replikimit të përsëritur përdoret për vlerësimin e gabimeve standarde.

- *Koeficienti i variacionit* (*se*/*r*) është raporti i gabimit standard ndaj vlerës (r) së treguesit dhe është masë e gabimit relativ të mostrimit.

- *Efekti i dizajnit* (*deff*) është raporti i variancës reale të një treguesi, sipas metodës së mostrimit të përdorur në anketë, ndaj variancës së llogaritur nën supozimin e mostrimit të rastësishëm të thjeshtë, bazuar në të njëjtën madhësi të mostrës. *Rrënja katrore e efektit të dizajnit (deft)* përdoret për të treguar efikasitetin e dizajnit të mostrës në raport me saktësinë. Një vlerë *deft* prej 1,0 tregon se dizajni i mostrës së anketës është po aq efikas sa një mostër e thjeshtë e rastësishme për një tregues të caktuar, ndërsa një vlerë *deft* mbi 1,0 tregon rritje të gabimit standard për shkak të përdorimit të një dizajni kompleks të mostrës. Nëse një vlerë *deft* (ose *deff*) është më e vogël se 1,0 dhe numri përkatës i vëzhgimeve është relativisht i vogël, vlerat e gabimit standard dhe kufijtë e besueshmërisë duhet të përdoren me kujdes. Këto situata mund të rrjedhin nga numri i vogël i vëzhgimeve dhe shpërndarja e vlerave të treguesit brenda dhe ndërmjet grupimeve të mostrës në fusha të tilla vlerësimi. Për më tepër, nëse në një ose më shumë shtresa të vogla, ku të gjitha QR-të përzgjidhen me probabilitet 1, përdoret mostrim i rastësishëm i stratifikuar njëfazor i ekonomive familjare, mostra e stratifikuar njëfazore mund të jetë më efikase se një mostër e thjeshtë e rastësishme përkatëse në atë shtresë. Kjo mund të rezultojë në vlera të vlefshme *deff* dhe *deft* më të vogla se 1,0.

- *Kufijtë e besueshmërisë* llogariten për të treguar intervalin që përmban vlerën e vërtetë të treguesit për popullsinë, me një nivel të caktuar besueshmërie. Për rezultatet e MICS përdoren intervale besueshmërie prej 95%, që është standarde për këtë lloj ankete. Koncepti i intervalit të besueshmërisë prej 95% mund të kuptohet kështu: nëse do të merreshin shumë mostra të përsëritura me madhësi dhe dizajn identik dhe për secilën mostër do të llogaritej intervali i besueshmërisë, atëherë 95% e këtyre intervaleve do të përmbanin vlerën e vërtetë të treguesit.

Për llogaritjen e gabimeve të mostrimit nga të dhënat e MICS, janë përdorur programe të zhvilluara në SPSS Versioni 25, duke përdorur modulin për mostra komplekse (Complex Samples). Metoda e linearizimit sipas Taylor-it është aplikuar për vlerësimin e variancës së vlerësimeve të anketës, siç janë mesataret ose proporcionet, ndërsa metoda Jackknife e replikimit të përsëritur është përdorur për statistika më komplekse, përfshirë shkallët e fertilitetit dhe vdekshmërisë. Për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është përdorur një plan i veçantë kompleks i mostrës për të marrë parasysh QR-të vetëpërfaqësuese dhe fraksionet më të larta të mostrimit. Kjo ishte e nevojshme duke pasur parasysh madhësinë relativisht të vogël të popullsisë së këtyre komuniteteve, e cila rezulton në fraksione më të larta të mostrimit. Për QR-të vetëpërfaqësuese u përdorën fraksione individuale të mostrimit në nivel të QR-së, ndërsa për 64 QR-të e mbetura jo vetëpërfaqësuese në vetvete u përdor një fraksion mesatar i mostrimit. Në shtresat vetëpërfaqësuese, QR-ja u konsiderua si shtresë e dizajnit, ndërsa ekonomitë familjare brenda QR-së u konsideruan si NjKM të dizajnit; ndërkaq, për shtresën jo vetëpërfaqësuese, QR-të u konsideruan si NjKM të dizajnit.

Rezultatet paraqiten në tabelat në vijim. Gabimet e mostrimit llogariten për treguesit e SDG-ve për të cilët mund të llogariten gabimet standarde (*se*), si dhe për disa tregues të tjerë të MICS. Përkufizimet, numëruesit dhe emëruesit e secilit prej këtyre treguesve janë paraqitur në Kapitullin 3. Rezultatet paraqiten për nivelin kombëtar (Tabela SE,1) dhe për vendbanimet urbane dhe rurale (Tabelat SE.2 dhe SE,3). Rezultatet përkatëse për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë paraqiten për nivelin kombëtar (Tabela SE.1R) dhe për vendbanimet urbane dhe rurale (Tabelat SE.2R dhe SE.3R).

Përveç masave të gabimit të mostrimit të përshkruara më sipër, tabelat përfshijnë gjithashtu numrat e peshuar dhe të papeshuar të emëruesve për secilin tregues. Duke pasur parasysh përdorimin e peshave të normalizuara, përmes krahasimit të numrave të peshuar dhe të papeshuar është e mundur të përcaktohet nëse një fushë e caktuar është nënmostruar ose mbimostruar krahasuar me shkallën mesatare të mostrimit. Nëse numri i peshuar është më i vogël se numri i papeshuar, kjo do të thotë se fusha është mbimostruar.

Megjithatë, për treguesit në vijim, numri i papeshuar përfaqëson numrin e ekonomive familjare të mostrës, ndërsa numrat e peshuar pasqyrojnë popullsinë totale të peshuar që jeton në këto ekonomi familjare.

- Qasja në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike
- Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji të pastra për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim
- Përdorimi i shërbimeve të paktën bazike të ujit të pijshëm
- Përdorimi i burimeve të përmirësuara të ujit në ambientet e banimit
- Përdorimi i burimit të përmirësuar të ujit me ujë në dispozicion kur është i nevojshëm
- Disponueshmëria e ujit të pijshëm në muajin e fundit
- Përdorimi i të paktën shërbimeve sanitare bazike
- Popullsia e mbuluar nga transferet sociale
- Fëmijët në ekonomitë familjare që kanë marrë ndonjë lloj transferi social

Tabela SE.1: Gabimet e mostrimit: Mostra totale

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	**Kufijtë e besueshmërisë**	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Mbulimi i mostrës dhe karakteristikat e respondentëve										
Qasja në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike	SR.1	1,000	0,000	0,000	0,859	0,927	24.654	5.777	0,999	1,000
Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim	SR.604	0,506	0,010	0,020	2,410	1,552	24.654	5.777	0,486	0,527
Mbijetesa										
Shkalla e vdekshmërisë neonatale (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.1	8	3,414	0,436	na	na	na	na	1	15
Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.5	13	3,998	0,311	na	na	na	na	5	21
Zhvillimi - Shëndeti riprodhues, maternal, i të porsalindurve dhe i të rriturve										
Shkalla totale e fertilitetit (numri i lindjeve të gjalla)	-	2,1	0,085	0,041	na	na	na	na	1,9	2,2
Shkalla e lindjeve tek adoleshentët (për 1.000 vajza adoleshente të moshës 15-19 vjeç)	TM.1b	4	1,535	0,385	na	na	na	na	1	7
Mbulueshmëria e kujdesit antenatal (të paktën katër herë nga cilido ofrues)	TM.5b	0,980	0,004	0,005	0,564	0,751	560	545	0,971	0,989
Zhvillimi - Shëndeti, të ushqyerit dhe zhvillimi i fëmijëve										
Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, tetanosit dhe pertusisit (DTaP)	TC.3	0,858	0,015	0,017	0,450	0,671	263	262	0,829	0,887
Mbulueshmëria me imunizim pneumokokal (konjugat)	TC.S1	0,879	0,014	0,015	0,454	0,674	263	262	0,852	0,906
Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit	TC.S2	0,828	0,020	0,024	0,782	0,885	262	276	0,787	0,868
Prevalenca e ngecjes në rritje (mesatare dhe e rëndë)	TC.45a	0,045	0,007	0,159	1,357	1,165	1.134	1.151	0,030	0,059
Prevalenca e peshës së vogël për gjatësi (mesatare dhe e rëndë)	TC.46a	0,024	0,005	0,211	1,219	1,104	1.113	1.133	0,014	0,034
Prevalenca e mbipeshës (mesatare dhe e rëndë)	TC.47a	0,077	0,007	0,094	0,831	0,911	1.113	1.133	0,062	0,091
Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030	TC.53	0,889	0,011	0,013	1,089	1,043	840	856	0,866	0,911
Mësimi dhe fitimi i aftësive										
Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (e përshtatur)	LN.2	0,875	0,016	0,018	0,807	0,898	361	345	0,843	0,907
Shkalla e përfundimit (shkolla fillore)	LN.8a	0,990	0,005	0,005	2,486	1,577	1.123	1.169	0,980	0,999
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e ulët)	LN.8b	0,981	0,006	0,006	1,983	1,408	1.045	1.086	0,970	0,993
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e lartë)	LN.8c	0,900	0,011	0,012	1,380	1,175	1.085	1.072	0,878	0,921
Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi										
Regjistrimi i lindjeve	PR.1	0,999	0,001	0,001	0,764	0,874	1.393	1.393	0,998	1,000
Disiplinimi i dhunshëm	PR.2	0,642	0,014	0,021	2,379	1,542	4.666	2.874	0,615	0,670
Fëmijët në punë	PR.3	0,093	0,008	0,087	1,832	1,353	4.582	2.389	0,077	0,109
Martesa e fëmijëve (para moshës 15 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4a	0,003	0,001	0,347	0,264	0,513	773	772	0,001	0,005
Martesa e fëmijëve (para moshës 18 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4b	0,034	0,006	0,183	0,920	0,959	773	772	0,022	0,047

Tabela SE.1: Gabimet e mostrimit: Mostra totale

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	**Kufijtë e besueshmërisë**	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Jeta në një mjedis të sigurt dhe të pastër										
Përdorimi i të paktën shërbimeve bazike të ujit të pijshëm	WS.2	0,961	0,004	0,004	2,349	1,533	24.654	5.777	0,953	0,969
Përdorimi i burimeve të përmirësuara të ujit të pijshëm në ambientet e banimit	WS.2a	0,918	0,007	0,007	3,461	1,860	24.654	5.777	0,905	0,932
Përdorimi i burimit të përmirësuar të ujit me ujë në dispozicion kur është e nevojshme	WS.2b	0,888	0,007	0,008	2,668	1,633	24.654	5.777	0,874	0,901
Disponueshmëria e ujit të pijshëm në muajin e fundit	WS.3a	0,893	0,007	0,007	2,703	1,644	24.654	5.777	0,880	0,907
Përdorimi i të paktën shërbimeve sanitare bazike	WS.9	0,950	0,007	0,008	6,359	2,522	24.654	5.777	0,936	0,965
Mundësia e barabartë në jetë										
Popullsia e mbuluar nga transferet sociale	EQ.3	0,800	0,007	0,008	1,590	1,261	24.654	5.777	0,787	0,813
Fëmijët në ekonomitë familjare që kanë marrë çfarëdo lloj transferi social	EQ.5	0,944	0,006	0,006	4,145	2,036	6.524	6.590	0,933	0,956
Diskriminimi	EQ.7	0,148	0,008	0,056	3,896	1,974	7.078	7.078	0,132	0,165

na: nuk aplikohet

Tabela SE.2: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet urbane

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	Kufijtë e besueshmërisë	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Mbulimi i mostrës dhe karakteristikat e respondentëve										
Qasja në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike	SR.1	1,000	0,000	0,000	0,773	0,879	12.727	2.831	0,999	1,000
Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim	SR.604	0,691	0,016	0,024	3,508	1,873	12.727	2.831	0,658	0,723
Mbijetesa										
Shkalla e vdekshmërisë neonatale (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.1	9	6,027	0,646	na	na	na	na	0	21
Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.5	11	6,157	0,544	na	na	na	na	0	24
Zhvillimi - Shëndeti riprodhues, maternal, i të porsalindurve dhe i të rriturve										
Shkalla totale e fertilitetit (numri i lindjeve të gjalla)	-	1,9	0,124	0,064	na	na	na	na	1,7	2,2
Shkalla e lindjeve tek adoleshentët (për 1.000 vajza adoleshente të moshës 15-19 vjeç)	TM.1b	2	1,194	0,590	na	na	na	na	0	4
Mbulueshmëria e kujdesit antenatal (të paktën katër herë nga cilido ofrues)	TM.5b	0,988	0,005	0,005	0,422	0,649	287	232	0,978	0,997
Zhvillimi - Shëndeti, të ushqyerit dhe zhvillimi i fëmijëve										
Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, tetanosit dhe pertusisit (DTaP)	TC.3	0,852	0,018	0,021	0,318	0,564	139	121	0,815	0,888
Mbulueshmëria me imunizim pneumokokal (konjugat)	TC.S1	0,874	0,016	0,018	0,273	0,522	139	121	0,842	0,905
Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit	TC.S2	0,807	0,038	0,048	1,028	1,014	121	109	0,731	0,884
Prevalenca e ngecjes në rritje (mesatare dhe e rëndë)	TC.45a	0,040	0,010	0,255	1,294	1,137	546	477	0,020	0,061
Prevalenca e peshës së vogël për gjatësi (mesatare dhe e rëndë)	TC.46a	0,028	0,008	0,288	1,119	1,058	535	468	0,012	0,044
Prevalenca e mbipeshës (mesatare dhe e rëndë)	TC.47a	0,074	0,010	0,130	0,631	0,794	535	468	0,054	0,093
Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030	TC.53	0,890	0,015	0,017	0,826	0,909	413	360	0,860	0,920
Mësimi dhe fitimi i aftësive										
Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (e përshtatur)	LN.2	0,854	0,026	0,031	0,864	0,930	189	159	0,802	0,906
Shkalla e përfundimit (shkolla fillore)	LN.8a	0,982	0,009	0,009	2,475	1,573	579	553	0,965	1,000
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e ulët)	LN.8b	0,974	0,011	0,011	2,281	1,510	525	506	0,953	0,995
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e lartë)	LN.8c	0,922	0,014	0,016	1,419	1,191	563	494	0,893	0,950
Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi										
Regjistrimi i lindjeve	PR.1	0,999	0,001	0,001	0,651	0,807	705	597	0,997	1,000
Disiplinimi i dhunshëm	PR.2	0,603	0,023	0,037	2,742	1,656	2.354	1.294	0,558	0,648
Fëmijët në punë	PR.3	0,071	0,011	0,151	1,949	1,396	2.325	1.109	0,050	0,093
Martesa e fëmijëve (para moshës 15 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4a	0,004	0,002	0,509	0,323	0,568	423	353	0,000	0,007
Martesa e fëmijëve (para moshës 18 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4b	0,033	0,008	0,228	0,629	0,793	423	353	0,018	0,048

Tabela SE.2: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet urbane

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	**Kufijtë e besueshmërisë**	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Jeta në një mjedis të sigurt dhe të pastër										
Përdorimi i të paktën shërbimeve bazike të ujit të pijshëm	WS.2	0,968	0,006	0,006	3,196	1,788	12.727	2.831	0,957	0,980
Përdorimi i burimeve të përmirësuara të ujit të pijshëm në ambientet e banimit	WS.2a	0,937	0,010	0,010	4,484	2,118	12.727	2.831	0,917	0,956
Përdorimi i burimit të përmirësuar të ujit me ujë në dispozicion kur është e nevojshme	WS.2b	0,886	0,010	0,011	2,810	1,676	12.727	2.831	0,866	0,906
Disponueshmëria e ujit të pijshëm në muajin e fundit	WS.3a	0,890	0,010	0,011	2,895	1,701	12.727	2.831	0,870	0,910
Përdorimi i të paktën shërbimeve sanitare bazike	WS.9	0,982	0,004	0,004	2,490	1,578	12.727	2.831	0,974	0,990
Mundësia e barabartë në jetë										
Popullsia e mbuluar nga transferet sociale	EQ.3	0,782	0,010	0,013	1,635	1,279	12.727	2.831	0,763	0,802
Fëmijët në ekonomitë familjare që kanë marrë çfarëdo lloj transferi social	EQ.5	0,938	0,007	0,007	2,182	1,477	3.300	2.961	0,925	0,951
Diskriminimi	EQ.7	0,148	0,012	0,083	3,952	1,988	3.773	3.271	0,124	0,173

na: nuk aplikohet

Tabela SE.3: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet rurale

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	Kufijtë e besueshmërisë	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Mbulimi i mostrës dhe karakteristikat e respondentëve										
Qasja në burime të qëndrueshme të energjisë elektrike	SR.1	0,999	0,000	0,000	0,929	0,964	11.927	2.946	0,999	1,000
Mbështetja primare në lëndë djegëse të pastra dhe teknologji për gatim, ngrohje hapësire dhe ndriçim	SR.604	0,309	0,012	0,038	1,860	1,364	11.927	2.946	0,286	0,333
Mbijetesa										
Shkalla e vdekshmërisë neonatale (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.1	6	3,108	0,497	na	na	na	na	0	12
Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare (për 1.000 lindje të gjalla)	CS.5	14	5,168	0,357	na	na	na	na	4	25
Zhvillimi - Shëndeti riprodhues, maternal, i të porsalindurve dhe i të rriturve										
Shkalla totale e fertilitetit (numri i lindjeve të gjalla)	-	2,3	0,108	0,048	na	na	na	na	2,0	2,5
Shkalla e lindjeve tek adoleshentët (për 1.000 vajza adoleshente të moshës 15-19 vjeç)	TM.1b	6	2,973	0,480	na	na	na	na	0	12
Mbulueshmëria e kujdesit antenatal (të paktën katër herë nga cilido ofrues)	TM.5b	0,972	0,008	0,008	0,695	0,834	273	313	0,957	0,988
Zhvillimi - Shëndeti, të ushqyerit dhe zhvillimi i fëmijëve										
Mbulueshmëria me imunizim kundër difterisë, tetanosit dhe pertusisit (DTaP)	TC.3	0,864	0,023	0,027	0,632	0,795	124	141	0,818	0,910
Mbulueshmëria me imunizim pneumokokal (konjugat)	TC.S1	0,885	0,023	0,026	0,716	0,846	124	141	0,839	0,931
Mbulueshmëria me imunizim kundër fruthit	TC.S2	0,845	0,018	0,021	0,416	0,645	141	167	0,809	0,881
Prevalenca e ngecjes në rritje (mesatare dhe e rëndë)	TC.45a	0,049	0,010	0,200	1,386	1,177	588	674	0,029	0,068
Prevalenca e peshës së vogël për gjatësi (mesatare dhe e rëndë)	TC.46a	0,020	0,006	0,306	1,241	1,114	579	665	0,008	0,032
Prevalenca e mbipeshës (mesatare dhe e rëndë)	TC.47a	0,080	0,011	0,134	1,024	1,012	579	665	0,058	0,101
Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme 2030	TC.53	0,888	0,017	0,019	1,373	1,172	427	496	0,855	0,921
Mësimi dhe fitimi i aftësive										
Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (e përshtatur)	LN.2	0,899	0,020	0,022	0,796	0,892	172	186	0,860	0,939
Shkalla e përfundimit (shkolla fillore)	LN.8a	0,997	0,002	0,002	0,786	0,887	544	616	0,994	1,000
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e ulët)	LN.8b	0,989	0,004	0,004	0,961	0,980	520	580	0,980	0,997
Shkalla e përfundimit (shkolla e mesme e lartë)	LN.8c	0,876	0,016	0,018	1,317	1,148	522	578	0,845	0,908
Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi										
Regjistrimi i lindjeve	PR.1	1,000	0,000	0,000	na	na	688	796	1,000	1,000
Disiplinimi i dhunshëm	PR.2	0,682	0,015	0,022	1,699	1,304	2.312	1.580	0,652	0,713
Fëmijët në punë	PR.3	0,115	0,012	0,102	1,746	1,321	2.258	1.280	0,091	0,139
Martesa e fëmijëve (para moshës 15 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4a	0,002	0,000	0,037	0,001	0,033	350	419	0,002	0,002
Martesa e fëmijëve (para moshës 18 vjeç, gratë e moshës 20-24 vjeç)	PR.4b	0,036	0,010	0,292	1,324	1,151	350	419	0,015	0,057

Tabela SE.3: Gabimet e mostrimit: Vendbanimet rurale

Gabimet standarde, koeficientët e variacionit, efektet e dizajnit (deff), rrënja katrore e efekteve të dizajnit (deft), dhe intervalet e besueshmërisë për treguesit e përzgjedhur të SDG-ve dhe MICS, Kosovë, 2025

	Treguesi MICS	Vlera (*r*)	Gabimi standard (*se*)	Koeficienti i variacionit (*se/r*)	Efekti i dizajnit (*deff*)	Rrënja katrore e efektit të dizajnit (*deft*)	Llogaritja e peshuar	Llogaritja e papeshuar	**Kufijtë e besueshmërisë**	
									Kufiri i poshtëm r - 2se	Kufiri i sipërm r + 2se
Jeta në një mjedis të sigurt dhe të pastër										
Përdorimi i të paktën shërbimeve bazike të ujit të pijshëm	WS.2	0,953	0,005	0,005	1,730	1,315	11.927	2.946	0,943	0,964
Përdorimi i burimeve të përmirësuara të ujit të pijshëm në ambientet e banimit	WS.2a	0,899	0,009	0,010	2,833	1,683	11.927	2.946	0,880	0,917
Përdorimi i burimit të përmirësuar të ujit me ujë në dispozicion kur është e nevojshme	WS.2b	0,890	0,009	0,010	2,470	1,572	11.927	2.946	0,872	0,908
Disponueshmëria e ujit të pijshëm në muajin e fundit	WS.3a	0,897	0,009	0,010	2,436	1,561	11.927	2.946	0,879	0,914
Përdorimi i të paktën shërbimeve sanitare bazike	WS.9	0,916	0,014	0,016	8,001	2,829	11.927	2.946	0,887	0,945
Mundësia e barabartë në jetë										
Popullsia e mbuluar nga transferet sociale	EQ.3	0,819	0,009	0,011	1,543	1,242	11.927	2.946	0,801	0,836
Fëmijët në ekonomitë familjare që kanë marrë çfarëdo lloj transferi social	EQ.5	0,951	0,010	0,010	7,029	2,651	3.223	3.629	0,931	0,970
